



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 47 regjistër (JR)
Datë 03.10.2019

Nr. 31 i vendimit
Datë 12.10.2021

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Gjyqtare
Rezarta Schuetz	Gjyqtare
Sokol Çomo	Gjyqtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në datën 12.10.2021, ditë e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Branko Hrvatin, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Gurali Brahimllari.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 166, datë 21.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7, 8, 13, 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave e Lirive Themelore të Njeriut, me protokollet 1 e 12 të saj; nenet 18, 29, 30, 31, 33/1, 41, 42 dhe 179/b, paragrafët 1, 2 dhe 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni A, paragrafi 1, neni C, paragrafët 3 e 5, neni D, paragrafi 4, si dhe neni F, paragrafët 1, 2, 3 e 7 të Aneksit të Kushtetutës, miratuar me ligjin nr. 76, datë 22.07.2016; nenet 62, 63, 65 dhe 66/1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 46, 47, 48 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në seancat e datës 11.10.2021, ditë e hënë, në orën 10:00, dhe datë 12.10.2021, ditë e martë, në orën 10:00, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e

vendimit nr. 166, datë 21.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Gurali Brahimllari, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës, ishte gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë (në vijim “GjAKRT”) dhe, për rrjedhojë, në zbatim të kësaj dispozite, dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Sipas parashikimeve të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Nga hetimi i kryer përgjatë hetimit administrativ, trupi gjykues i Komisionit ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel kualifikues për kriterin e aftësive profesionale, ndërsa ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, për shkak të deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me këtë kriter, duke vendosur përfundimisht: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë”.

Në vlerësimin tërësor për vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues i Komisionit, konkludoi se:

1. *Për pasuritë e krijuara përpara vitit 2003, ka mungesë të të ardhurave në shumën 951.756 lekë, për të justifikuar:*
 - i. *blerjen dhe ndërtimin e pasurisë nr. 1 në vitet 1997 - 1998, si dhe ka deklaruar në mënyrë të pasaktë vlerën e shpenzuar për ndërtimin e pasurisë shtesë me sip. 16 m²;*
 - ii. *investimin në pasurinë nr. 2 në vitin 2000;*
 - iii. *ndërtimin e klinikës dentare në qytetin e Kuçovës në vitin 1995, si dhe ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e shpenzuar për ndërtimin e kësaj klinike.*
2. *Ka mungesë dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 1.500.000 lekë (dhënë hua nga shtetasi {***}), sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.*
3. *Ka mungesë dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 19.000 euro (dhënë hua nga shtetasi {***}), sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.*
4. *Nuk arriti të shpjegojë bindshëm, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, burimin e ligjshëm të shumës 2.000.000 lekë, marrë hua nga vëllai i tij, shtetasi B. B..*
5. *Për pasurinë nr. 4:*

- i. ka mungesë të të ardhurave në shumën 899.670 lekë për të justifikuar pagesën e shumës 49.000 euro në vitin 2008;
 - ii. nuk ka deklaruar këstin e paguar në datën 18.10.2008, në shumën 10.000 euro;
 - iii. nuk ka deklaruar gjendjen cash në shumën prej 6.536 euro sipas pretendimit të tij se ka paguar shumën 20.000 euro në fund të muajit dhjetor të vitit 2008, si dhe nuk ka deklaruar gjendjen cash në shumën 1.291.185 lekë, të pretenduar në tabelën e përllogaritjeve nga eksperti kontabël, po për vitin 2008;
 - iv. ka mungesë të të ardhurave në shumën 2.172.082 lekë, për të justifikuar pagesën e shumës 41.000 euro deri në datën 3.6.2009;
 - v. ka kryer deklarim të rremë lidhur me burimin e krijimit të këstit prej 41.000 eurosh në vitin 2009, pasi ka deklaruar si burim krijimi të tij dy hua të marra përtej shlyerjes, përkatësisht në shumën 1.000.000 lekë, marrë shtetasit P. B., në datën 14.8.2009 dhe 10.000 euro, marrë shtetasit B. B., në datën 17 shtator të po këtij viti;
 - vi. nuk ka deklaruar gjendjen cash në shumën 1.291.185 lekë, të pretenduar në tabelën e përllogaritjeve nga eksperti kontabël të vitit 2008, mbartur për shpenzimet e gjashtëmujorit të parë për vitin 2009;
 - vii. nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të shumës 10.000 euro, marrë hua nga vëllai i tij, shtetasi B. B. më 14.8.2009, sipas pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016;
 - viii. nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të shumës 1.000.000 lekë, marrë hua nga vëllai i tij, shtetasi P. B., në gusht të vitit 2009, sipas pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016;
 - ix. ka mungesë të të ardhurave në shumën 9.912.391 lekë (nga të cilat 6.840.639 lekë për vitet 2008 - 2016 dhe 3.071.752 lekë për këstet deri në tetor të vitit 2008 dhe qershor të vitit 2009) për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, për shlyerjen e huave të marra, kësteve të kredive në shumën 25.000 euro dhe 50.000 euro, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera të familjes së tij, përgjatë viteve 2008 – 2016.
6. Ka deklaruar në mënyrë të pasaktë burimet e pasurive në deklaratën “vetting”, si dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të tyre dhe të të ardhurave me burim nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortes për justifikimin e 13 huave, sipas pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka kryer deklarim të pamjaftueshëm sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit nr. 166, datë 21.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në datën 23.09.2019, në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore, ushtroi ankim subjekti i rivlerësimit Gurali Brahimllari duke parashtruar si më poshtë.

A. Shkaqet procedurale të ankimit për procesin e rregullt ligjor

5. Sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues i Komisionit ka vendosur të mbyllë hetimin administrativ me vendimin e ndërmjetëm të datës 15.05.2019, pa ezauruar verifikimet e nevojshme për procesin e rivlerësimit dhe duke shmangur vënien në dijeni të subjektit të rivlerësimit për gjendjen e arkës në pasqyrat financiare¹. Në lidhje me gjendjen e arkës në B.ncin tregtar të klinikës

¹ Së bashku me kërkesën për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe dokumentet në vijim: a) vërtetimin nr. {***} prot., datë 22.08.2019, të {***} “{***}”); b) vërtetimin nr. {***} prot., datë

dentare, subjekti i rivlerësimit pretendon se relatorja e çështjes dhe anëtarët e tjerë të trupit gjykues të Komisionit, në aktin “Rezultate të hetimit administrativ”, datë 15.05.2019, kanë shtrembëruar rrethanat e faktet që janë provuar në gjykim.

5.1. Gjithashtu, sipas pretendimeve në ankim të subjektit të rivlerësimit, disponimi me shumicë votash, me vendimin e ndërmjetëm të datës 30.05.2019, me të cilin trupi gjykues i Komisionit refuzoi kërkesën për thirrjen e pyetjen e ekspertëve/dëshmitarëve², ishte përcaktues në përfundimet për vendimin përfundimtar.

5.1.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se baza e procesit të rivlerësimit për subjektin apelues, ndryshe nga rastet e tjera në proces rivlerësimi, ka qenë e mbetet interpretimi i ligjeve fiskale që rregullojnë veprimtarinë e biznesit të vogël që administron bashkëshortja nga viti i hershëm 1994 e në vijim, legjislacionin i cili jo vetëm ka ndryshuar nga viti në vit, por shoqërohet edhe me një sërë aktesh nënligjore të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (në vijim “DPT”), duke e bërë atë kompleks e të vështirë, si për subjektin tatimpagues e subjektin e rivlerësimit, edhe për ekonomistët e specialistët e financës, pa përjashtuar edhe administratën tatimore. Prandaj, sipas subjektit të rivlerësimit, ka qenë e është krejt e domosdoshme që në procesin e rivlerësimit, jo vetëm Komisioni, por edhe subjekti i rivlerësimit të kishte të drejtën të realizonte mbrojtjen efektive duke urdhëruar kryerjen e ekspertizës dhe marrjen e dëshmive të kërkuara prej subjektit të rivlerësimit.

6. Sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në parashtrimet e datës 09.04.2021³, fashikujt nr. 15 - 20, në dosjen e përgatitur nga Komisioni, janë në kundërshtim me legjislacionin për arkivistikën dhe kanë krijuar një rrëmujë të vërtetë dokumentare, duke prishur lidhjen logjike dhe natyrore mes përgjigjeve, shpjegimeve dhe dokumenteve justifikuese, me pasojë kryerjen e shkeljeve të rënda procedurale, të cilat kanë cenuar procesin e rregullt ligjor dhe kanë pasur ndikim në rezultatin përfundimtar.

6.1. Për subjektin e rivlerësimit, ka qenë e nevojshme që ILDKPKI-ja të përfshinte procesverbalet me shpjegimet e tij në dosjen e dorëzuar në Komision, për të cilat Komisioni ka ardhur në dijeni në prapësimet e datës 10.06.2019. Këto akte, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk mund të konsiderohen prova të reja në kuptimin e plotë të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, meqenëse kanë qenë dhe janë pjesë e dosjes personale të subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI. Për sa i përket përmbajtjes së këtyre procesverbaleve dhe vlerës provuese, subjekti i rivlerësimit pretendon se një ndër problematikat e procesit të rivlerësimit ka qenë përlllogaritja e vlerës së amortizimit të aseteve me konsum afatgjatë në B.ncin tregtar të klinikës, mënyra e administrimit të fitimit neto të klinikës dhe vlera e tërhequr për shpenzime familjare e personale nga ky fitim, prej të cilave ka dalë edhe gjetja e Komisionit për gjendjen *cash*. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se problematika e mospërputhjes së deklaramit të

22.08.2019, {***}; c) vërtetimin nr. {***} prot., datë 04.09.2019, të {***} (në vijim “{***}”); ç) vërtetimin, datë 29.07.2019, të {***} (si dhe nxjerrjen e llogarive bankare për secilën prej tyre¹); d) deklaratën me përgjegjësi personale, datë 31.07.2019, të z. A. S.; dh) materialin sqarues, datë 13.09.2019, të kontabilistes F. K. për L. B. me NIPT {***}; e) tabelat e treguesve financiarë që rezultuan nga procesi i rivlerësimit në shkallë të parë; ë) shkresën nr. {***} prot., datë 03.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, së bashku me vendimin e trupit gjykues, datë 30.05.2019; dhe f) shkresën nr. {***} prot., datë 11.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (së bashku me vendimet e ndërmjetme të trupit gjykues, përkatësisht nr. 1, datë 18.07.2018; nr. 2, datë 15.05.2019 dhe nr. 3, datë 12.06.2019).

² Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me qëllim për t’u thirrur dëshmitarët me njohuri në fushën e kontabilitetit, përkatësisht znj. F. K., znj. A. M., z. Th. F., z. Q. L. dhe z. S. L., si dhe për t’u shqyrtuar në mënyrë tërësore provat dhe për t’u shpjeguar në mënyrë të plotë rrethanat lidhur me paaftësinë paguese dhe gjendjen arka/cash në klinikë.

³ Të tiulluara “shtesa paraprake të ankimit”.

subjektit të rivlerësimit për treguesit financiarë të klinikës dentare me ato të konfirmuara nga DRT Tiranë, është trajtuar në sqaruesen kthim përgjigje në lidhje me deklaratimet e pasurisë në vite drejtuar ILDKPKI-së, në datën 28.01.2015.

7. Në parashtrimet e dorëzuara në Kolegj në datat 21.09.2021 dhe 23.09.2021, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: “[...] ka bindjen e plotë se Kolegji i Posaçëm i Apelimit do të shqyrtojë pretendimet e ankuesit dhe çështjen në tërësi me drejtësi dhe paanësi, duke konkluduar edhe në dhomë këshillimi se vendimi i Komisionit është i gabuar dhe duhet të ndryshohet duke u konfirmuar [...]” dhe se: “[...] nëse Kolegji do të ketë paqartësi për të konkluduar në dhënien e vendimit, subjekti konfirmon kërkesën për kalimin e çështjes në gjykim, në prezencë të tij, në seancë gjyqësore [...]”.
8. Nëpërmjet ankimit të datës 23.09.2019, subjekti i rivlerësimit pretendon se procedura para Komisionit është kryer në kundërshtim me nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim KEDNj)⁴, duke mos u dëgjuar ai drejtësisht, duke nënçmuar dhe mos marrë në konsideratë shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij, duke mos i dhënë kohën e nevojshme për t’u njohur me gjetjet e hetimit administrativ. Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit dhe këshilltarët ekonomikë nuk përmbushnin kriteret e pavarësisë, paanësisë dhe kapaciteteve profesionale. Për sa u përket pretendimeve mbi shkeljen e nenit 14 të KEDNj-së⁵ dhe nenit 1, protokollit 12 i KEDNj-së⁶, sipas subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit ka qenë diskriminues, mbështetur mbi etiketimin si *gjyqtar i pasur*⁷. Për sa u përket pretendimeve mbi shkeljen e nenit 8 të KEDNj-së⁸, sipas subjektit të rivlerësimit, konkludimi i trupit gjykues të Komisionit, se ai dhe personi i lidhur me të nuk justifikojnë pasurinë, ka sjellë ulje të reputacionit të tij

⁴ Neni 6 i KEDNj-së, parashikon se: “1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë. 2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. 3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij; b) t’i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes; c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të njafueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë; d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës; e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq”.

⁵ Neni 14 i KEDNj-së parashikon se: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

⁶ Neni 1 i protokollit 12 të KEDNj-së parashikon se: “1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1”.

⁷ I cili, sipas subjektit të rivlerësimit, e ka zanafillën nga publikimi i datës 16.07.2016 i Reporter.al, dhe në disa media e portale të ndryshme.

⁸ Neni 8 i KEDNj-së parashikon se: “1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”.

në familje, te të afërmit, kolegët e në opinionin publik⁹. Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, duke vënë në diskutim e publikuar në media të dhëna financiare të personit fizik, si dhe standardet e shërbimit stomatologjik, në klinikën dentare, trupi gjykues i Komisionit ka shkaktuar ndërhyrje të padrejtë në jetën private e profesionale të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, duke cenuar reputacionin e saj si stomatologe.

8.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton vendimin e ndërmjetëm, datë 15.05.2019, të Komisionit, nëpërmjet të cilit Komisioni ka përfunduar hetimin administrativ, duke pretenduar se Komisioni nuk ka qenë i paanshëm, por ka qenë paragjykes sepse ka mbyllur hetimin administrativ pa vënë në dijeni subjektin e rivlerësimit mbi gjendjen e arkës, se duhet t'i kishte dhënë atij të drejtën e mbrojtjes përpara përfundimit të hetimit administrativ, dhe se vendimmarrja e Komisionit nuk duhej të bazohej në gabime materiale, lapsuse matematikore apo harresa të paqëllimshme në deklarime.

8.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton edhe vendimin e ndërmjetëm, datë 30.05.2019, të Komisionit, nëpërmjet të cilit Komisioni ka refuzuar marrjen e provave me dëshmitarë, duke pretenduar se Komisioni ka qenë paragjykes në vlerësimin e çështjes dhe nuk ka konsideruar mbrojtjen e subjektit të mbështetur në këto prova që ai ka kërkuar të merren.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

9. Lidhur me pasurinë apartament me sip. 36 m², rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni nuk ka vlerësuar me objektivitet provat dhe shpjegimet e dhëna prej tij, duke mos përfshirë në burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie pjesën takuese të të ardhurave të bashkëshortes nga profesioni i stomatologes për periudhën 01.01.1998 - 15.03.1998¹⁰, për shumën prej 216.667 lekë, si dhe të ardhurat e vetë subjektit të rivlerësimit nga bursa në Shkollën e Magjistraturës, në shumën prej 44.610 lekë, pas konsiderimit të të cilave ai rezulton me një diferencë pozitive prej (+) 9.067 lekësh¹¹.
10. Lidhur me pasurinë apartament me sip 116 m², në rr. ““{***}””, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se në analizën financiare të Komisionit për vitin 1998, të ardhurat nga klinika dentare e bashkëshortes për vitin 1998, duhet të ishin llogaritur për periudhën pas datës 15.03.1998, në shumën prej 758.333 lekësh dhe, nga ana tjetër, në analizën financiare të Komisionit duhet të ishin përfshirë të ardhurat nga klinika dentare e bashkëshortes për periudhën 1 maj - 31 korrik 2000 në shumën prej 312.188 lekësh; për periudhën 01 gusht – 22 dhjetor 2000 në shumën prej 492.563 lekësh; të ardhurat nga bursa e Shkollës së Magjistraturës për periudhën 1999 - 2000 në shumën prej 397.200 lekësh; të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit për periudhën shtator - dhjetor 2000 në shumën prej 111.962 lekësh; të ardhurat nga interesat e depozitës në periudhën 03.05.2000 - 08.08.2000 në shumën prej 77.500 lekësh¹², si edhe shpenzimet e jetesës për vitet 1999 dhe 2000.

⁹ Së pari, sipas subjektit të rivlerësimit, të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët janë të paragjykuar si të korruptuar, prandaj, sipas tij, mbeten pa asnjë vlerë të dhënat e hetimit administrativ, dhe së dyti, ndërhyrja e Komisionit në jetën private e profesionale të rivlerësimit, nuk është e ligjshme, sepse është zbatuar në mënyrë të njëanshme dhe me paragjykim përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit për justifikimin e pasurisë.

¹⁰ Përpjesëtimore me fitimin e vitit.

¹¹ Duke krahasuar përfundimet e trupit gjykues të Komisionit në f. 14, në vlerën prej (-) 251,440 lekësh, me analizën krahasuese në f. 31 të ankimit të subjektit të rivlerësimit, në vlerën prej (-) 252,210 lekësh, ka diferencë pasi shuma e investimit nga trupi gjykues i Komisioni është rrumbullakosur në shumën prej 298,000 lekësh, ndërsa subjekti e ka llogaritur në shumën prej 298.770 lekësh.

¹² Referuar f. 41 të analizës financiare të subjektit të rivlerësimit të paraqitur në ankim.

11. Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë ish-klinika dentare, Kuçovë, me sip. 38,25 m², të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në strukturën e burimit të krijimit të apartamentit, me garazh dhe papafingo, me sip. 250 m² në rr. ““{***}””, kompleksi ““{***}””, “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit e kundërshton konkluzion e arritur nga Komisionit duke pretenduar që në analizën financiare të përfshihen:
- a) të ardhurat e bashkëshortes si stomatologe në qendrën stomatologjike në Kuçovë¹³, për të gjithë periudhën e punës së saj, deri më 31.03.1994 (pra edhe të ardhurat e pagës së saj nga marrëdhënia e punës në institucionin shtetëror, në periudhën 01.01.1994 - 31.03.1994);
 - b) të ardhurat e bashkëshortes si person fizik, në periudhën prill - dhjetor 1994¹⁴, që përkon me vitin e parë të punës si stomatologe në profesion të lirë, për të cilat subjekti në ankim shprehet se Komisioni ka përjashtuar nga llogaritja të ardhurat e bashkëshortes për periudhën e tremujorit të katërt të vitit 1994, ndonëse për të u provua pagimi i tatimit të përcaktuar nga organi tatimor, dhe është dorëzuar mandat pagesa për vlerën e këtij tatimi;
 - c) të ardhurat e shërbimit të ortopedisë dentare, për të cilat subjekti i sjell në vëmendje të Kolegjit se, si në deklaratën e pasurisë *vetting*, edhe gjatë procesit të rivlerësimit, pretendon se bashkëshortja e tij, si tatimpaguese, në vitet 1994 - 1997, nuk ka deklaruar në organin tatimor këto të ardhura, të cilat zënë një vend të rëndësishëm në fitimet neto të klinikës. Mosdeklarimi prej bashkëshortes i vlerës së shërbimit të ortopedisë në të ardhura të tatueshme për vitet 1994 - 1995 (por edhe për periudhën e viteve 1996 - 1997), për të cilën ka pasur fajin e përgjegjësive edhe administrata tatimore, e lidhur me kohën e largët dhe vitet e para të ekonomisë së tregut në Shqipëri, përbëjnë rrethana të mjaftueshme për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve në krijimin e kësaj pasurie. Gjithashtu subjekti thekson se kjo pasuri është krijuar në rrugë ligjore, pa përfitime preferenciale të subjektit për shkak të detyrës dhe se të ardhurat e shpenzuara nuk kanë asnjë lidhje me funksionin e tij për të cilin po kryhet rivlerësimi, sepse në periudhën që u përket viteve 1994 deri nga mesi i vitit 1995, nuk ushtronte funksione në sistemin e drejtësisë.
 - ç) Subjekti pretendon se argumenti i përdorur nga Komisioni, se të ardhurat e klinikës dentare për vitin 1994 (si edhe për vitin 1995) neutralizojnë shpenzimet familjare, është jo vetëm në kundërshtim me parimin e objektivitetit, por edhe jologjik e kontradiktor me vetë përmbajtjen e arsytimit të metodologjisë në fillim të faqes 50 të vendimit, kur shprehet se "për periudhën para vitit 1996, shpenzimet (për jetesë) konsiderohen në masën 40% të të ardhurave", sepse subjekti i rivlerësimit ka pretenduar këtë vlerë për të ardhurat nga paga në shtet dhe jo nga aktiviteti tregtar.
 - d) Për sa i përket koston së ndërtimit të ish-klinikës dentare, Kuçovë, me sip. 38.25 m², subjekti i rivlerësimit pretendon se ajo duhet të llogaritet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 09.12.1996, "Për miratimin e vleftave mesatare vjetore te apartamenteve tip në tregun e lirë dhe të vleftës se koeficientit "K" (në vijim "VKM nr. 815/1996").
 - e) Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën e Komisionit dhe njëkohësisht pretendon që të kryhet një analize e plotë dhe jo e fragmentarizuar në periudhat konkrete të krijimit të pasurive, duke llogaritur të ardhurat e njësisë familjare për periudhën 1994 - 2002 dhe shpenzimet e kryera.
12. Lidhur me pasurinë njësi e destinuar si klinikë dentare, me sip. 74,32 m², në “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimi ka pretenduar se deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting* të depozitës

¹³ Referuar analizës së subjektit në ankim në faqen 53 të tij, tabela, ka konsideruar të ardhura 30.000 lekë.

¹⁴ Referuar analizës së subjektit në ankim në faqen 53 të tij, tabela, pika 1 e saj, ka konsideruar të ardhura 112.684 lekë.

1.500.000 lekë si burim për krijimin e kësaj pasurie është lapsus/ngatërresë që lidhet me identifikimin e depozitës dhe vlerën e saj¹⁵, kjo për shkak të kohës së largët dhe ngarkesës në punë. Ai ka pretenduar në vijim se ka shpjeguar bindshëm, bazuar në prova dokumentare, se kjo depozitë ka ekzistuar, mjetet monetare kanë qenë në posedim të bashkëshortes dhe ajo i ka përdorur si burim financiar për funksionimin e klinikës dentare, rrethanë që provon mungesën e qëllimit në pasaktësinë në deklaram.

13. Lidhur me analizën financiare të kryer në Komision për periudhën 2006 - 2007, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kontrolli e vlerësimi i pasurisë, i kryer nga trupi gjykues i Komisionit, ka qenë i mangët, duke argumentuar se ai nuk ka shpjeguar shkaqet e përfshirjes apo përjashtimit të pasurive apo burimeve nga kolonat përkatëse dhe nuk ka bërë analizë të detajuar financiare të kësaj periudhe. Sipas subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit nuk ka përfshirë në balancat respektive financiare dhe mundësinë e krijimit të vlerave monetare të lira, si likuiditete (*cash*) të mbartura vit pas viti, duke pretenduar se në periudhën 30.03.2005 - 31.12.2007, ka pasur mundësinë e krijimit të kursimeve monetare, si likuiditet, në vlerën rreth (+) 1.332.638 lekë¹⁶, e cila është përdorur muajt e parë të vitit 2008 për përballimin e shpenzimeve të nevojshme, si dhe pagesën e fundit të kredisë. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit pretendon se pavarësisht se trupi gjykues i Komisionit ka pranuar ngatërresën e destinacionit të përdorimit të depozitës në “{***}”, të tërhequr në datën 30.03.2005, të përdorur për blerjen e pajisjes ““{***}””, ai nuk i ka marrë në konsideratë e nuk ka reflektuar efektet financiare të këtij veprimi për periudhën vijuese.

14. Lidhur me pasurinë apartament, me garazh dhe papafingo, me sip. 250 m², në rr. ““{***}””, kompleksi ““{***}””, “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se huatë nga personat e tjerë të tretë, duhet të konsiderohen të sakta e të plota, në referim edhe të fakteve se këto marrëdhënie financiare u provua se janë shlyer totalisht në vitet 2010 - 2013, dhe deklarimi i përgjithshëm, pa detaje të plota, i kësaj marrëdhënieje me personat e tretë, duhet të konsiderohet i mjaftueshëm për korrektesën e subjektit në plotësimin e deklaratës, edhe për faktin se edhe në ligjin nr. 84/2016, nuk ka pasur qartësi në lidhje me deklaramin e marrëdhënies së huas me të tretë, kur ajo nuk konfirmohet se ekziston ende në kohën e plotësimit të saj.

14.1. Lidhur me pagesat e kryera në vitin 2008 për shlyerjen e kësteve të çmimit për pasurinë e ndodhur në “{***}”, subjekti i rivlerësimit pretendon se në analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 01.01.2008 - 18.10.2008, në rastin më të mirë nuk janë përfshirë treguesit realë të të ardhurave të biznesit deri në atë datë, jo vetëm sepse ato nuk pasqyrohen në pasqyrat financiare të dorëzuara në tatime në datën 10.02.2009, por edhe sepse rrethanat e nevojshme të rivlerësimit edhe për këtë periudhë, nuk janë hetuar e nuk janë vlerësuar nga trupi gjykues i Komisionit. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, ka neglizhuar e refuzuar pa asnjë arsye, shpjegimet e tij për faktorët që duhen marrë në konsideratë edhe kur bëhet analizë e parcelizuar. Subjekti ka pretenduar në vijim se trupi gjykues i Komisionit ka qenë subjektiv dhe ka arritur në përfundime të gabuara për balancën e pasurive me të ardhurat sipas analizës së parcelizuar, duke argumentuar se në kushtet kur bashkëshortja e vetëpunësuar nuk merr pagë mujore dhe, sipas ligjit fiskal, është e lirë të përdorë e disponojë të ardhurat nga shërbimi që kryen edhe sipas nevojave të saj personale e familjare.

¹⁵ Në vend të depozitës nr. {***} në “{***}”, e krijuar më 10.12.2003, është deklaruar si burim për krijimin e pasurisë depozita nr. {***}, datë 23/10/2003, në emër të bashkëshortes në Bankën “{***}”.

¹⁶ Në ankim e përllogarit si total të balancave pozitive (si diferencë e të ardhurave – shpenzime – pasuri) për vitet 2005, 2006 dhe 2007 sipas rezultateve të analizës financiare të Komisionit.

14.1.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, vlera negative e balancës sipas analizës së Komisionit për periudhën 01.01.2008 - 18.10.2008, prej (-) 899.670 lekësh, do të dilte pozitive në shumën mbi 400.000 lekë, sepse duhej të merrej në konsideratë në analizë gjendja *cash* e datës 31.12.2007, në vlerën prej 1.332.638 lekësh, e kursyer gjatë periudhës 30.03.2005 - 31.12.2007, me burim kryesor ngatërresën e paqëllimshme në deklarime të destinacionit të përdorimit të depozitës bankare të mbyllur në datën 30.03.2005¹⁷. Gjithashtu dhe mundësia e kursimit në fund të vitit 2008, sipas analizës e pretendimeve të subjektit, duhej të vlerësohej bashkë me mundësinë e kursimit deri në datën 31.12.2007, prej 1.332.638 lekësh, e do të rezultonte në shumën 1.465.000 lekë.

14.1.2. Sipas subjektit të rivlerësimit, konkluzioni i Komisionit se: “[...] nuk ka deklaruar këstin e paguar në datën 18 tetor 2008, në shumën 10.000 euro [...]”, është tërësisht i gabuar pasi dhe pse nuk përcakton se në cilën deklaratë se ka deklaruar, ky këst është pjesë e deklaratimit të bërë në deklaratën vjetore për shumën totale të paguar prej 49.000 eurosh dhe në deklaratën e pasurisë *vetting* referuar shumës së paguar në vitin 2008, si dhe është pjesë përbërëse e shumës monetare prej 29.000 eurosh, referuar kontratës së porosisë, paguar para lidhjes së kontratës, përkatësisht pagesa e datës 18.10.2008, prej 10.000 eurosh.

14.1.3. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji, të konfirmojë dinamikën e pagesave të kryera realisht, në datën 18.10.2008, në shumën prej 10.000 euro, me burim kryesisht të ardhura nga mbyllja e depozitave që kanë qenë aktive nga viti 2007 në “{***}” në emër të bashkëshortes, të tërhequra në periudhën gusht - shtator 2008, si dhe me të ardhurat e tjera të bashkëshortes gjatë periudhës gusht - tetor 2008.

14.1.4. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton konkluzionin e Komisionit se nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të huave nga vëllai, z. B. B., në vitin 2008, në shumën prej 2.000.000 lekësh, duke pretenduar se provoi dhe shpjegoi bindshëm se depozita bankare dhe e gjithë shuma e dhënë hua jo vetëm ka qenë në llogarinë personale të huadhënësit në kohën e transaksionit, por dhe vite më parë, pra se deklarimi i tij për burimin e huamarrjes nga llogaria personale është i saktë dhe arsyetimi i vendimit të Komisionit jo vetëm është i gabuar, por përbën shtrembërim të fakteve dhe rrethanave të provuara. Gjithashtu, lidhur me shumën prej 1.500.000 lekësh, të marrë nga kunati i tij, z. A. S.¹⁸, në vitin 2002, dhe huan prej 19.000 eurosh, të marrë po nga kunati i tij, z. A. S., në vitin 2008, subjekti i rivlerësimit i kundërshton konkluzionet e Komisionit duke pretenduar se kunati kishte mundësi t’i krijonte këto shuma në vitet 2002 dhe 2008 me burime të ligjshme.

14.2. Lidhur me pagesat e kryera në vitin 2009, subjekti pretendon se rezultati i analizës financiare do të ishte pozitiv në vlerën rreth (+) 192.000 lekë, me përfshirjen në analizë të mundësisë së kursimit nga viti 2008, në shumën prej 1.465.000 lekësh, huan afatshkurtër prej 700.000 lekësh, të marrë në maj dhe të shlyer në shtator të të njëjtit vit nga familja B.¹⁹, si edhe përdorimin e mjeteve monetare në shumën prej 200.000 lekësh, të tërhequra nga të ardhurat e klinikës në cilësinë e

¹⁷ Referuar depozitës në {***} të bashkëshortes, tërhequr në datën 30.03.2005, në shumën prej 1.613.000 lekësh, me burim nga huaja e dhënë nga kunati i tij, z. A. S., në vitin 2002, sipas përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 4.02.2019.

¹⁸ Z. B. V., në vendim identifikohet me emrin “A. S.”, sipas ndryshimit të emrit dhe mbiemrit me vendimin nr. {***}, datë 17.11.1995, të Këshillit të Bashkisë Kuçovë.

¹⁹ Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit referon dhe në huat e deklaruara në pyetësor, të marra nga vëllai B. B., në shumën prej 5.000 eurosh, marrë në janar 2009 dhe në shumën prej 3.000 eurosh nga vëllai P. B., marrë në prill 2009, të cilat janë shlyer në dhjetor 2009, por që nuk janë deklaruar në deklaratën periodike/vjetore, dhe trupi gjykues i Komisionit i ka përfshirë në analizën financiare që i përket periudhës 01.01.2009 - 03.06.2009.

pronarit, si përdorimi i aktiveve të arkëtueshme apo detyrimeve afatshkurtra me personat e tjerë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit e kundërshton konkluzionin e Komisionit për mosdeklarimin e shumë prej 1.291.185 lekësh, të pretenduar në tabelën e llogaritjeve nga eksperti kontabël për vitin 2008²⁰, të mbartur sipas subjektit të rivlerësimit në të ardhurat e vitit 2009, duke argumentuar se përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit nuk lidhet me deklaratimet e tij dhe as me gjetjet e Komisionit, por me rezultate të llogaritura nga eksperti kontabël për mundësinë e kursimit, dhe se mosdeklarimi i mundësive të kursimit lidhet me paqartësitë ligjore të formatit të deklaratës vjetore në ILDKPKI, të cilat kërkonin vetëm ndryshimet e gjendjes *cash*, jo vlerën totale të kësaj gjendjeje në fundin e vitit dhe se përgjegjësia ligjore e subjektit të rivlerësimit lidhet me saktësinë e deklaratës e pasurisë *vetting* dhe jo me ndonjë parregullsi të deklaratave periodike/vjetore.

14.3. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton konkluzionin e Komisionit se nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të huave në vitin 2009, prej 10.000 eurosh, nga vëllai i tij B. B., dhe prej 1.000.000 lekësh, nga vëllai i tij P. B., duke pretenduar se vëllezërit kishin mundësi t'i krijonin këto shuma në vitin 2009 me burime të ligjshme.

15. Lidhur me analizën financiare të Komisionit për vitet 2010 – 2016, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk duhet të konsiderohet gjendja “arka” e pasqyrave financiare të personit fizik si një vlerë likuiditeti *cash* që ngarkon me shpenzim analizën financiare të njësisë familjare të subjektit, moskonsiderimi i së cilës do të jepte rezultat përfundimtar përgjithësisht pozitiv të kësaj analize.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

16. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

16.1. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Gurali Brahimllari, me funksion gjyqtar pranë GjAKRT-së, dhe për të cilin subjekti i rivlerësimit nëpërmjet ankimit kërkon ndryshimin e tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

17. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15

²⁰ Në analizën në ankim, mundësia e kursimit *cash* në datën 31.12.2007, pretendohet në shumën prej 1.332.638 lekësh, dhe në datën 31.12.2008, pretendohet në shumën prej 1.465.000 lekësh.

ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit²¹, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

18. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”) për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

18.1. Në ankimin e paraqitur në Komision prej subjektit të rivlerësimit në datën 23.09.2019 dhe në kërkesën e datës 23.09.2019, bashkëlidhur këtij ankimi, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar: “[...] 2. Gjykimin e çështjes në apel, në seancë gjyqësore publike, për shkak se është bazuar në shkelje të rënda procedurale e kushtetuese, si dhe në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht, në mënyrë jo të plotë, prandaj është e nevojshme të përsëritet shqyrtimi i provave të dosjes së rivlerësimit, të pranohen për shqyrtim provat e refuzuara pa të drejtë në shkallë të parë, si dhe të lejohet paraqitja e shqyrtimi i disa provave të reja²², për të cilat plotësohen kushtet e nenit 47 të ligjit 49/2012”.

18.1.1. Nëpërmjet aktit të paraqitur në Kolegj në datën 12.04.2021, të titulluar “shtesë paraprake ankimi”, me objekt: “Parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara në dosjen e rivlerësimit, pasojat procedurale për procesin e rivlerësimit dhe kërkimi që Kolegji i Posaçëm i Apelit të bëjë korrigjimet e nevojshme”, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji: së pari, të korrigjojë organizimin e dokumenteve në katër fashikuj të Komisionit; së dyti, të korrigjojë neglizhencën e Komisionit duke plotësuar dosjen e rivlerësimit edhe me akte shkresore që gjenden në dosjet personale të subjektit në ILDKPKI dhe KLGj; së treti, të ekzaminojë të gjitha provat dhe shpjegimet për kriterin e pasurisë, përfshirë edhe procesverbalet me shpjegime për ILDKPKI-në; dhe së katërti, të rishqyrtojë dokumentet për rivlerësimin profesional që gjenden në dosje. Të njëjtin pretendim subjekti e ka paraqitur në mënyrë të përsëritur edhe në parashtrimet e datave 21.09.2021 dhe 23.09.2021, të depozituara në Kolegj.

²¹ Subjektit të rivlerësimit i është njoftuar vendimi i arsyetuar në datën 07.09.2019, dhe ankimi i subjektit të rivlerësimit është paraqitur në datën 23.09.2019.

²² Së bashku me ankimin dhe kërkesën e datës 23.09.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: vërtetimin nr. {***} prot., datë 22.08.2019, të {***}; vërtetimin nr. {***} prot., datë 22.08.2019, të {***}; vërtetimin nr. {***} prot., datë 04.09.2019, të {***}; dhe vërtetimin, datë 31.07.2019, të llogarive bankare, lëshuar nga {***}, të cilat dëshmojnë fakte ekzistuese para dhënies së vendimit nga Komisioni, por që për të cilat subjekti i rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 47 të ligjit nr. 84/2016, nuk ka vërtetuar se pa fajin e tij nuk janë paraqitur në Komision. Gjithashtu, në përmbajtje, dokumentet e paraqitura së bashku me ankimin nuk sjellin ndryshime për vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, pasi vërtetimi nr. {***} prot., datë 22.08.2019, i {***}, dëshmon të drejtën e punësimit në Greqi të z. A. S., por nuk dëshmon të ardhura nga punësimi; vërtetimi nr. {***} prot., datë 22.08.2019, i {***}, dëshmon të drejtën e punësimit në Greqi të znj. K. K., por nuk dëshmon të ardhura nga punësimi i kësaj të fundit apo i z. A. S.; vërtetimi nr. {***} prot., datë 04.09.2019, i {***}, për z. A. S., dëshmon regjistrimin për herë të parë në zyrën e punësimit në Greqi, por nuk dëshmon të ardhura nga punësimi; dhe vërtetimi, datë 31.07.2019, i llogarive bankare, lëshuar nga {***}, dëshmon kreditimet/debitimet në llogari të z. A. S. dhe znj. K. K., por nuk dëshmon burimin e këtyre transaksioneve. Për këto arsye, dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit së bashku me ankimin, bazuar në nenin 49, pikat 1 dhe pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, janë të panevojshme pasi nuk sjellin përcaktime të gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

19. Për të përcaktuar formën e gjykimit në Kolegj, trupi gjykues vlerësoi të shqyrtonte në mënyrë të integruar pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit mbi cenimin e parimit të paanësisë nga trupi gjykues i Komisionit dhe refuzimin e marrjes së provave të paraqitura prej tij, nëpërmjet kundërshtimit të vendimeve të ndërmjetme të trupit gjykues të Komisionit, datë 15.05.2019 dhe datë 30.05.2019, si edhe kërkesën e subjektit për marrjen e provave të reja të paraqitura me ankimin dhe përgjatë fazës kur çështja gjendej në studim.

19.1. Për sa i përket pretendimit kundër vendimit të ndërmjetëm, datë 15.05.2019, se trupi gjykues i Komisionit nuk ka qenë i paanshëm, por ka qenë paragjykes sepse ka mbyllur hetimin administrativ pa vënë në dijeni subjektin e rivlerësimit për gjetjet mbi gjendjen e arkës, Kolegji konstatoi nga analiza e akteve që gjenden në fashikull se ky pretendim nuk qëndron pasi, në rezultatet e hetimit administrativ, referuar gjendjeve *cash* të konsiderueshme në B.ncet e aktivitetit tregtar të bashkëshortes së subjektit për vitet 2010 - 2016, Komisioni, në përputhje me nenin 52, pika 2, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime për të provuar të kundërtën e konstatimit se kjo gjendje do të duhej t'i ngarkohej analizës financiare të njësisë familjare të subjektit. Vënia në dijeni e subjektit të rivlerësimit me këtë gjetje të Komisionit, për më tepër në rezultatet e hetimit paraprak, shoqëruar me kalimin e barrës së provës, i ka dhënë subjektit jo vetëm mundësinë për t'u njohur me një rezultat të pritshëm administrativ lidhur me këtë konstatim, por edhe mundësinë që ai të mbrohet duke paraqitur prova e argumente për të provuar të kundërtën. Komisioni, duke vepruar në këtë mënyrë, ka ezauruar detyrimet e tij ligjore sipas përcaktimit të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe ka zhveshur vendimmarrjen e tij nga mundësia e dyshimit për anësi e paragjykim përderisa e ka trajtuar këtë çështje, në ndryshim nga sa pretendon subjekti, në përputhje me parimet e procesit të rregullt, sipas parashikimit të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e nenit 6 të KEDNj-së.

19.1.1. I pabazuar gjendet edhe pretendimi i subjektit se Komisioni duhet t'i kishte dhënë të drejtën e mbrojtjes përpara përfundimit të hetimit administrativ, duke qenë se bazuar në nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka detyrimin që t'i kalojë subjektit barrën e provës, pasi të ketë arritur në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë dhe pasi të ketë arritur në përfundime paraprake²³ për çështjet për të cilat kalohet barra e provës. Vlerësimet paraprake të Komisionit, të krijuara në një fazë të hershme e të bazuara në informacionin e disponueshëm, por të patrajtuara si gjetje, për të cilat kalohet barra e provës, nuk është e detyrueshme të ndahen me subjektin e rivlerësimit përderisa ato mund të mbeten vetëm në këtë status e të mos formalizohen në formën e gjetjeve për të cilat kalon barra e provës, e për pasojë të mos përcaktojnë edhe konkluzionet përfundimtare të trupës, në të cilat arrihet në përfundim të procesit administrativ e bazuar në të gjitha elementet e disponueshme, duke përfshirë provat e grumbulluara dhe kundërshtimet e paraqitura në seancë dëgjimore²⁴. Në këto rrethana, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk u konsiderua si i bazuar në ligj prej Kolegjit dhe as se cenon në ndonjë mënyrë të drejtat e tij në këtë proces.

19.1.2. Lidhur me pretendimin se Komisioni ka bazuar vendimin e tij në gabime materiale, lapsuse matematikore apo harresa të paqëllimshme në deklarime të kryera prej subjektit, Kolegji vlerëson se nuk qëndron pasi nga një lexim qoftë *prima facie* i vendimit të Komisionit, i pasqyruar në mënyrë të përmbledhur edhe në pjesën hyrëse të këtij vendimi, rezulton se ai është mbështetur jo vetëm mbi pasaktësitë në deklarime të subjektit, por, sipas rastit, edhe mbi mungesën e burimeve

²³ Sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016: "2. Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën".

²⁴ Shih paragrafin 306, fjalia e fundit e vendimit Xhoxhaj kundër Shqipërisë të GjEDNj-së.

të ligjshme, mungesën dokumentacionit justifikues dhe në përgjithësi mungesën e shpjegimeve bindëse të dhëna nga subjekti për justifikimin e pasurive të tij si shkaqe që kanë përcaktuar vendosjen e masës disiplinore²⁵.

19.2. Për sa u përket kundërshtimeve të subjektit në drejtim të vendimit të ndërmjetëm të Komisionit, datë 30.05.2019, nëpërmjet të cilit Komisioni ka refuzuar marrjen e provave të kërkuara prej tij, duke “demonstruar”, sipas subjektit të rivlerësimit, se ai ka qenë paragjykses në vlerësimin e çështjes dhe nuk ka konsideruar mbrojtjen e subjektit të mbështetur në provat që ai ka kërkuar të merren, Kolegji vlerëson të ndalet tek arsyetimi i trupit gjykues të Komisionit për t’i dhënë përgjigje këtij pretendimi si më poshtë vijon.

19.2.1. Sipas trupit gjykues të Komisionit: *[...] në lidhje me kërkimin e parashtruar në pikën e dytë ku subjekti i rivlerësimit kërkon të pyetet ish-punonjësja e {***}, shtetësja A. M., për të reflektuar ndryshime në analizën financiare për periudhën 1998 - 2000, ai ka depozituar edhe dokumentacionin mbështetës, vlerësim - analizë të kartelave në {***}, të hartuar nga kjo shtetase, për të cilin trupi gjykues çmon se është i mjaftueshëm për t’u administruar dhe vlerësuar në cilësinë e provës në dosjen e hetimit administrativ.*

19.2.1.1. Kolegji, duke konsideruar arsyetimin e mësipërm, vlerëson se vendimi i Komisionit është i mbështetur në faktet që kanë rezultuar prej hetimit administrativ. Duke arsyetuar në këtë mënyrë, Komisioni ka zbatuar tagrat e tij diskrecionalë për të vendosur marrjen ose refuzimin e provave të kërkuara prej subjektit, të parashikuara në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, dhe ka bërë një vlerësim të drejtë të kërkimit të subjektit, i cili duket se me provën me dëshmitar, ka synuar të provojë një fakt i cili është konsideruar njësoj i provuar për Komisionin nëpërmjet një akti shkresor të administruar sipas kërkimit të subjektit të rivlerësimit.

19.2.2. Në të njëjtën linjë konstatohet se është edhe disponimi i Komisionit lidhur me kërkesën për pyetjen e dëshmitares F. K., për të cilën është arsyetuar: *Subjekti kërkon të pyetet në cilësinë e dëshmitares shtetasja F. K., si hartuese e pasqyrave financiare, akte të cilat ai i ka depozituar së bashku me kërkesën e tij. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se ato janë të mjaftueshme për t’u administruar dhe vlerësuar si prova në dosjen e hetimit administrativ.*

19.2.2.1. Edhe lidhur me këtë disponim, Kolegji vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit që ka refuzuar marrjen e provës me dëshmitar përderisa faktet që tentohen të provohen me këtë provë, provohen gjithashtu nëpërmjet akteve shkresore të administruara, duke përdorur arsyetimin si më lart, për sa kohë që tipologjia e vendimmarrjes dhe arsyetimi i Komisionit është i njëjtë.

19.2.3. Komisioni ka refuzuar kërkesën e subjektit për të pyetur me cilësinë e dëshmitarit ekspertin Q. L., duke arsyetuar se: *Subjekti kërkon të pyetet në cilësinë e dëshmitarit ekspertit kontabël, shtetasi Q. L., i cili njëkohësisht ka hartuar analizën financiare të subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ. Për pasojë, trupi gjykues çmon se tabelat financiare të depozituara nga subjekti, janë dokumente të mjaftueshme për t’u administruar dhe vlerësuar në cilësinë e provës në dosjen e hetimit administrativ.*

19.2.3.1. Kolegji konstaton se kundërshtimi i subjektit në lidhje me këtë disponim, është njësoj i pambështetur duke konsideruar si më lart arsyetimin e Komisionit, se dëshmia është vlerësuar si e

²⁵ Shih vlerësimin tërësor të çështjes që trupi gjykues i Komisionit ka kryer në f. 56-57, në përmbyllje të vendimit nr. 166, datë 21.06.2019.

panevojshme përderisa të dhënat që do të merreshin nëpërmjet dëshmisë janë pasqyruar në analizën financiare të hartuar prej tij e të administruar si provë nga Komisioni.

19.2.4. Lidhur me kundërshtimin e subjektit ndaj disponimit të Komisionit për refuzimin e marrjes së dëshmisë së z. Th. F., konstatohet se Komisioni ka arsyetuar: *Subjekti kërkon të pyetet në cilësinë e dëshmitarit shtetasi Th. F., {***}, me qëllim provueshmërinë e një xhiro qarkulluese për vitet 1995 - 1997, më të lartë se ajo e deklaruar dhe e konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë. Subjekti ka depozituar dy fletë njoftim-tatimi të Degës së Tatimeve Kuçovë, përkatësisht për vitet 1997 dhe 1998, të cilat rezultojnë të administruara edhe më parë në dosjen e hetimit administrativ. Trupi gjykues çmon se dëshmia e dhënë për të provuar një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, në raport me dokumentacionin zyrtar, edhe po të konsiderohet e vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit, ndërsa vlerëson administrimin e këtyre provave edhe një herë.*

19.2.5. Në vlerësim të këtij kundërshtimi, Kolegji çmon se me të drejtë Komisioni ka arsyetuar mbi mospasjen e vlerës provuese të dëshmisë së z. F. për të kundërshtuar faktet që kanë rezultuar të provuara nga dokumentacioni shkresor i administruar si provë në Komision e që për më tepër konsiston në akte zyrtare të organeve tatimore të krijuara pikërisht për evidentimin e të dhënave të pretenduara për t'u provuar. Me të drejtë Komisioni, duke konsideruar vlerën provuese të këtyre lloj provash, veçanërisht për fakte të ndodhura në vitet 1995-1997 e që nuk rezultojnë se kanë qenë me rëndësi të posaçme për dëshmitarin, ka refuzuar si të panevojshme marrjen e dëshmisë, mbështetur në të drejtën që i ka njohur neni 49, pika 6, germa "a" e ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, Kolegji vlerësoi se kërkesa e subjektit për të marrë prova të reja, nuk gjeti mbështetje në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, për sa kohë ai nuk provoi se mosparaqitja e tyre gjatë hetimit nuk ka qenë për fajin apo pamundësinë e tij. Siç rezultoi nga analiza e akteve, subjekti ka qenë i informuar për gjetjet për të cilat i është kaluar barra e provës dhe në mundësi të paraqiste provat që nevojiteshin brenda kohës së lënë në dispozicion nga Komisioni, prova të cilat edhe janë paraqitur prej tij si në këtë fazë të procesit, por edhe më parë, përgjatë pyetjeve që Komisioni i ka drejtuar atij. Përveç sa më lart, Kolegji, duke analizuar përmbajtjen e akteve të paraqitura si provë prej subjektit bashkë me ankimin apo edhe me parashtrimet, vëren se ato nuk përcjellin informacion të domosdoshëm për zgjidhjen e çështjes, për pasojë edhe në versionin që ato do të kalonin testin e nenit 47 të ligjit nr. 49.2912, ato përsëri konsiderohen si të panevojshme në kuadër të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe, si të tilla, vlerësohet se duhet refuzuar marrja e tyre. Në vijim të këtij arsyetimi, do të analizohen rast pas rasti situatat faktike në të cilat mund të përdroreshin provat e reja të paraqitura nga subjekti duke u pasqyruar në mënyrë të detajuar edhe panevojshmëria e tyre sipas rastit.

- 20.** Përpos sa më lart, duke vlerësuar në tërësi kërkesën e subjektit të rivlerësimit në ankim dhe në parashtrime, dhe mbi bazën e dokumenteve që ndodhen në dosjen e dërguar nga Komisioni në Kolegj, në mbështetje të parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, debati gjyqësor në seancë gjyqësore, me praninë e subjektit, u vlerësua nga trupi gjykues i Kolegjit se është i panevojshëm, pasi konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e prova të reja, nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni. Hetimi gjyqësor ka qenë i rregullt, vendimmarrja e Komisionit ka qenë në përputhje me parimet e procesit të rregull ligjor, duke i garantuar subjektit të gjitha të drejtat e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 dhe nuk konstatohen shkaqe që do të shkaktonin pavlefshmëri të tij.

20.1. Për këtë arsye, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi që shqyrtimi i vendimit nr. 166, datë 21.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të kryhet mbi bazën e dokumenteve në dhomën e këshillimit sipas vlerësimit në vijim të shkaqeve të ankimit, pasi për këtë çështje nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit.

20.2. Për sa u përket pretendimeve se trupi gjykues i Komisionit kishte shkelur nenin 6 të KEDNj-së sepse nuk i ka dhënë subjektit kohën e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij dhe paraqitur dokumentacionin e nevojshëm, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se ato janë pabazuara sepse rezulton se Komisioni ka pranuar kërkesat e subjektit të rivlerësimit për shtyrjen e afatit 10-ditor për të paraqitur prapësime mbi rezultatet e hetimit të njoftuara në datën 15.05.2019, një herë për arsye pune, kërkesë e paraqitur po në datën 15.05.2019, dhe herën tjetër për arsye shëndetësore, kërkesë e paraqitur në datën 30.05.2019, duke i dhënë kohën mjaftueshme për të paraqitur prapësimet, sikurse edhe u paraqitën prej subjektit të rivlerësimit në datën 08.06.2019. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, mbi mospërmbushjen e kërkesës së pavarësisë dhe paanësisë, mbetën në nivelin e pretendimeve të pambështetura në rrethanat e çështjes konkrete, në kushtet kur edhe jurisprudenca e GjEDNj-së²⁶ ka vlerësuar se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mishëron karakteristikat e një organi të pavarur gjyqësor, ndërkohë që vetëm fakti i thjeshtë që trupi gjykues i Komisionit konstatoi gjetje paraprake në çështjen e subjektit të rivlerësimit, nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e trupit gjykues të Komisionit²⁷.

20.3. Kolegji vëren se nuk konstatohen shkelje të nenit 8 të KEDNj-së në drejtim të cenimit të jetës familjare dhe uljes së reputacionit, sepse aspektet procedurale të nenit 8 të KEDNj-së janë të lidhura ngushtë me të drejtat dhe interesat e mbrojtura nga neni 6 i KEDNj-së, nëpërmjet të cilit ofrohet garancia ligjore e së drejtës së aksesit në gjykatë, me qëllim për të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet civile, kështu që kërkesat procedurale të parashikuara nga neni 8 i KEDNj-së jo vetëm që përfshijnë procedurat administrative dhe ato gjyqësore, por ato janë plotësuese në një kuptim më të gjerë për të siguruar, ndër të tjera, jetën private dhe të familjes²⁸. Kolegji vëren se kufizimet e së drejtës për privatësi, në kuptim të nenit 8 të KEDNj-së, janë pranuar si të kufizueshme në këtë proces sipas parashikimit të nenit A, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, dhe këto kufizime i janë nënshtruar vlerësimit të GjEDNj-së në rastin Xhoxhaj kundër Shqipërisë, duke u konsideruar se ato nuk prekin thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive në kuptim të garancive të Konventës, për këtë arsye në planin konventor dhe kushtetues, Kolegji çmon se është kapërcyer kufiri i kufizimeve të këtyre të drejtave në përputhje me nivelin e pranuar prej nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Përveç kësaj analize në parim, Kolegji nënvizon faktin se në çështjen objekt shqyrtimi, nuk u konstatuan shkelje të këtyre të drejtave përtej një niveli të arsyeshëm të pranuar e parashikuar nga Kushtetuta e ligji dhe as sjellje tipikisht cenuese të këtyre të drejtave që lidheshin me subjektin e rivlerësimit apo familjen e tij. Llogaridhënia e subjektit dhe e personave të lidhur në kuadër të procesit të rivlerësimit, vlerësohet si e njëjtë në drejtim të kufizimit të të drejtave të garantuara nga neni 8 i KEDNj-së, ashtu si edhe për të gjitha subjektet e tjera të rivlerësimit e në përputhje me parashikimet e frymën e Kushtetutës dhe ligjit.

²⁶ *Vendimi Xhoxhaj kundër Shqipërisë.*

²⁷ *Vendimi i GjEDNj-së, Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafët 294 - 308.*

²⁸ *Vendimet e GjEDNj-së, Tapia Gasca and D. kundër Spanjës, paragrafët 111 - 113, Bianchi k. Zvicrës paragrafi 112, McMichael k. Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 91, B. k. Mbretërisë së Bashkuar, paragrafët 63 - 65, dhe Golder k. Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 36.*

20.4. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit i gjen të pabazuara pretendimet e subjektit mbi shkeljen e nenit 14 të KEDNj-së dhe nenit 1, protokollit 12 i KEDNj-së, sepse vendimmarrja e trupit gjykues të Komisionit nuk rezulton të jetë kryer mbi bazën e etiketimit si gjyqtar i pasur apo vlerësimeve mediatike për subjektin, por ka ardhur në vlerësim të plotë të fakteve që rezultuan nga procesi administrativ e kuadrit ligjor në fuqi për vlerësimin e kriterit të pasurisë.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

21. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartamentin me sip. 36 m², në rr. “{***}”, Tiranë, me vlerë 1.500.000 lekë, pjesa takuese 100%, me burim krijimi: “a) të ardhura nga shitja e 1/2 pjesë e pasurisë ap. 1 + 1, nga bashkëshortja, në shumën 400.000 lekë sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.08.1997²⁹; b) të ardhura nga aktiviteti i saj si stomatologe në periudhën janar 1996 - dhjetor 1998, si dhe nga paga e subjektit si ndihmësgjyqtar efektiv në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kuçovë”. Në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, lidhur me këtë pasuri, është deklaruar burimi i krijimit: “[...] kursimet nga të ardhurat e pagës time dhe të bashkëshortes si stomatologe”. Për sa i përket mënyrës së krijimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Nga bashkimi i dy pasurive të deklaruara për ILDKPKI, në mars 2004: a) pasuria nr {***}, në {***}, sip 20 m², blerë në datën 27.08.1997, me kontratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., e përbërë nga një dhomë, banjo e korridor, në rrugën "{***}", pall {***}, shk. {***}, ap. {***}, regjistruar në datën 18.12.2002, dhe b) pasuria nr. {***} në {***}, vol. {***}, f. {***} që vijon nga vol. {***}, f. {***}, sip.16 m², regjist. në datën 22.04.2009. Kjo pasuri është krijuar si shtesë anësore e pallatit ku gjendej pasuria e përshkruar në pikën a), ndërtuar me leje ndërtimi nr. {***}, datë 01.07.1998, e bashkisë Tiranë, në favor të firmës ndërtuese "{***}" shpk, me financim të pronarëve të apartamenteve që përfitojnë nga shtesa.*

21.1. Për pasurinë me sip. 36 m², në rr. “{***}”, Tiranë, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar në mënyrë të pasaktë vlerën e shpenzuar për ndërtimin e pasurisë shtesë me sip. 16 m², si dhe kishte mungesë të burimit të krijimit të kësaj pasurie, për sa i përket blerjes dhe ndërtimit të shtesës, në shumën prej 251.440 lekësh.

21.2. Subjekti i rivlerësimit i kundërshton para Kolegjit konkluzionet e arritura në vendimin objekt shqyrtimi për këtë pasuri, duke pretenduar se Komisioni nuk ka vlerësuar me objektivitet provat dokumentare të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, por as nuk ka marrë në konsideratë kërkimin, qëndrimin dhe shpjegimet e tij, duke mos përfshirë në burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie pjesën takuese të të ardhurave të bashkëshortes, si stomatologe për periudhën 01.01.1998 - 15.03.1998, përpjesëtimore me fitimin e vitit, në shumën prej 216.667 lekësh, si dhe të ardhurat e tij nga bursa në Shkollën e Magjistraturës, në shumën prej 44.610 lekësh.

21.3. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, duke marrë në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin e Komisionit dhe arsyetimin e këtij të fundit në vendim, Kolegji konstatoi se në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, ndryshe nga pretendimet e ngritura në ankim, ka deklaruar të ardhura nga “[...] aktiviteti si stomatologe i bashkëshortes në vitet janar 1996 - dhjetor 1998 [...]”, ndërkohë që nuk ka deklaruar të ardhurat e tjera të pretenduara në ankim nga bursa në Shkollën e Magjistraturës.

²⁹ Të blerë nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.1994.

21.4. Ndryshe nga deklaratat e pasurisë *vetting*, në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, subjekti i rivlerësimi ka deklaruar: “[...] të ardhurat e pagës sime dhe të bashkëshortes si stomatologe [...]”, ndërsa në përgjigje të pyetësorit të datës 18.04.2019, për burimet e krijimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimi ka deklaruar: “[...] për mundësinë financiare për shlyerjen e pjesës takuese, për ndërtimin e shtesës anësore prej 16 m², duhet të mbahen në konsideratë të ardhurat e klinikës dentare në muajt tetor - dhjetor 1997, një pjesë e të ardhurave të saj të vitit 1998 [...]”.

21.5. Nga shqyrtimi i legjislacionit në fuqi lidhur me detyrimin për deklarim të pasurive dhe interesave privatë në kuadër të procesit të rivlerësimi, si dhe të mënyrës së deklarimit, sikurse edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit³⁰, trupi gjykues i Kolegjit vëren sa më poshtë.

21.5.1. Në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, në pikat 1, 2 dhe 3 të tij, parashikohet shprehimisht: “1. Subjektet e rivlerësimi i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. 2. Subjekti dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. [...]. 3. Subjekti i rivlerësimi duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave [...]”.

21.5.2. Në nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikohet se subjekti i rivlerësimi plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të të njëjtit ligj, në të cilën, në informacionin e dhënë në ndihmë të subjekteve deklaruuese, në pjesën që i takon deklarimit të pasurisë nga subjekti i rivlerësimi, thuhet shprehimisht: *Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit të rivlerësimi dhe të familjes së tij [...], burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit, përfshirë interesat privatë që i ka në pronësi ose në përdorim, sipas nenit 3, pikat 9 dhe 11, të ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.* Në fund të këtij materiali informues, në rubrikën me titull “Sanksionet”, përcaktohet: *Mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës së pasurisë mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimi, sipas ligjit [...].*

21.5.3. Në faqen 5 të së njëjtës shtojcë të ligjit nr. 84/2016, që përbën edhe formularin e deklaratës së pasurisë *vetting*, subjektet e rivlerësimi, në kuadër të deklarimit të pasurive dhe interesave të tyre privatë, udhëzohen shprehimisht si vijon: *Përshkruani hollësisht: llojin sipërfaqen adresën [...] pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.*

21.5.4. Referuar nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimi dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, duhet të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

21.5.5. Gjithashtu, në pikën 7 të Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimi dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet shprehimisht: *Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e*

³⁰ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 20/2021 (JR), paragrafi nr. 23.

aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklarojnë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre.

21.6. Në jurisprudencën³¹ e Kolegjit të mbajtur në raste të ngjashme, kontrolli i deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme, u shërben Komisionit dhe Kolegjit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit të rivlerësimit apo mjaftueshmërinë e deklaratimeve të tij. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *Deklarimet e interesave private dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.*

21.7. Në interpretim të dispozitave të mësipërme, qëllimi dhe fryma e Kushtetutës dhe ligjit është e tillë që nga ky proces i rivlerësimit të verifikohen dhe të gjithë ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht apo plotësisht pasuritë e tyre. Ballafaqimi i deklaratimeve periodike me ato të bëra në deklaratën e pasurisë *vetting* në vitin 2017, u jep mundësi institucioneve të rivlerësimit për të arritur në përfundimin nëse është bërë deklarim i saktë ose i pasaktë i pasurisë, është bërë ose jo fshehje e kësaj pasurie, nëse është i justifikuar burimi i të ardhurave dhe pasurisë së deklaruar.

21.8. Komisioni, në përputhje me deklaratimet në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka përfshirë në analizën financiare “Të ardhura nga klinika 1996 - 1998”³² në shumën prej 448.000 lekë, dhe “Paga si ndihmësgjyqtar Kuçovë 1996 - 1998”, në shumën prej 538.560 lekësh, por nuk ka vlerësuar deklaratimin e subjektit të rivlerësimit në pyetësinë e datës 18.04.2019, për të përfshirë në analizë një pjesë të të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortes në vitin 1998, dhe as ka vlerësuar në tërësi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga bursa e Shkollës së Magjistraturës.

21.9. Pavarësisht këtyre rrethanave, Kolegji vlerëson se të ardhurat e pretenduara në ankim përmbushin standardet e ligjshmërisë sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, dhe nga ana tjetër këto pasaktësi në deklarim nuk janë të lidhura me mungesë të burimeve financiare për të justifikuar pasuritë. Në konkluzion të analizës faktike dhe ligjore si më sipër, trupi gjyqësor i Kolegjit vlerëson se të ardhurat e bashkëshortes, si stomatologe për periudhën 01.01.1998 - 15.03.1998, përpjesëtimore me fitimin e vitit në shumën prej 216.667 lekësh, dhe të ardhurat nga bursa në Shkollën e Magjistraturës janë të ardhura nga burim i ligjshëm, që duhet të përfshihen në analizën financiare për krijimin e pasurisë me sip. 36 m², në rr. “{***}”, Tiranë.

21.10. Kolegji vëren se në analizën financiare të kryer në Komision, nuk janë përfshirë të ardhurat e aktivitetit të bashkëshortes nga klinika të vitit 1998, pasi këto të ardhura trupi gjyqësor i Komisionit i ka përfshirë në analizën financiare për burimin e krijimit të depozitës 4.000.000 lekë, sikurse rezulton nga rezultatet e hetimit³³, ndërsa subjekti i rivlerësimit pretendon që për krijimin

³¹ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit: nr. 6/2018 (JR), paragrafi nr. 14; nr. 7/2018 (JR), paragrafët nr. 73, 74; nr. 8/2018 (JR), paragrafi nr. 43; nr. 9/2018(JR), paragrafi nr.42; nr. 10/2018(JR), paragrafi nr. 67; nr. 12/2018(JR), paragrafi nr. 24.11; nr. 9/2019(JR), paragrafi nr.10.1.1; nr. 19/2019(JR), paragrafi nr. 22.4, nr. 12/2021(JR), paragrafi nr. 24.4.

³² Referuar tabelës nr. 1 në vendimin nr. 166, datë 21.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

³³ Poshtëshënimi nr. 69, në f. 41: “Viti 1998 është përfshirë në burimin e krijimit të depozitës 4.000.000 lekë për pasurinë nr. 3, pasi kjo depozitë është çelur në këtë vit”.

e kësaj depozite të llogariten të ardhurat që bashkëshortja kishte krijuar pas datës 15.03.1998. Kolegji vëren se analiza financiare në Komision është kryer në total për vitet 1996 - 1998, duke përfshirë blerjen e pasurisë me sip. 20 m²³⁴ në vitin 1997, ekuivalenti në shumën prej 980.000 lekësh dhe gjithashtu ndërtimin e shtesës me sip. 16 m² në vitin 1998, në vlerën prej 298.770 lekësh.

21.11. Kolegji vlerëson se në analizën financiare për blerjen e pasurisë me sip. 20 m², në datën 27.08.1997, në vlerën prej 980.000 lekësh dhe ndërtimin e shtesës me sip. 16 m² në vitin 1998, në vlerën prej 298.770 lekësh, duhet të përfshihen të ardhurat e bashkëshortes si stomatologe për periudhën 01.01.1998 - 15.03.1998, përpjesëtimore me fitimin e vitit në shumën prej 216.667 lekësh, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, sikurse duhet të përfshihen edhe të ardhurat nga bursa në Shkollën e Magjistraturës, në shumën prej 44.610 lekë.

21.12. Në përfundim, Kolegjit i rezulton se duke përfshirë në të ardhura të ligjshme, sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, edhe të ardhurat e bashkëshortes si stomatologe për periudhën 01.01.1998 - 15.03.1998, përpjesëtimore me fitimin e vitit në shumën prej 216,667 lekësh, si dhe të ardhurat nga bursa në Shkollën e Magjistraturës, në shumën prej 44.610 lekësh, subjekti i rivlerësimit kishte mundësi për të justifikuar me burime të ligjshme blerjen e pasurisë me sip. 20 m², në datën 27.08.1997, në vlerën prej 980.000 lekësh, dhe ndërtimin e shtesës me sip. 16 m² në vitin 1998, në vlerën prej 298.770 lekësh.

22. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartamentin me sip. 116 m², në rr. ““{***}””, Tiranë, të blerë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.11.2000, nga shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, me vlerë 3.000.000 lekë, si dhe shpenzime pas blerjes 1.000.000 lekë për arredimin e tij³⁵, pjesa takuese 100%, 50% + 50%, me burim krijimi: “Në datën 08.08.2000 u likuidua depozita prej 4.000.000 lekësh, në {***}, Agjencia nr. {***}, nr. {***}, depozitë e krijuar prej: a) të ardhurave nga aktiviteti si stomatologe e bashkëshortes në periudhën janar 1999 - gusht 2000; b) shitjes së apartamentit të përfituar nga privatizimi, 1 + 1, të ndodhur në lagjen “{***}”, Kuçovë, sipas kontratës not. nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.11.1998, në vlerën 850.000 lekë”. Në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, është deklaruar: “Apartament 2 + 1, 116 m². Vlera 4.000.000 lekë. Pjesa takuese 50% + 50%. Burimi: Shitja e banesës 1+1 në lagjen “{***}”, Kuçovë. Likuidim i librezës së kursimit nr. {***} të Agjencisë nr. {***}”.

22.1. Komisioni, për këtë pasuri, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit kishte mungesë të burimit të krijimit të saj, në shumën prej 186.778 lekë.

22.2. Subjekti i rivlerësimit i kundërshton para Kolegjit konkluzionet e Komisionit, duke pretenduar se në analizën financiare të kryer gjatë hetimit në Komision, nuk janë përfshirë të ardhurat nga klinika dentare për periudhën maj - 31 korrik 2000, në shumën 312.188 lekë³⁶, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga bursa e Shkollës së Magjistraturës për periudhën 1999 - 2000, në shumën totale 397.200 lekë, si dhe të ardhurat nga interesat e depozitës në periudhën 03.05.2000 - 08.08.2000, në shumën 77.500 lekë, dhe gjithashtu subjekti i rivlerësimit

³⁴ Sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.1997, çmimi 7.000 USD.

³⁵ Rivlerësim në datën 17.10.2011, në vlerën e tregut 10.440.000 lekë.

³⁶ Referuar analizës së subjektit në ankim, në faqen 41 të tij, tabela, pikat 4 dhe 5 të saj.

pretendon se nuk janë përfshirë në analizën financiare të Komisionit shpenzimet e jetesës për periudhën 1999 - 2000³⁷.

22.3. Në kuadër të këtij shkaku ankimi, duke ballafaquar deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, rezulton se në strukturën e burimit të krijimit të kësaj pasurie, në deklaratën e pasurisë *vetting* subjekti i rivlerësimi ka deklaruar se: “[...] u likuidua depozita prej 4.000.000 lekësh, në {***}, Agjencia nr. {***}, nr. {***}, depozitë e krijuar prej: a) të ardhurave nga aktiviteti si stomatologe e b/shortes në periudhën janar 1999 - gusht 2000; b) shitjes së apartamentit të përfituar nga privatizimi, 1+1, "{***}" Kuçovë, sipas kontratës not. nr. {***} rep., {***} kol., dt. 09.11.1998, në vlerën 850.000 lekë [...]”, ndërsa në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, ka deklaruar: “Likuidim i librezës së kursimit nr. {***} të Agjencisë nr. {***}”. Ndërkohë që në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimi ka detajuar të ardhurat për krijimin e depozitës bankare, në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003 një detajim i tillë nuk është kryer, dhe përfundimisht në ankim subjekti i rivlerësimi pretendon përfshirjen e të ardhurave të bursës nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën 1999 - 2000, në shumën totale prej 397.200 lekësh, të ardhura nga klinika e bashkëshortes për vitin 1998 [pas 15.03.1998, pasi deri në këtë periudhë u përfshinë në analizën e pasurisë sa më sipër] dhe për vitin 2000, si dhe të ardhurat nga interesat e depozitës në periudhën 03.05.2000 - 08.08.2000.

22.4. Pavarësisht se në deklaratën e pasurisë *vetting* subjekti i rivlerësimi ka detajuar të ardhurat për krijimin e depozitës bankare prej 4.000.000 lekësh, që nuk ishte detajuar në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, dhe në ankim subjekti i rivlerësimi pretendon përfshirjen edhe të të ardhurave të tjera, sikurse të ardhurat nga bursa e Shkollës së Magjistraturës për periudhën 1999 - 2000, në shumën totale prej 397.200 lekësh, të ardhurat nga klinika e bashkëshortes për vitin 1998 [pas 15.03.1998, pasi deri në këtë periudhë u përfshinë në analizën e pasurisë sa më sipër] dhe për vitin 2000, si dhe të ardhurat nga interesat e depozitës në periudhën 03.05.2000 - 08.08.2000, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimi ka deklaruar se për krijimin e kësaj pasurie është përdorur likuidimi i depozitës bankare, deklarim që është i njëjtë si në deklaratën e pasurisë *vetting*, ashtu edhe në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, dhe nga ana tjetër, të ardhurat e pretenduara në ankim përmbushin standardet e ligjshmërisë sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, Kolegji vlerëson të shqyrtojë në themel mundësinë e justifikimit të krijimit me burime të ligjshme të depozitës së likuiduar.

22.5. Kolegji vëren se nëpërmjet analizës financiare të kryer në Komision, është vlerësuar mundësia e krijimit të depozitës 4.000.000 lekë deri në datën 08.08.2000, si pasuri e deklaruar që është përdorur më tej si burim për krijimin e pasurisë apartament në rr. “{***}”, Tiranë. Rezulton se Komisioni në analizë ka vlerësuar mundësinë e krijimit të depozitës prej 4.000.000 lekësh, vetëm duke përfshirë në analizë të ardhurat nga klinika e bashkëshortes në vitet 1998 -1999, ndërsa për vitin 2000 deri në muajin prill dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në Kuçovë, sipas deklarimeve të subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe interesat bankarë deri në datën 03.05.2000, pa përfshirë shpenzimet e jetesës, duke rezultuar mungesa e burimeve të ligjshme me diferencë prej (-) 186.778 lekësh.

22.6. Në kuadër të shkakat të ankimit të subjektit të rivlerësimi, Kolegji vlerësoi krijimin e depozitave pranë {***}, në raport me deklaratimet të subjektit të rivlerësimi, si burim për krijimin e

³⁷ Referuar analizës së subjektit në ankim, në faqen 41 të tij, tabela, te “Total Shpenzimet”.

depozitës 4.000.000 lekë, deklaruar më tej si burim për krijimin e pasurisë apartament në rr. “{***}”, Tiranë.

22.7. Nga shpjegimet dhe dokumentet e dorëzuara në Komision nga subjekti i rivlerësimit³⁸, si dhe nga shkresat e {***}, rezulton se:

22.8. Në datën 09.04.1998, personi i lidhur, znj. L. B., ka çelur depozitën në shumën prej 100.000 lekësh, në të cilën, në vijim, ka kryer depozitime pothuajse çdo muaj, dhe në datën 09.11.1998 ka tërhequr nga depozita shumën prej 650.000 lekësh, e cila duket se është përdorur, si sqaruar dhe nga subjekti në pyetësor, për krijimin e depozitës në të njëjtën datë, në emër të L. B., së bashku me të ardhurat nga shitja e apartamentit në Kuçovë, në shumën prej 850.000 lekësh, pra në total në shumën prej 1.500.000 lekësh, e cila është mbyllur më pas në datën 01.12.1999, kur kishte arritur vlerën prej 1.931.024 lekësh. Prej kësaj shume, sipas sqarimeve të subjektit të rivlerësimit, në të njëjtën datë është depozituar në depozitën më lart shuma prej 1.921.000 lekësh. Pas vijimit të depozitimeve në depozitën nr. {***}, kohë pas kohe, është tërhequr në datën 03.05.2000, totali i akumuluar në shumën prej 3.873.673 lekësh.

22.9. Me këtë shumë, sipas sqarimeve të subjektit në pyetësor, në të njëjtën datë me tërheqjen, 03.05.2000, është çelur depozita në emër të Gurali Brahimllari, në shumën 3.900.000 lekë. Kjo depozitë, sipas shënimeve në skedën e saj dhe shpjegimeve nga shkresat e {***}, nga dega Kuçovë është transferuar në datën 23.05.2000 në degën {***},{***}, por nuk ka mundur të gjendet informacion i arkivuar për depozitën, siç shprehet banka në përgjigjen e saj, ndoshta për shkak të afatit të shkurtër të depozitës.

22.10. Sipas mandatarëtimit të {***}³⁹, subjekti Gurali Brahimllari ka depozituar shumën prej 30.100 lekësh, me përshkrimin: “[...] Në kredi: Agj. 1, numri llogarisë: {***}, Për: Dep. 3 muaj [...]Nr. {***}. Vendi: Tiranë. Data: 03.08.2000 [...]”, ndërsa sipas mandat shlyerje depozitash⁴⁰ të {***}, {***}, datë 08.08.2000, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shlyer librezën nr. {***}, duke tërhequr shumën prej 4.000.500 lekësh.

22.11. Sipas kronologjisë së krijimit të depozitës, referuar analizës së kryer nga Komisioni duke konsideruar të ardhurat nga aktiviteti deri në prill 2000 dhe të ardhurat nga interesat e depozitave prej 516.497 lekësh, që u takojnë depozitave deri më 03.05.2000, ndryshimet që ka pësuar depozita deri në tërheqje, datë 08.08.2000, në shumën 4.000.000 lekë, shtimi i depozitës nga kalimi në emër të bashkëshortes në emër të subjektit prej 26.327 lekësh [mbyllur në shumën 3.873.637 lekë në emër të bashkëshortes në 03.05.2000 dhe hapur në të njëjtën datë në emër të subjektit prej 3.900.000 lekësh], si dhe shtimi që ka pasur depozita në emër të subjektit prej 100.000 lekësh [nga 3.900.000 lekë hapur në 03.05.2000 dhe tërhequr në 08.08.2000 në shumën 4.000.000 lekë], pra në total prej 126.327 lekësh. Në analizën financiare të kryer në Komision, **nuk janë përfshirë të ardhurat pas muajit prill 2000 për ndryshimet e ndodhura të depozitës në periudhën prill 2000 – gusht 2000 kur është tërhequr përfundimisht, të ardhura të cilat, sikurse ka pretenduar dhe subjekti i rivlerësimit, vijnë nga aktiviteti i bashkëshortes për periudhën 1 maj – 31 korrik 2000, gjithashtu nuk janë përfshirë dhe interesat bankarë për periudhën 03.05.2000 - 08.08.2000.**

³⁸ Pyetësori nr. 2 datë 04.02.2019, pyetja 23 dhe shkresa e {***} nr. {***} prot, datë 31.01.2019 dhe pyetësori nr. 2 shtesë, datë 28.02.2019 dhe shkresa e {***} datë 27.02.2019 dhe akteve bashkëlidhur.

³⁹ Nr. {***} datë 03.08.2000, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr.2 datë 04.02.2019 (Fashikulli 17, faqe 3094).

⁴⁰ Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 04.02.2019 (fashikulli 17, pjesa mbrapa e faqes 3093).

22.12. Në vlerësim të pretendimit të subjektit për të ardhura të papërllogaritura për mundësinë e krijimit të depozitës, Kolegji vlerëson se Komisioni duhej të kishte vlerësuar fillimisht mundësinë e krijimit me të ardhura të ligjshme të kësaj depozite deri në datën 03.05.2000⁴¹ e më pas të vlerësohej mundësia e shtimit të saj me kreditimet respektive dhe interesat bankarë deri në gusht të vitit 2000, kur shumata e likuiditeteve të gjendura në të është tërhequr për t'u përdorur si burim për financimin e apartamentit të ndodhur në rrugën ““{***}””, Tiranë. Nga një verifikim i këtyre mundësive, i kryer në Kolegji, rezultoi se subjekti nuk kishte mundësi të krijonte këtë depozitë me të ardhura të provuara si të ligjshme deri në mars të vitit 2000⁴², por në kushtet kur Komisioni nuk e ka analizuar këtë aspekt dhe në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të burimeve të subjektit me burim kryesor të ardhura që vijnë nga aktiviteti i bashkëshortes, në periudhën për të cilën nuk kishte detyrime për deklarim, si edhe në zbatim të parimit të mosrëndimit të pozitës, Kolegji nuk e mori në konsideratë këtë situatë në vlerësimin e shkakut të ankimit të ngritur në lidhje me konkluzionin e Komisionit për këtë pasuri, duke analizuar vetëm mundësinë e subjektit për të krijuar me të ardhura të ligjshme vetëm shtesat e depozitës dhe interesat bankarë deri në gusht të vitit 2000⁴³.

22.13. Për krijimin e depozitës finale prej 4.000.000 lekësh ({***}) në emër të subjektit, tërhequr më 08.08.2000, në vlerësim të dinamikës së rritjes së saj, sipas vlerësimit në Kolegji, rezultoi se nga tërheqja më 03.05.2000, prej 3.873.673 lekësh në emër të bashkëshortes dhe kalimit në të njëjtën datë në emër të subjektit në shumën 3.900.000 lekë, shtimin e depozitës me + 26.327 lekë, subjekti mund ta krijonte nëse përllogariten të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes për muajin prill 2000 (prej 104.063 lekësh⁴⁴).

22.14. Në vijim të kësaj përllogaritjeje, subjekti mund të krijonte me të ardhura të ligjshme edhe shtimin e depozitës në emër të subjektit ({***}) nga momenti i hapjes, prej 3.900.000 lekësh, në 03.05.2000, deri në momentin e tërheqjes, 08.08.2000, në shumën 4.000.000 lekë, pasi rritja prej 100.000 lekësh, vjen si rezultat i interesave të përfituar, 77.500 lekë, pra të ardhura të ligjshme të provuara sipas dokumentacionit, si të ardhura të Kartelës Depozitë Kursimi, depozita {***}⁴⁵,

⁴¹ Data e mbylljes së depozitës në emër të bashkëshortes së subjektit dhe çelja e depozitës në emër të tij.

⁴² Rezultoi se deri në datën 09.03.2000, depozita është shtuar me depozitim të fundit, pra me të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes, dhe më tej është shtuar nga kreditimi i interesave të depozitës.

⁴³ Për krijimin e depozitës 3.873.673 lekë (nr. {***}) deri më 03.05.2000 në emër të bashkëshortes së subjektit, në analizë të të ardhurave të ligjshme për krijimin e pasurisë, duke konsideruar pretendimin e subjektit për konsiderimin e të ardhurave të klinikës të vitit 1998, pas 15.03.1998 (prej 758.333 lekësh), të ardhurat e tjera prej 2.421.972 lekësh⁴³, përllogaritur nga Komisioni, si dhe nga subjekti në të njëjtën vlerë, por për të ardhurat e vitit 2000 duhet të konsideroheshin deri në 09.03.2000⁴³ pasi deri në atë moment depozita është shtuar me depozitim të fundit (pra, me të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes) më tej është shtuar nga kreditimi i interesave të saj (përfshirë në analizë më sipër), për të mos përpjesëtuar të ardhurat në bazë ditore⁴³ dhe duke konsideruar të ardhurat nga aktiviteti i klinikës deri në fund të muajit mars 2000, pra për periudhën janar – mars 2000 prej 312.188 lekësh, pra për një total të ardhurash prej 3.492.493 lekësh nuk do të mbulonte krijimin e depozitës prej 3.873.673 lekësh deri në 03.05.2000, për një diferencë negative – 381.181 lekë. Por për mundësinë e krijimit të depozitës 3.873.673 lekë (nr. {***}) në emër të bashkëshortes, do të konsideronim përveç sa trajtuar më lart, dhe të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga Shkolla e Magjistraturës, pavarësisht se ato nuk janë deklaruar si burim i krijimit të depozitës në deklaratën e pasurisë vetting, si pretenduar prej tij në ankim (prej 308.985 lekësh⁴³), por duke përllogaritur dhe shpenzimet e jetesës (prej 150.000 lekësh⁴³) si pretenduar e përllogaritur prej subjektit në ankim, sërish do të rezultonte me diferencë negative prej -222.196 lekësh.

⁴⁴ E ardhura vjetore prej 1.248.750 lekësh, përpjesëtuar për 12 muaj ose pretenduar prej subjektit në ankim për të ardhura të klinikës janar – prill 2000 prej 416.250 lekësh e proporcionale për një muaj, prill 2000.

⁴⁵ Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 04.02.2019 (fashikulli 17, faqe 3104), sjellë nga {***}, subjektit me nr. {***} prot., datë 31.01.2019.

pretenduar dhe nga subjekti në ankim të papërfshira nga Komisioni në analizën e tij. Si dhe depozitimi prej 30.100 lekësh më 03.08.2000, sipas mandatarkëtimit të {***}⁴⁶, të cilat subjekti mund t'i mbulonte me të ardhura të ligjshme duke vlerësuar burimin e krijimit të ardhurat e bashkëshortes nga klinika për periudhën maj - korrik 2000 (prej 312.188 lekësh⁴⁷) pretenduar dhe nga subjekti në ankim.

22.15. Në përfundim, duke abstraguuar krijimin e depozitës deri më 03.05.2000 dhe duke vlerësuar shtimet në depozitën bankare, në raport me të ardhurat nga klinika dentare për periudhën maj - 31 korrik 2000, të ardhurat e bursës nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën përkatëse dhe të ardhurat nga interesat e depozitës në periudhën 03.05.2000 - 08.08.2000, si dhe llogaritjen e shpenzimeve të jetesës, Kolegjit i rezulton se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi për të justifikuar burimin e krijimit të apartamentit me sip. 116 m², në rr. “{***}”, Tiranë.

23. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, në burimet e krijimit të apartamentit, me garazh dhe papafingo, me sip. 250 m², në rr. “{***}”, kompleksi “{***}”, “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e njësisë, ish-klinika dentare, Kuçovë, me sip. 38,25 m², përkatësisht: “[...] 3. Shitja totale e pasurisë nr. {***}, me sip. 38,25 m², (ish-klinika dentare Kuçovë, ndërtuar sipas leje shesh ndërtimi nr. {***}, dt. 14.02.1995, e lejes së ndërtimit nr. {***}, dt. 30.03.1995, në funksion të punës si dentiste të bashkëshortes në qershor 1995), me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 27.12.2012, së bashku me truallin 38,25 m² (i cili u ble nga subjekti me kont. nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 14.08.2012). Çmimi i shitjes së ish-klinikës dentare, 4.000.000 lekë, prej të cilave 1.500.000 lekë ishin paguar nga blerësi A. S., në tetor 2003 (deklaruar në mars 2004), ndërsa pjesa e mbetur u kompensua me vlerën e 19.000 eurove, marrë hua në dhjetor 2008, për apartamentin në “{***}”.

23.1. Në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, është deklaruar: “Klinikë dentare (dhomë, aneks, banjë, korridor + bodrum), 50 m². Vlera: 1.800.000 lekë. Lagja “{***}”, pranë Këshillit të Rrethit Kuçovë. Viti 1995. Ndërtim nga themeli. Kontributi financiar e fizik i familjes. Shënim: pasuria klinikë dentare në Kuçovë i është shitur në fakt kunatit A. S., por çmimi i shitjes nuk është likuiduar dhe kontrata nuk është bërë ende”. Dhe “Librezë kursimi, nr. {***} datë 23.10.2003, {***}. Vlera 1.500.000 lekë. Burimi: Marrë nga kunati [...]”⁴⁸ si pjesë e marrëveshjes sonë për shitjen e pronës klinikë dentare në Kuçovë”, ndërsa te pjesa e detyrimeve financiare: “Marrë nga kunati [...] për efekt shitje të klinikës dentare në Kuçovë. Vlera 1.500.000 lekë, Kuçovë, lagjja “{***}”, pranë n/prefekturës. Shitje e klinikës dentare si godinë”.

23.2. Në deklaratën periodike/vjetore 2012, është deklaruar: “Me kontratën nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 14.08.2012, u ble nga Ministria e Financave sipërfaqe trualli prej 38,25 m² në Kuçovë (për klinikën e ndërtuar me leje ndërtimi në vitin 1995). U regjistrua në ZRPP Kuçovë, pasuria ish-klinikë dentare, me nr. {***}, u bë bashkimi i saj me truallin e blerë nga Ministria e Financave, si dhe rivlerësimin e saj duke paguar vlerën 1%. Vlera 44.064 lekë, si dhe 20.000 lekë bono privatizimi. Ndërtuar në vitin 1995 pa preventiv të saktë. Pagova tarifën e rivlerësimit në shumën 36.000 lekë”. Dhe gjithashtu: “Pakësuar: Pas përfundimit të procedurës së blerjes së truallit dhe të regjistrimit në ZRPP Kuçovë, u shit, u tjetërsua me kontratë shitje pasurie nr. {***},

⁴⁶ Nr. {***}, datë 03.08.2000, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 04.02.2019 (fashikulli 17, faqe 3094).

⁴⁷ E ardhura vjetore prej 1.248.750 lekësh, përpjesëtuar për 12 muaj, shumëzuar me 3 muaj, ose pretenduar prej subjektit në ankim për të ardhura të klinikës 1 - 3.05.2000 dhe 4.5.2000 - 31.07.2000 për një total prej 312.188 lekësh.

⁴⁸ I cili në vendim identifikohet me emrin “A. S.”, sipas ndryshimit të emrit dhe mbiemrit më vendimin nr. {***}, datë 17.11.1995, të Këshillit të Bashkisë Kuçovë.

datë 27.12.2012, ish-klinika dentare në Kuçovë, te blerësit A. S.. Vlera: 4.000.000 lekë, prej të cilave pjesa prej 2.500.000 lekësh u llogarit në kompensim të detyrimit tim të marrë në vitin 2008, në vlerën 19.000 euro, për pagimin e kësteve të shtëpisë së re, në “{***}”.”

23.3. Duke i vlerësuar në tërësi pasuritë e krijuara para vitit 2003, trupi gjykues i Komisionit ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të të ardhurave në shumën 951.756 lekë për të justifikuar të gjitha pasuritë e krijuara para vitit 2003, përfshirë edhe ndërtimin e klinikës dentare në qytetin e Kuçovës në vitin 1995, si dhe ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e shpenzuar për ndërtimin e kësaj klinike.

23.4. Subjekti e kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se ka përjashtuar si burim të ligjshëm në krijimin e kësaj pasurie: a) të ardhurat e bashkëshortes si stomatologe në qendrën stomatologjike në Kuçovë⁴⁹, për të gjithë periudhën e punës së saj, deri më 31.03.1994⁵⁰; b) të ardhurat e bashkëshortes si person fizik, në periudhën prill - dhjetor 1994⁵¹, që përkon me vitin e parë të punës si stomatologe në profesion të lirë, për të cilat subjekti në ankim shprehet se Komisioni ka përjashtuar nga llogaritja të ardhurat e bashkëshortes për periudhën e tremujorit të katërt të vitit 1994, ndonëse për të u provua pagimi i tatimit të përcaktuar nga organi tatimor, e është dorëzuar mandatpagesa për vlerën e këtij tatimi; c) të ardhurat e shërbimit të ortopedisë dentare⁵². Sipas subjektit të rivlerësimit, argumenti i përdorur nga Komisioni, se të ardhurat e klinikës dentare për vitin 1994 (si edhe për vitin 1995) neutralizojnë shpenzimet familjare, është jo vetëm në kundërshtim me parimin e objektivitetit, por edhe jologjik e kontradiktor me vetë përmbajtjen e arsytimit të metodologjisë së përdorur në Komision se: “[...] për periudhën para vitit 1996, shpenzimet (për jetesë) konsiderohen në masën 40% të të ardhurave”, me argumentin se këtë vlerë e ka pretenduar për të ardhurat nga paga në shtet dhe jo nga aktiviteti tregtar, ndërsa kostoja e ndërtimit duhej të llogaritej sipas VKM-së nr. 815/1996.

23.5. Bazuar në kuadrin ligjor që normon procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se subjektet e rivlerësimit mbajnë përgjegjësi për saktësinë, vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve dhe gjendjes së pasurisë, deri në dorëzimin e deklaratës e pasurisë *vetting*⁵³, dhe duke qenë se vlera e përfituar nga tjetërsimi i kësaj pasurie është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në strukturën e çmimit të apartamentit, me garazh dhe papafingo, me sip. 250 m² në rr. “{***}”, kompleksi “{***}”, “{***}”, Tiranë, burimi i krijimit të kësaj pasurie është marrë në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit, në drejtim të mjaftueshmërinë së deklaramit dhe gjendjes së pasurisë, deri në dorëzimin e deklaratës e pasurisë *vetting*.

⁴⁹ Referuar analizës së subjektit në ankim në faqen 53 të tij, tabela, ka konsideruar të ardhura 30.000 lekë.

⁵⁰ Të ardhurat e pagës së saj në shtet, në periudhën 01.01.1994 - 31.03.1994.

⁵¹ Referuar analizës së subjektit në ankim, në faqen 53 të tij, tabela, pika 1 e saj, ka konsideruar të ardhura 112.684 lekë.

⁵² Të cilat subjekti i sjell në vëmendje të Kolegjit se, si në deklaratën e pasurisë *vetting*, edhe gjatë procesit të rivlerësimit, ka pretenduar e pretendon se bashkëshortja e tij, si tatimpaguese, në vitet 1994 - 1997, nuk ka deklaruar në organin tatimor këto të ardhura, të cilat zënë një vend të rëndësishëm, në fitimet neto të klinikës, mosdeklarimi prej bashkëshortes i vlerës së shërbimit të ortopedisë në të ardhura të tatueshme për vitet 1994 - 1995 (por edhe për periudhën e viteve 1996 - 1997), për të cilën ka pasur fajin e përgjegjësi edhe administrata tatimore. E lidhur me kohën e largët dhe vitet e para të ekonomisë së tregut në Shqipëri, përbëjnë rrethana të mjaftueshme për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve në krijimin e kësaj pasurie. Gjithashtu subjekti thekson se kjo pasuri është krijuar në rrugë ligjore, pa përfitime preferenciale të subjektit për shkak të detyrës dhe se të ardhurat e shpenzuara nuk kanë asnjë lidhje me funksionin e tij, për të cilin po kryhet rivlerësimi.

⁵³ Vendimi nr. 8/2021, paragrafi 26.3, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (subjekt rivlerësimi I. Mulkurti).

23.6. Në lidhje me koston e ndërtimit të kësaj pasurie, Komisioni ka vlerësuar se: “Për sa i përket pretendimit të vlerës së investimit për këtë pasuri, trupi gjykues vëren se subjekti është kontradiktor në deklaratimet e tij kur kërkon që të konsiderohet vlera 489.026 lekë e ndërtimit, sipas koston së parashikuar në VKM-në nr. 815, datë 9.12.1996 (akt të cilin e depozitoi vetëm pas dërgimit të rezultateve të hetimit), ndërsa gjatë hetimit administrativ, edhe në përgjigje të pyetësorëve, ka deklaruar se kostoja e përlllogaritur në rivlerësimin nga ZVRPP-ja Kuçovë, është bazuar në vlerën 747.596 lekë. Nën këtë arsyetim, trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe as të bazuara në prova”.

23.7. Qëndrimet e ndryshme që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision, Kolegji i vlerëson duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Kolegjit, përkatësisht në vendimin (JR) 15/2019, tek i cili Kolegji ka shprehur se për përlllogaritjen e kostove të banesës: “Referimi që Komisioni ka bërë te kostoja mesatare e ndërtimit, e përcaktuar ndër vite prej EKB-së, çmohet si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi, të sjellë prej subjektit të rivlerësimit”, por që përfaqëson në çdo rast standardin ligjor minimal në këtë kuptim. Për sa u përket deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, i cili ka referuar në një vlerë kostoje më pak se 800.000 mijë lekë, dhe rivlerësimit të kryer nga ZVRPP Kuçovë në shumën prej 747.596 lekë, Kolegji vlerëson se duhet pranuar vlera e përlllogaritur nga ZVRPP Kuçovë, përderisa ajo përfron me vlerën e deklaruar prej subjektit të rivlerësimit. Pretendimi i subjektit në vijim të hetimit, sidomos pas njohjes së rezultateve të hetimit për mungesë të burimeve financiare se duhej të referohej te kosto sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 815/1996, nuk gjendet i arsyeshëm dhe i bazuar prej Kolegjit. Referimi te kostoja e standardizuar sipas vlerave të VKM-së, është përdorur nga Kolegji në funksion të përcaktimit të një standardi ligjor bazik, në rastet kur subjektet e kanë të pamundur të provojnë shpenzime për kosto më të ulët se ajo që rezultojnë sipas këtyre kushteve, por ky rregull nuk mund të zbatohet në të kundërt, kur vetë subjektet referojnë në kosto më të larta për ndërtimin e objekteve në pronësi të tyre, sepse logjikisht një ndërtim mund të kushtojë më shumë se niveli bazik i përcaktueshëm sipas rregullave të standardizuara për përcaktimin e saj. Në këto kushte, Kolegji konsideroi në analizën financiare vlerën e përcaktuar nga ZVRPP-ja, si vlerën më të afërt me deklaratimin që kishte bërë vetë subjekti për përcaktimin e koston së ndërtimit për këtë pasuri.

23.8. Për sa i përket analizës financiare të kryer në Komision, rezultojnë që në këtë analizë të jenë përfshirë të ardhurat nga klinika dentare në vitin 1995, nga paga e subjektit të rivlerësimit në vitet 1994 dhe 1995, me qëllim për të vlerësuar përballimin me të ardhura të ligjshme të ndërtimit të pasurisë në Kuçovë, në vlerën prej 800.000 lekësh, dhe se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me diferencë negative prej (-) 513.538 lekësh.

23.9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në analizën e kryer në Komision, nuk janë përfshirë: a) të ardhurat e klinikës dentare për vitin 1994, në shumën prej 112.684 lekësh, për periudhën prill 1994 – dhjetor 1994; b) të ardhurat nga paga e bashkëshortes së subjektit për vitin 1994, në shumën prej 30.000 lekësh; dhe c) se ka përlllogaritur dhe konsideron në analizë dhe shpenzime jetese prej 112.684 lekësh, dhe duke llogaritur koston e ndërtimit në shumën prej 489.026 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë, me diferencë prej (-) 172.564 lekësh.

23.10. Në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për të ardhura të munguara në analizën financiare të kryer në Komision, Kolegji vëren se lidhur me të ardhurat e klinikës në vitin

1994, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ato duhet të ishin llogaritur në shumën prej 112.684 lekësh, duke paraqitur fletë njoftimi të tatimit dhe mandatpagesa që i përkasin vitit 1994, por nga të cilat rezultojnë vetëm vlera e tatimit, por jo të ardhurat mbi të cilat tatimi ishte llogaritur, dhe as subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë sqarime për vlerën e llogaritur prej tij. Nga shkresa nr. {***} prot., datë 11.04.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimpaguesve, në lidhje me detyrimet tatimore dhe shkallën tatimore për çdo tatim për subjektin person fizik, për vitin 1994, për tatimin mbi biznesin e vogël, bazuar në ligjin nr. 7679, datë 03.03.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël” (në vijim “ligji nr. 7679/1993”), sipas nenit 2 të të cilit parashikohet se: “[...] Tatimi llogaritet me tarifa proporcionale mbi të ardhurat që realizohen nga shitja ose kryerja e shërbimeve [...]”, ndërsa sipas nenit 3, pika “c” parashikohet se: “[...] avokatët, mjekët e stomatologët, 8 për qind [...]”. Sipas akteve në dosjen e ILDKPKI-së⁵⁴, për një total tatimi të paguar për vitin 1994, prej 2.456 lekësh, dhe tarifa si dhe përqindja e tatimit 8% (2.456 lekë/8% = 30.700 lekë), vlera prej 30.700 lekësh rezultojnë të ketë qenë e ardhura e realizuar nga shitja ose kryerja e shërbimeve, xhiro e realizuar. Në kushtet e përfshirjes në analizë të vlerës totale të xhiros për vitin 1994, pa zbritur shpenzimet për të përlllogaritur fitimin e vitit 1994, vlera prej 30.700 lekësh është në çdo rast vlera me e lartë e përfituar prej bashkëshortes në këtë periudhë, vlerë e cila u konsiderua në analizë.

23.11. Në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për të ardhura të munguara në analizë nga paga e bashkëshortes në vitin 1994, subjekti i rivlerësimit në ankim, ka pretenduar se ato duhet të ishin llogaritur në shumën prej 30.000 lekësh, duke paraqitur librezën e punës së bashkëshortes, sipas së cilës ka punuar si stomatologe në Kuçovë, për periudhën 22.08.1988 - 14.04.1994, dhe vendimin nr. {***}, datë 22.08.1988, të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit Berat për emërimin si stomatologe në Klinikën Stomatologjike Kuçovë, por nga të cilat rezultojnë vetëm punësimi në profesionin e stomatologes, por jo të ardhurat e realizuara, dhe as subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë sqarime për vlerën e llogaritur prej tij. Kolegji vëren se në pyetësorin e datës 04.02.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se paga bruto mbi të cilën janë derdhur kontributet për periudhën korrik 1993 - mars 1994, ka qenë 10.343 lekë që, e llogaritur për tre muaj, rezultonte se duhej të kishte realizuar të ardhura në shumën prej 31.029 lekësh. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, për periudhën e punës 22.08.1987 - 14.04.1994, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura për bashkëshorten në total, përafërsisht 500.000 lekë, që e llogaritur përafërsisht për 80 muaj, do të rezultonte se të ardhurat nga paga kanë qenë përafërsisht 6.289 lekë/muaj, për pasojë në një shumatorë prej 22.013 lekësh për periudhën 01.01.1994 - 14.04.1994. Në vijim të kësaj analize, pavarësisht diferencave në vlera për këto të ardhura mes deklarimeve të subjektit të përshkruara më lart, Kolegji vlerësoi se duhet pranuar vlera e pretenduar në ankim nga subjekti i rivlerësimit prej 30.000 lekësh, përderisa ajo përfaqëson me vlerën e deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në pyetësor dhe që rezultojnë e përfaqësojnë me deklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting*.

23.12. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, duke përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga klinika në vitin 1994, në shumën prej 30.700 lekësh, pagën e bashkëshortes në vitin 1994 në

⁵⁴ Fletë njoftim tatimi, datë 07.06.1994, për tatimpaguesen L. B., për 3-mujorin II, vlera 796 lekë dhe mandatarkëtimi nr. {***}, me vlerë 796 lekë, datë 07.06.1994, e L. B.; fletë njoftim tatimi, datë 25.10.1994, për tatimpaguesen L. B., për 3-mujorin III, vlera 1.210 lekë dhe mandatarkëtime me vlerë 1.210 lekë, datë 25.10.1994, të L. B., si dhe mandatarkëtime me vlerë 450 lekë, datë 12.01.1995, të L. B.

shumën prej 30.000 lekësh, dhe të ardhurat e tjera⁵⁵ në shumën prej 286.462 lekësh, në total prej 347.162 lekësh, subjekti i rivlerësimit sërish nuk do të mbulonte koston e ndërtimit prej 747.596 lekësh, sipas përcaktimit të koston nga ZVRPP Kuçovë, nëpërmjet rivlerësimit të pasurisë në vitin 2012⁵⁶. Referuar rivlerësimit të pasurisë në vitin 2012, të kryer nga ZVRPP Kuçovë, kostoja e ndërtimit për vitin 1996, ishte në vlerën prej 19.545 lekë/m², që në total për sip. prej 38,25 m², kostoja e ndërtimit të ish-klinikës dentare, Kuçovë, ishte në vlerën prej 747.596 lekësh. Subjekti i rivlerësimit, sipas kësaj llogaritjeje, do të kishte mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë për diferencën prej (-) 400.434 lekësh, pa përfshirë në analizë shpenzimet e jetesës të cilat do ta thellonin diferencën negative. Duke përfshirë në analizë edhe shpenzimet e jetesës, sikurse ka bërë edhe subjekti i rivlerësimit në analizën e paraqitur në ankim, në shumën prej 112.684 lekësh, diferenca negative do të thellohej në shumën prej (-) 513.118 lekësh. Duke i llogaritur shpenzimet e jetesës para vitit 1996, në masën prej 40% të të ardhurave nga pagat në shtet dhe jo nga aktiviteti tregtar sipas pretendimeve, në vlerën prej 96.178 lekësh⁵⁷, subjekti i rivlerësimit do të kishte mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë, me diferencë negative prej (-) 496.612 lekësh.

23.13. Në përfundim, Kolegji, duke vlerësuar mënyrën e krijimit të ish-klinikës dentare, Kuçovë, me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes, si dhe koston e ndërtimit sipas përcaktimit të koston nga ZVRPP Kuçovë, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e saj në vitin 1995, në vlerën prej (-) 513.118 lekësh.

23.14. Në funksion të dhënies përgjigje të pretendimeve të ngritura në ankim prej subjektit të rivlerësimit lidhur me analizën dhe vlerësimin e burimeve financiare të ligjshme të përdorura për financimin e pasurive të përshkruara më lart e të krijuara nga viti 1995 deri në vitin 2002, Kolegji analizoi këtë mundësi edhe në funksion të një pretendimi konstant të subjektit për kryerjen e një analize të plotë dhe jo të fragmentarizuar në periudhat konkrete të krijimit të këtyre pasurive, duke llogaritur të ardhurat e njësisë familjare për këtë periudhë dhe shpenzimet e kryera.

23.15. Kolegji e konsideroi të drejtë të kryejë këtë vlerësim, duke arsyetuar mbi faktin se pjesa më e rëndësishme e të ardhurave të njësisë familjare, të përdorura në këtë periudhë, kishin si burim aktivitetin e bashkëshortes së subjektit si person fizik, aktivitet i cili të pamundëson përllogaritjen e saktë të të ardhurave në një moment kohor të caktuar, duke qenë se aktiviteti ka dinamikë të ndryshme nga periudha në periudhë dhe është e pamundur të matet rezultati financiar për çdo periudhë të vitit, përveç se rezultatit të deklaruar në fund të vitit ushtrimor në organet tatimore.

23.16. Nga analiza e pretendimeve të subjektit, rezulton se ai ka ndjekur dhe ka qenë koherent në shpjegimet e tij, mënyrën e llogaritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve që ka sugjeruar analiza dhe metodologjia e kryer nga Komisioni në mënyrë të parcelizuar, por nuk ka hequr asnjëherë dorë nga pretendimi për një analizë gjithëpërfshirëse të të ardhurave, pretendim të cilin e ka paraqitur

⁵⁵ Si total i të ardhurave të klinikës për vitin 1995 prej 76.016 lekësh + paga subjektit për vitin 1994 prej 67.283 lekësh + paga subjektit për vitin 1995 prej 143.163 lekësh. Të ardhura të përllogaritura nga Komisioni dhe nga subjekti rivlerësimit gjithashtu në analizën financiare të tij.

⁵⁶ Referuar dokumenteve bashkëlidhur aplikimit të subjektit të rivlerësimit në ZVRPP Kuçovë, në datën 01.02.2019, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 04.02.2019.

⁵⁷ Përllogaritur si 40% e totalit nga të ardhurat nga pagat [prej 240.446 lekësh], 30.000 lekë paga e bashkëshortes në vitin 1994 + 67.283 lekë paga e subjektit në vitin 1994 + 143.163 paga e subjektit në vitin 1995, rezulton në 96.178 lekë.

që në deklaratimet e burimeve në deklaratën e pasurisë *vetting*, në të cilën ka deklaruar të ardhura në total edhe përtej atyre të deklaruara në vitet ushtrimore.

23.17. Në përdorimin e kësaj metodologjie, Kolegji konsideroi edhe faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur në këto vite detyrimin për deklarime periodike dhe as vëmendje të pasqyronte me saktësi momentin e krijimit të pasurisë dhe të ardhurat e sakta që ai posedonte në atë moment, të cilat siç u përshkrua më lart, dukeshin të vështira për t'u përcaktuar ekzaktësisht për shkak të natyrës së krijimit të tyre. Sipas vlerësimit të Kolegjit, kjo metodologji nuk mund të jetë e përdorshme për analizën financiare të pretenduar nga subjekti pas lindjes së detyrimit për deklarime periodike sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit, pavarësisht vështirësisë së matjes së të ardhurave të krijuara nga aktiviteti i bashkëshortes në një moment të caktuar kohor, duhej të kishte marrë masat që të dokumentonte këto vlera në funksion të plotësimeve të detyrimeve të tij sipas ligjit më sipër, por edhe në zbatim të barrës për të provuar burimet e ligjshme të pasurive të tij, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

23.18. Duke arsyetuar si më lart, Kolegji kreu analizën financiare për këto pasuri të krijuara deri në vitin 2002, duke pranuar të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i bashkëshortes dhe puna e subjektit dhe e personit të lidhur, të provuar me dokumentacion ligjor, si edhe shpenzimet për jetesë dhe krijimin e pasurive, sipas vlerave të pranuar nga Komisioni⁵⁸, dhe rezultoi se subjekti dhe familja e tij kishin mungesa të burimeve të ligjshme në vlerën prej (-) 243.012 lekësh.

23.19. Kolegji, në përgjigje të shkaqeve të ankimit, vlerësoi këtë rezultat edhe nën dritën e fakteve të pretenduara nga subjekti e të pranuar përgjithësisht se për shkak të kohës shumë të largët e informalitetit të theksuar që ka shoqëruar fillimet e veprimtarive private në vend, është e vështirë të gjenden dokumente ligjore që provojnë të ardhurat e realizuara e shpenzimet e kryera, konsideruar pretendimet për të ardhura nga ortopedia, për të cilat subjekti kërkoi të merreshin edhe prova me dëshmitarë, apo përcaktimi i normës së fitimit i cili u pranua sipas parametrave të përgjithshëm të kohës, por jo saktësisht referuar rastit konkret, faktit se dy pasuritë që rezultojnë me më shumë problematikë brenda kontekstit të përshkruar më lart ishin krijuar në kohën kur subjekti i rivlerësimit nuk kishte filluar të ushtronte funksionet gjyqësore, në vitin 1995, duke arritur në përfundimin se kjo vlerë negative në analizën financiare, nuk mund të shërbente si një shkak për të konsideruar problematike krijimin e pasurive deri në vitin 2002, në një nivel që do të konsiderohej si një shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit.

23.20. Në të njëjtën linjë, Kolegji arsyetoi edhe mbi konkluzionet për deklarime të pasakta të arritura prej Komisionit lidhur me kostot e këtyre pasurive, të cilat nga analiza rezultuan së pari, se nuk ishin vlera të deklaruara pasaktësisht në deklaratën e pasurisë *vetting*, por u referoheshin deklarimeve dhe shpjegimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit dhe së dyti, përcaktimi i saktë i tyre nuk referohej në ndonjë dokument ligjor, por në vlerësime e analiza të situatave në të cilat ishin realizuar investimet, pra që kishte një paqartësi të pranuar për vlerën e saktë, të shtrirë në kohë të këtyre investimeve. Në këto kushte, për sa kohë që rezultoi i paqartë përcaktimi i këtyre

⁵⁸ *Shpenzimet e jetesës për periudhën 1994 – 1995, në vlerën prej 112.684 lekësh, shpenzime jetese për periudhën 1996 - 2000, në vlerën prej 120.000 lekësh/vit, shpenzime jetese për periudhën 2001 - 2002, në vlerën prej 480.000 lekësh, dhe kostoja e ndërtimit të ish-klinikës dentare Kuçovë, në vlerën prej 747.596 lekësh, sipas llogaritjes nga ZVRPP Kuçovë.*

vlerave dhe pas hetimit administrativ, do të ishte e paarsyeshme dhe e padrejtë të konkludohej për deklarime të pasakta në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

23.21. Kolegji e shqyrtoi këtë situatë edhe në kontekst të analizës së parcelizuar të përshkruar më sipër, në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit, sipas parashikimit të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe nuk e konsideroi atë si të mundur për kualifikimin e një deklarimi të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për pasojë, qëndrimin e Komisionit të mbajtur për këto pasuri në vlerësimin tërësor të tyre, si të pambështetur në fakte e në ligj.

- 24.** Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar njësinë, klinikë dentare, me sip. 74,32 m², ndodhur në “{***}”, Tiranë, sipas kontratës së porosisë, datë 09.06.2004, me shoqërinë “{***}” ShPK, vlerë 93.000 euro (ose 11.600.000 lekë), e shlyer me këste, gjatë viteve 2004 - 2005, me burim krijimi: a) likuidimin e depozitës së subjektit të rivlerësimit në “{***}”, Dega Tiranë, kontrata nr. {***}, datë 19.06.2000, me gjendje në datën 31.12.2003 në vlerën prej 1.400.073 lekësh; likuidimin e depozitës së subjektit të rivlerësimit në ish-{***}, {***}, kontrata nr. {***}, datë 25.11.2002, e rinovuar në datën 02.09.2004, me kontratën nr. {***}, me vlerë 2.011.039.36 lekë, si dhe likuidimin e depozitës së bashkëshortes në “{***}”, kontrata nr. {***}, datë 23.10.2003⁵⁹; b) kredinë në “{***}”, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.05.2005, lëvruar më 26.05.2005, në vlerën 50.000 euro, lënë hipotekë ap. 116 m², me interes 6,12%⁶⁰; dhe c) të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit, si dhe nga veprimtaria si stomatologe e bashkëshortes, në periudhën janar 2001 - maj 2005⁶¹, si dhe në periudhën qershor 2005 - maj 2008, për shlyerjen e kredisë së marrë për klinikën.

24.1. Nga deklarata periodike vjetore e vitit 2004, rezulton se subjekti ka deklaruar: “Porositur në ndërtim ambient rreth 79 m² për klinikë dentare, në katin II të pallatit në fillim të {***}, te firma e ndërtimit “{***}” ShPK, me pronar Z. K. etj. Nga data 09.06.2004, paguar deri më 31.12.2004, rreth 43.000 euro. Përfundon brenda qershor 2005”, dhe gjithashtu në deklaratën periodike/vjetore 2004, është deklaruar: “Depozitat në {***} nr. {***}, datë 25.11.2002, nr. {***}, datë 10.12.2003, si dhe në “{***}”, {***}, datë 19.06.2000, janë tërhequr (mbyllur) duke paguar këstet e sipërmarrjes së klinikës së re”, ndërsa nga deklarata periodike/vjetore 2005, rezulton: “Aparatura dentare - Unit Dentar, “{***}” i kompletuar, u ble më 31.05.2005 [...] 15.100 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind) euro [...]”.

24.2. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, për sa i përket deklaramit të burimit të kësaj pasurie, duke arsyetuar se: “Lidhur me deklaramin e burimit të krijimit të kësaj pasurie, trupit gjykues i rezulton se subjekti, shumë e depozitës 1.500.000 lekë e ka përdorur si burim për një tjetër destinacion, blerje aparature dentare, e pranuar edhe prej tij dhe, për rrjedhojë, çmon se subjekti ka paraqitur në mënyrë të pasaktë deklaramin e burimit të saj në deklaratën e pasurisë *vetting*. Për shkak të shpjegimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ se, për këtë pasuri është përdorur depozita nr. {***}, në ish-{***}, në shumë 200.000 lekë, e deklaruar në deklaratën për vitin 2004, dhe jo ajo e deklaruar gabimisht në deklaratën e pasurisë *vetting*, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*”.

⁵⁹ E cila përfshinte vlerën prej 1.500.000 lekësh nga kësti i parë i shitjes së ish-klinikës dentare në Kuçovë.

⁶⁰ Kësti 3-mujor 1.250 euro. Likuiduar në total më datë 13.08.2008, pa penalitet. Paguar interesa rreth 5.000 euro.

⁶¹ Deri në likuidimin e shumës së kontratës.

24.3. Subjekti i rivlerësimit i kundërshton konkluzionet e arritura nga trupi gjykues i Komisionit, me pretendimin se deklarimi në këtë mënyrë ishte një lapsus/ngatërrësë që lidhet me identifikimin e depozitës dhe vlerën e saj⁶², kjo për shkak të kohës së largët dhe ngarkesës në punë. Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, që në fazën e përgjigjeve të pyetjeve të Komisionit, në shkurt 2019 dhe në të gjitha komunikimet më pas, ai ka shpjeguar bindshëm, bazuar në prova dokumentare, se kjo depozitë ka ekzistuar, mjetet monetare kanë qenë në posedim të bashkëshortes dhe i ka përdorur si burim të ardhurash për funksionimin e klinikës dentare.

24.4. Duke ballafaquar burimet e krijimit të deklaruara në lidhje me këtë pasuri, Kolegjit i rezulton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, në strukturën e burimit të krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “[...] Bashkëshortja e subjektit në “{***}”, kontr. nr. {***}, datë 23.10.2003, e cila përfshinte vlerën prej 1.500.000 lekësh nga kësti i parë i shitjes së ish-klinikës dentare në Kuçovë. [...]”, deklarim i kryer edhe gjatë hetimit administrativ, ndërsa në deklaratën periodike vjetore 2004, është deklaruar: “[...] si dhe në “{***}”, Tirana Branch nr. {***}, datë 19.06.2000, janë tërhequr (mbyllur) duke paguar këstet e sipërmarrjes së klinikës së re [...]”.

24.5. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për kryerjen e pagesave, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ndër të tjera, edhe depozitën nr. {***}, datë 23.10.2003, në “{***}”, në shumën prej 1.500.000 lekësh, ndërsa në deklaratën periodike/vjetore 2004, është deklaruar një depozitë tjetër në {***}, depozita nr. {***}, datë 10.12.2003, sikurse ka shpjeguar *subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit, datë 11.04.2019*, se depozita e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* nr. {***}, datë 23.10.2003, në “{***}”, në shumën prej 1.500.000 lekësh, nuk ishte përdorur si burim për këtë pasuri, por për blerjen e pajisjes ““{***}””.

24.6. Kolegjit i rezulton se pavarësisht deklarimit të një tjetër depozite në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike/vjetore 2004 ka deklaruar përdorimin e depozitës përkatëse si burim për krijimin e kësaj pasurie. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting* i një burimi të ndryshëm në strukturën e burimit të krijimit të kësaj pasurie, vlerësohet nga ana e trupit gjykues të Kolegjit si deklarim i pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, referuar parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht këtyre rrethanave, meqenëse është vetëm një deklarim i pasaktë, që lidhet vetëm me identifikimin e gabuar të depozitës së përdorur si burim për krijimin e pasurisë, por i pashoqëruar me problematika të tjera referuar burimeve të ligjshme të krijimit të saj, të cilat janë të justifikuara edhe duke konsideruar depozitën e cila realisht ka shërbyer si burim krijimi, Kolegji vlerëson se kjo pasaktësi, duke qëndruar e vetme dhe pa pasojë në drejtim të legjitimitetit të burimeve financiare, nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut shkarkimi, duke qenë se të ardhurat që rezultuan nga hetimi përmbushin standardet e ligjshmërisë sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016.

25. Sipas analizës financiare të kryer në Komision për periudhën 01.01.2006 - 31.12.2007, raporti i të ardhurave me shpenzimet e kryera në këtë periudhë, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me balancë pozitive, përkatësisht prej (+) 670.902 lekësh për vitin 2005, prej (+) 544.533 lekësh për vitin 2006 dhe prej (+) 117.192 lekësh për vitin 2007.

⁶² Në vend të depozitës nr. {***}, në “{***}”, e krijuar më 10.12.2003, është deklaruar si burim për krijimin e pasurisë, depozita nr. {***}, datë 23/10/2003, në emër të bashkëshortes në {***}.

25.1. Duke reflektuar mbi këto rezultate të bëra prezente me rezultatet e hetimit paraprak, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kontrolli dhe vlerësimi pasuror i kryer nga Komisioni ka qenë i mangët, për shkak se nuk ka shpjeguar shkaqet e përfshirjes apo përjashtimit të pasurive apo burimeve nga kolonat përkatëse dhe nuk ka bërë analizë të detajuar financiare të kësaj periudhe. Sipas subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit nuk ka përfshirë balancat respektive financiare dhe mundësinë e krijimit të vlerave monetare të lira, si likuiditete *cash* në vitet pasardhëse. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në periudhën 30.03.2005 - 31.12.2007, ka pasur mundësinë e krijimit të kursimeve monetare, si likuiditet, në vlerën rreth (+) 1.332.638 lekë⁶³ e cila është përdorur muajt e parë të vitit 2008 për përballimin e shpenzimeve të nevojshme si dhe pagesën e fundit të kredisë, datë 26.05.2005, në “{***}”, prej 50.000 eurosh, si burimi i financimit të pasurisë klinike dentare në “{***}”, Tiranë. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit pretendon se pavarësisht se trupi gjykues i Komisionit ka pranuar ngatërresën e destinacionit të depozitës në “{***}”, të tërhequr në datën 30.03.2005, të përdorur për blerjen e pajisjes “{***}”, ai nuk i ka marrë në konsideratë e nuk ka reflektuar efektet financiare sipas përdorimit të saj për periudhën vijuese.

25.2. Kolegji vëren se në deklaratat periodike/vjetore 2005, 2006 dhe 2007, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në formën *cash*, apo të ketë deklaruar ndryshime, në formën e shtimeve apo të pakësimeve të gjendjes *cash*, duke përjashtuar indiciet për mundësitë e kursimit në formën e likuiditeteve *cash*, dhe në këto kushte Kolegji vlerëson se nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit. Kolegji ka mbajtur qëndrim të konsoliduar tashmë⁶⁴, se gjendja e likuiditeteve *cash* apo kursimet e shtuara kësaj gjendjeje nuk mund të provohen ndryshe në këtë proces, përveç se me deklaratat periodike, si i vetmi dokument i krijuar në kohën që pretendohet krijimi i kësaj pasurie që mund ta provojë atë. Nga shqyrtimi i të gjitha akteve të administruara gjatë hetimit, Kolegji nuk konstaton asnjë dokument tjetër ligjor në të cilin të gjejnë pasqyrim këto të dhëna, të cilat të mund të vlerësoheshin në drejtim të provueshmërisë së ekzistencës së kësaj pasurie.

26. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartamentin me garazh dhe papafingo, me sip. 250 m², në rr. “{***}”, kompleksi “{***}”, “{***}”, Tiranë, të porositur nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.01.2010, e cila referon në kontratat nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.04.2009, por e nënshkruar nga palët në datën 13.12.2008, në të cilin janë kryer punime shtesë dhe arredimi. Vlera sipas kontratës së sipërmarrjes prej 160.000 eurosh, është paguar me këste, përkatësisht: në vitin 2008, kësti prej 49.000 eurosh; në vitin 2009, kësti prej 91.000 eurosh; dhe në vitin 2010, kësti prej 20.000 eurosh, ndërsa për shpenzime për punime shtesë në periudhën 2011 - 2012, shuma prej 2.000.000 lekësh, ndërsa për arredimin, shuma rreth 2.100.000 lekë, përkatësisht: në vitin 2012, shuma rreth 1.250.000 lekë; në vitin 2013, shuma prej 250.000 lekësh; dhe pjesa tjetër në vitet në vitet 2014 - 2016. Burimi i financimit: “i) *paga e subjektit si gjyqtar dhe nga aktiviteti i klinikës dentare të bashkëshortes L., gusht 2008 - dhjetor 2016 (e vijim për pagesën e kredisë së marrë për këtë qëllim); ii) dy kredi në {***}, në total 75.000 euro. Në datën 01.06.2009, shuma 50.000 euro (kaluar firmës me bankë) dhe në datën 16.12.2010, vlera e 25.100 eurove. Në detaje do të sqarohet te seksioni i kredive ekzistuese; dhe iii) shitja totale e pasurisë nr. {***}, me sip. 38,25 m², (ish-klinika dentare Kuçovë, ndërtuar sipas*

⁶³ Në ankim e përllogarit si total të balancave pozitive (si diferencë e të ardhurave – shpenzime – pasuri) për vitet 2005, 2006 dhe 2007 sipas rezultateve të analizës financiare të Komisionit.

⁶⁴ Vendim nr. 8/2019 (JR), datë 16.04.2019; paragrafi 43; vendim nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019, paragrafi 32.5; vendim nr. 29/2019 (JR), datë 08.11.2019, paragrafi 31; vendim nr. 1/2020 (JR), datë 15.01.2020, paragrafi 50; vendim (JR) nr. 11/2019, paragrafi 27; vendim (JR) nr. 19/2019, paragrafët 84-85.

leje shesh ndërtimi nr. {***}, datë 14.02.1995, e lejes së ndërtimit nr. {***}, datë 30.03.1995, në funksion të punës si dentiste të bashkëshortes në qershor 1995), me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.12.2012, së bashku me truallin 38,25 m² (i cili u ble nga subjekti me kont. nr. {***} rep. e nr. {***} kol., datë 14.08.2012). Çmimi i shitjes së ish-klinikës dentare 4.000.000 lekë, prej të cilave 1.500.000 lekë ishin paguar nga blerësi A. S., në tetor 2003 (deklaruar në mars 2004), ndërsa pjesa e mbetur u kompensua me vlerën e 19.000 eurove, marrë hua në dhjetor 2008, për apartamentin në “{***}”. Te seksioni “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar: “Kontrata për kredi bankare afatgjatë nr. {***}, datë 22.05.2009, është lëvruar më datë 01.06.2009, në shumën 50.000 euro, e cila ka kaluar me veprim bankar në llogarinë e firmës ndërtuese “{***}” në të njëjtën bankë, si këst për blerjen e apartamentit në kompleksin që po ndërtohej prej saj, në rr. {***}, në përputhje me kushtet e kontratës së porosisë së nënshkruar që në datë 13.12.2008 (kjo pasuri është regjistruar në ZRPP në emër të firmës ndërtuese “{***}” me nr. pasurie nr. {***}, ndërsa në seksionin D është regjistruar kontrata e porosisë). Kredia mbyllet më datë 01.06.2017. Deri në datën 20.01.2017, janë paguar vlera e principalit prej 46.518.18 eurosh, si dhe interesa 15.664.02 euro. Sqarim: Në të njëjtën bankë, më 03.12.2010, me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., mora kredinë e dytë prej 25.000 eurosh, me të cilën efektivisht u shlye kësti i fundit i kontratës së porosisë për shtëpinë në “{***}”, ndaj firmës “{***}” ShPK (ndonëse kjo e fundit ishte likuiduar para lëvrimit të kësaj kredie, sipas afatit të caktuar në kontratën e re të porosisë, datë 05.01.2010, me hua nga vëllezërit e mi, prandaj edhe vlera e kredisë ka kaluar në llogarinë e vëllait B. B. në këtë bankë [...]).”

26.1. Në deklaratën periodike/vjetore 2008, është deklaruar se për këtë pasuri, në këtë vit, është paguar shuma prej 49.000 eurosh, me burim: Për këtë pagesë mora hua nga A. S. [...], vëllai i gruas L. B., pa interes, llogaria e tij bankare në “{***}” që ia kalon firmës “{***}”. Vlera 19.000 euro. “Mora hua nga vëllai im B. B., depozita e tij në {***}, pa interes. Marrëveshja e huasë është gojore, pa afat, por do të shlyhen me kredi ose nga shitja e objektit në rr. “{***}”. Vlera 2.000.000 lekë”.

26.2. Në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti ka deklaruar se, për këtë pasuri, në këtë vit ka paguar 91.000 euro⁶⁵, prej të cilave, shuma prej 50.000 eurosh me kredi dhe shuma 41.000 euro, detyrime financiare për kontratën e porosisë, datë 13.12.2008, përkatësisht: “A) Detyrime të krijuara e mbetura nga v. 2008: 1). kunatit [...], mbetur borxh 19.000 euro; 2). vëllait B. B., mbetur borxh 2.000.000 lekë. B) Detyrime të krijuara gjatë vitit 2009: 1). vëllait B. B. nga llogaria në “{***}” [...] {***}, mora borxh 10.000 euro; 2). vëllait P. B., marrë borxh shumën 2.000.000 lekë, të cilat 1 mln nga llogaria në {***} nr. {***} dhe 1 mln i kishte të lira. C) Në Bankën Popullore mora kredinë në shumën 50.000 euro [...]”⁶⁶.

26.3. Në deklaratën periodike të vitit 2010, subjekti ka deklaruar se në datën 05.01.2010, u revokua në të gjitha elementet, përveç çmimit, kontrata e sipërmarrjes, datë 13.12.2008, e lidhur me shoqërinë ndërtuese “{***}” ShPK, për ndërtimin e apartamentit nr. {***}, radha e parë në “{***}”, e vitit 2008, dhe u lidh kontratë e re sipërmarrjeje për ndërtimin e apartamentit nr. 12, radha e dytë në të njëjtin vend, me vlerë të njëjtë prej 160.000 eurosh, ndërsa sipërfaqja ndërtimore

⁶⁵ Nga shuma totale prej 160.000 eurosh, kishte mbetur pa paguar shuma prej 20.000 eurosh.

⁶⁶ Me interes 7,64% për një periudhë 8 vjet (56 muaj), këste mujore 697,11 euro, interes 16.922,56 euro, për periudhën 01.06.09 deri më 01.06.2017. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit: 4182,66 euro (2315,17 principal + 1867,49 interesa).

250 m², sip. banimi 180 m², e likuiduar, përkatësisht: në vitin 2008, shuma prej 49.000 eurosh; në vitin 2009, shuma prej 91.000 eurosh; dhe në vitin 2010, shuma prej 20.000 eurosh.

26.4. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton konkluzionin e Komisionit se: “Ka deklaruar në mënyrë të pasaktë burimet e pasurive në deklaratën e pasurisë “vetting”, si dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të tyre [...]”, duke pretenduar se huatë nga personat e tjerë të tretë, duhet të konsiderohen të sakta e të plota, në referim edhe të fakteve se këto marrëdhënie financiare u provua se janë shlyer totalisht në vitet 2010 - 2013, dhe deklarimi i përgjithshëm, pa detaje të plota, i kësaj marrëdhënieje me personat e tretë, duhet të konsiderohet i mjaftueshëm për korrektesën e subjektit në plotësimin e deklaratës, edhe për faktin se edhe në ligjin nr. 84/2016, nuk ka pasur qartësi në lidhje me deklarimin e marrëdhënies së huas me të tretë, kur ajo nuk konfirmohet se ekziston ende në kohën e plotësimit të saj. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se: “[...] nuk ka deklaruar këstin e paguar në datën 18 tetor 2008, në shumën 10.000 euro [...]”, duke pretenduar se është tërësisht i gabuar pasi edhe sepse nuk përcakton se në cilën deklaratë e ka deklaruar.

26.5. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, ndryshe nga sa ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore 2008 dhe 2009, për efekt të shlyerjes së detyrimeve për blerjen e apartamentit me sip. 250 m² në rr. “{***}”, kompleksi “{***}”, “{***}”, Tiranë (ku është deklaruar se në vitin 2008, kishte marrë hua nga vëllai B. B., në shumën prej 2.000.000 lekësh, dhe në vitin 2009, se përkatësisht kishte marrë huatë nga vëllai B. B., në shumën prej 10.000 eurosh, dhe nga vëllai P. B. në shumën prej 2.000.000 lekësh), në deklaratën e pasurisë *vetting*, në strukturën e burimeve të krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pagat e veta dhe të ardhurat e bashkëshortes, kreditë nga {***} dhe të ardhurat e shitjes së ish-klinikës dentare në Kuçovë.

27. Lidhur me pagesat e kryera në vitin 2008, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: “[...] i). ka mungesë të të ardhurave në shumën 899.670 lekë, për të justifikuar pagesën e shumës 49.000 euro në vitin 2008; ii). nuk ka deklaruar këstin e paguar në datën 18.10.2008, në shumën 10.000 euro; dhe iii). nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën prej 6.536 eurosh, sipas pretendimit të tij se ka paguar shumën 20.000 euro në fund të muajit dhjetor të vitit 2008, si dhe nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën 1.291.185 lekë, të pretenduar në tabelën e përlllogaritjeve nga eksperti kontabël, po për vitin 2008 [...]”.

27.1. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton konkluzionin e mësipërm të Komisionit, duke pretenduar se: në analizën financiare të trupit gjykues të Komisionit, për periudhën 01.01.2008 - 18.10.2008, në rastin më të mirë nuk ka përfshirë treguesit realë të të ardhurave të biznesit deri në atë datë, jo vetëm sepse ata nuk pasqyrohen në pasqyrat financiare të dorëzuara në tatime në datën 10.02.2009, por edhe sepse rrethanat e nevojshme të rivlerësimit edhe për këtë periudhë, nuk janë hetuar e nuk janë vlerësuar nga trupi gjykues i Komisionit. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka neglizhuar e refuzuar pa asnjë arsye shpjegimet e tij për faktorët që duhen marrë në konsideratë edhe kur bëhet analizë e parcelizuar. Subjekti ka pretenduar në vijim se trupi gjykues i Komisionit ka qenë subjektiv dhe ka arritur në përfundime të gabuara për balancën e pasurive me të ardhurat sipas analizës së parcelizuar, duke argumentuar se në kushtet kur bashkëshortja e vetëpunësuar nuk merr pagë mujore dhe, sipas ligjit fiskal, është e lirë të përdorë e disponojë të ardhurat nga shërbimi që kryen edhe sipas nevojave të saj personale e familjare.

27.1.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, vlera negative e balancës sipas analizës së Komisionit për periudhën 01.01.2008 - 18.10.2008, prej (-) 899.670 lekësh, do të dilte pozitive në shumën mbi

400.000 lekë, sepse duhej të merrej në konsideratë në analizë gjendja *cash* e datës 31.12.2007, në vlerën prej 1.332.638 lekësh, e kursyer gjatë periudhës 30.03.2005 - 31.12.2007, me burim kryesor ngatërresën e paqëllimshme në deklarime të destinacionit të depozitës bankare të mbyllur në datën 30.03.2005⁶⁷.

27.1.2. Sipas subjektit të rivlerësimit, konkluzioni i trupit gjykues të Komisionit se: “[...] nuk ka deklaruar këstin e paguar në datën 18 tetor 2008, në shumën 10.000 euro [...]”, është tërësisht i gabuar pasi, edhe pse nuk përcakton se në cilën deklaratë nuk e ka deklaruar, ky këst është pjesë e deklaramit të bërë në deklaratën vjetore, për shumën totale të paguar prej 49.000 eurosh dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, referuar shumës së paguar në vitin 2008, si dhe është pjesë përbërëse, referuar kontratës së porosisë, shuma monetare prej 29.000 eurosh, paguar para lidhjes kontratës, përkatësisht pagesa e datës 18.10.2008, prej 10.000 eurosh.

27.1.2.1. Lidhur me kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar këstin e paguar në datën 18 tetor 2008, në shumën 10.000 euro, Kolegji vëren se në deklaratën periodike të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Me firmën ndërtuese ““{***}”” [...] u lidh kontrata paraprake e porosisë për apartamentin në “{***}”, duke u paguar kësti i parë [...] 49.000 euro [...]”. Nga kontrata e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.12.2008, rezulton se: “[...] me çmim 160.000 euro, dhe që do t’i paguhet sipërmarrësit sipas kësteve më poshtë: me datën e lidhjes së kontratës, është paguar shuma 29.000 euro, deri më datën 31.12.2008 paguhet shuma 20.000 euro [...]”.

27.1.2.2. Kolegji vëren se duke shqyrtuar totalin e kësteve të paguara në vitin 2008, rezultojnë të besueshme rrethanat e kryerjes së pagesës prej 10.000 eurosh në datën 18.10.2008, ndonëse ky këst pagese nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe nuk është deklaruar saktësisht në deklaratën periodike/vjetore 2008, por nëpërmjet deklaramit se: “[...] me datën e lidhjes së kontratës, është paguar shuma 29.000 euro, deri më datën 31.12.2008 paguhet shuma 20.000 euro [...]”. Pavarësisht mungesës së deklaramit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe pasaktësisë së deklaramit në deklaratën periodike/vjetore 2008, në këto deklarata është deklaruar saktësisht shuma e paguar në vitin 2008, brenda së cilës përfshihet edhe shuma prej 10.000 eurosh. As deklarata e pasurisë *vetting* dhe as deklaramat periodike nuk parashikojnë detyrimin për deklaram të detajuar të çdo kësti pagesash, për sa kohë që deklarohet saktësisht shuma e paguar dhe burimet e financimit të saj. Mënyra e pagesës dhe verifikimi i mundësive financiare të subjektit për të paguar këstet e paguara në kohën e verifikuar, janë objekt i kontrollit e verifikimit të burimeve të ligjshme që kryhet nga organet e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi, por jo element i domosdoshëm për t’u deklaruar në deklaratën e pasurisë, përveç rasteve kur ligji e ka kërkuar në mënyrë të posaçme këtë deklaram. Për pasojë, konkluzioni i Komisionit rreth këtij fakti, nuk konsiderohet nga Kolegji si një shkelje e ligjit me ndonjë pasojë në procesin e rivlerësimit të subjektit⁶⁸.

27.1.3. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga trupi gjykues i Kolegjit të konfirmojë dinamikën e pagesave të kryera realisht, në datën 18.10.2008, në shumën prej 10.000 eurosh, me burim kryesisht të ardhura nga mbyllja e depozitave që kanë qenë ekzistuese nga viti 2007, në “{***}”,

⁶⁷ Referuar depozitës në {***} të bashkëshortes, tërhequr në datën 30.03.2005, në shumën prej 1.613.000 lekësh, me burim nga huaja e dhënë nga kunati i tij, z. A. S., në vitin 2002, sipas përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 04.02.2019.

⁶⁸ Vendimi nr. 21/2021 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 36.

në emër të bashkëshortes, të tërhequra në gusht - shtator 2008, si dhe me të ardhurat e tjera të bashkëshortes gjatë periudhës 01 gusht - 18 tetor 2008.

27.1.3.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, sikurse rezultoi edhe nga analiza financiare e kryer në Komision për periudhën 01.01.2008 - 18.10.2008, ku janë përfshirë shumat nga mbyllja e depozitave në “{***}”, në zërin “ndryshim likuiditete”, si dhe të ardhura të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit kishte mungesë burimesh të ligjshme në shumën prej (-) 899.670 lekësh, për të kryer pagesën prej 10.000 eurosh.

27.1.4. Lidhur me kundërshtimin e konkluzionit të trupit gjykues të Komisionit se ka mungesë të të ardhurave në shumën 899.670 lekë, për të justifikuar pagesën e shumës 49.000 euro në vitin 2008, Kolegji analizoi pretendimet e subjektit të ngritura mbi analizën e kryer në Komision, duke marrë në shqyrtim çdo pretendim sipas këndvështrimit të parashtruar në ankim e duke vlerësuar rezultatin që del nga këto analiza.

27.1.5. Në analizën financiare të kryer në Komision për periudhën 01.01.2008 - 18.10.2008, janë përfshirë të ardhurat nga pagat e bashkëshortes së subjektit nga ushtrimi i profesionit si stomatologe, prej 240.000 lekësh, sipas të dhënave të B.ncit të vitit 2008, kur zëri “paga”, në pasqyrën e të ardhura/shpenzimeve ka qenë 288.000 lekë dhe është konsideruar në llogaritje pjesa përpjesëtimore për 10 muaj. Duke iu referuar lëvizjeve të llogarisë së L. B. PF - Personit Fizik në {***}⁶⁹, rezultojnë kalim page për L. B. deri në datën 18.10.2008, vetëm për pagat e periudhës janar - mars 2008, prej 14.000 lekësh x 3 muaj = 42.000 lekë. E thënë ndryshe, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka marrë paga vetëm për tre muaj sipas këtyre të dhënave. Nga ana tjetër, nga kjo llogari rezultojnë se ka qenë e punësuar dhe i është kaluar pagë çdo muaj edhe një punonjëseje tjetër. Nga lëvizjet e llogarisë gjatë vitit 2008, janë bërë kalime për paga për bashkëshorten në shumën totale prej 42.000 lekësh, dhe për punonjësen tjetër në shumën totale prej 238.944 lekësh, gjithsej prej 280.944 lekë, me një diferencë prej 7.056 lekësh nga totali i pagave sipas pasqyrës së të ardhura/shpenzimeve prej 288.000 lekësh. Sipas të dhënave më sipër, paga e bashkëshortes nuk është llogaritur në mënyrë të saktë, pasi zëri paga, referuar B.ncit të vitit 2008, nuk përmban vetëm pagën e bashkëshortes, por dhe të një punonjëseje tjetër, deri në datën 18.10.2008. Sipas lëvizjeve në llogarinë bankare, bashkëshortja ka marrë pagë vetëm për tre muaj, në masën prej 42.000 lekësh dhe jo 240.000 lekë. Në dritën e standardit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit, në analizën financiare të kryer në Kolegji, është përfshirë vlera prej 240.000 lekësh, sikurse dhe në analizën financiare kryer në Komision.

27.1.6. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se duhet të merrej në konsideratë në analizë gjendja *cash* e datës 31.12.2017, në vlerën prej 1.332.638 lekësh⁷⁰, kursime të mundshme, Kolegji në vijim të qëndrimit të mbajtur⁷¹, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar likuiditete *cash* në deklaratën vjetore të vitit 2005, 2006 po ashtu dhe në deklaratën vjetore të vitit 2007, të cilat të përfshihen në analizën financiare të vitit 2008, dhe gjithashtu nuk ka deklaruar

⁶⁹ Bashkëlidhur shkresës së {***}-së nr. {***} prot., datë 08.04.2019, fashikulli 6, faqe 996.

⁷⁰ Në ankim e përllogarit si total të balancave pozitive (si diferencë e të ardhurave – shpenzime – pasuri) për vitet 2005, 2006 dhe 2007, sipas rezultateve të analizës financiare të Komisionit.

⁷¹ Vendim nr. 8/2019 (JR), datë 16.04.2019, paragrafi 43; vendim nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019, paragrafi 32.5; vendim nr. 29/2019 (JR), datë 08.11.2019, paragrafi 31; vendim nr. 1/2020 (JR), datë 15.01.2020, paragrafi 50; vendim (JR) nr. 11/2019, paragrafi 27; vendim (JR) nr. 19/2019, paragrafët 84-85; vendim (JR) nr. 20/2019, paragrafi 59; vendim (JR) nr. 20/2020, paragrafi 19.4; vendim (JR) nr. 12/2021; vendim (JR) nr. 27/2020, paragrafët 19.4.iii, 19.4.v.

as përdorim apo pakësim të mundësisë së kursimit të likuiditeteve *cash* të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit se ka pasur gjendje në datën 31.12.2007, si burim i mundshëm i krijimit të pasurisë, nuk ka njohur dhe as ka llogaritur këtë gjendje të pretenduar prej subjektit si një e ardhur që mund të përdorej si burim për të përballuar financimin e shpenzimeve në vitin 2008.

27.1.7. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për gjendjen *cash*, në shumën prej 1.332.638 lekësh⁷², në datën 31.12.2007, e cila sipas subjektit të rivlerësimit është përdorur muajt e parë të vitit 2008, bie ndesh me përgjigjet e pyetësorëve nr. 2, datë 04.02.2019, pyetjes nr. 20, për pajisjen e blerë për klinikën në vitin 2007, ku subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, pavarësisht se nuk i ka deklaruar kursimet *cash*: “[...] kursime të vitit 2005 në shumën 800.000 lekë dhe atyre të vitit 2006 në shumën prej rreth 400.000 lekësh [...]”, dhe në vijim se pjesën më të madhe të kursimeve *cash* e ka përdorur si burim për blerjen e pajisjes dentare ““{***}””, në shkurt 2007. Duket se me shpjegimet e tij, vetë subjekti, edhe sikur të kishte deklaruar krijimin e kësaj gjendjeje likuiditeti, mbetet konfuz dhe kontradiktor për përdorimin e saj, fakt që e potencon edhe më shumë qëndrimin e Kolegjit se ajo nuk mund të llogaritet se ka ekzistuar në vitin 2008 dhe se është përdorur në destinacionin që deklaroi subjekti pas njohjes me rezultatet e hetimeve paraprake.

27.1.8. Në këto kushte, sikurse edhe trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar në analizën financiare të kryer në Komision për periudhën 01.01.2008 - 18.10.2008, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë, duke u gjendur me balancë negative në shumën prej (-) 899.670 lekësh për të paguar këstin prej 10.000 eurosh dhe për të mbuluar shpenzimet e tjera familjare deri në datën 18.10.2008, duke përfshirë në analizë edhe mbylljen e depozitave të bashkëshortes në ““{***}””, por nëse të ardhurat e bashkëshortes nga paga në aktivitetin e saj do të llogariteshin në shumën prej 42.000 lekësh, që rezultuan të kishin kaluar në llogarinë bankare të bashkëshortes, në raport me shumën prej 240.000 lekësh të konsideruara në analizën e kryer në Komision, diferenca negative e pajustificuar me burime të ligjshme do të ishte edhe më e thelluar, në shumën prej (-) 1.097.670 lekësh.

27.1.9. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në analizën financiare të kryer në Komision për periudhën 01.01.2008 - 18.10.2008, në rastin më të mirë nuk janë përfshirë treguesit realë të të ardhurave të biznesit deri në atë datë, sepse ato nuk pasqyrohen në pasqyrat financiare të dorëzuara në tatime në datën 10.02.2009, Kolegji vlerësoi se edhe në rastin më të favorshëm për subjektin e rivlerësimit, sikur të konsiderohej se të gjitha të ardhurat e vitit 2008 nga aktiviteti i bashkëshortes do të ishin gjeneruar deri në datën 18.10.2008, megjithëse kjo do të ishte një tablo aspak realiste, duke qenë se në natyrën e këtij aktiviteti, mund të ndodhë që ai të prodhojë më shumë të ardhura në periudhën e fundvitit, në shumën prej 1.862.533 lekësh, dhe elementet e tjera të analizës financiare për periudhën 01.01.2008 - 18.10.2008 do të llogariteshin sipas vlerësimit që është bërë në Komision, sërish subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar pasuritë në këtë periudhë, në vlerën prej (-) 589.247 lekësh.

27.1.10. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit të paraqitur në parashtrimet e dorëzuara në Kolegj për kryerjen e analizës financiare të parcializuar për periudhën 01.08.2008 - 18.10.2008, duke konsideruar se në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar si burime pagat

⁷² Në ankim e përllogarit si total të balancave pozitive (si diferencë e të ardhurave – shpenzime – pasuri) për vitet 2005, 2006 dhe 2007, sipas rezultateve të analizës financiare të Komisionit.

nga funksioni i gjyqtarit dhe të ardhurat nga aktiviteti i klinikës dentare të bashkëshortes për periudhën gusht 2008 - dhjetor 2016, sërish edhe pas kryerjes së analizës në këtë optikë, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar pasuritë, pasi në këtë periudhë, në datën 13.08.2008, është kryer mbyllja e kredisë në “{***}”, në shumën prej 21.482 eurosh, nëpërmjet depozitimit *cash*, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë pasur likuiditete *cash*, gjendje të deklaruara në vitin 2007 apo të deklaruara të përdorura në vitin 2008. Duke vlerësuar parcializimin e analizës financiare për periudhën 01.01.2008 - 01.08.2008, për të vlerësuar kursimet *cash* që kishte pasur mundësi familja të kursente, të cilat më pas janë depozituar *cash* për mbylljen e kredisë në “{***}”⁷³ [subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat deri në maj 2008 dhe jo deri në gusht 2008], për një total të ardhurash prej 2.339.484 lekësh, zbritur shpenzimet prej 359.430 lekësh, si dhe zbritur shlyerja e kredisë në “{***}” [principal + interesa prej 309.451 lekësh], si dhe zbritur shtimi i likuiditeteve në bankë prej 374.984 lekësh, do të rezultonte se kishte mundësi për të kursyer në likuiditete në *cash* [në fillim të muajit gusht 2008] në vlerën prej 1.295.619 lekësh. Sipas analizës së parcializuar për 01.08.2008 – 18.10.2008, do të rezultonte një total të ardhurash prej 690.633 lekësh, zbritur shpenzime prej 382.985 lekësh, si dhe zbritur shlyerja e kredisë në “{***}” [principal + interesa prej 2.697.745 lekësh], zbritur pakësimi i likuiditeteve në bankë prej 1.398.071 lekësh [ku përfshihen dhe depozitat e përdorura për pagesën e këstit parë prej 10.000 eurosh], si dhe paguar kësti parë prej 10.000 eurosh ose 1.231.825 lekësh, sërish subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me diferencë negative prej (-) 2.223.850 lekësh, por konsideruar kursimet e mundshme të analizës për 01.01.2008 - 01.08.2008 prej 1.295.619 lekësh, do të rezultonte sërish për totalin e periudhës në analizë, 01.01.2008 – 01.08.2008 - 18.10.2008, me diferencë negative në vlerën prej (-) 928.231 lekësh⁷⁴.

27.2. Në përfundim të konsiderimit të shkaqeve të ankimit dhe të çdo skenari të mundshëm të ngritur prej subjektit lidhur me pagesën e shumës prej 10.000 eurosh, paguar në datën 18.10.2008, si pjesë e këstit prej 49 mijë eurosh të paguar në vitin 2008, për blerjen e apartamentit të ndodhur në kompleksin ““{***}””, “{***}”, Tiranë, me sip. 250 m², me vlerë 160.000 euro, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit rezulton të gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për ta justifikuar atë, të paktën në vlerën e konkluduar prej Komisionit, si një vlerë që konfirmohet në çdo version të analizës financiare të kryer në Kolegj mbi pretendimet e subjektit, për pasojë ai gjendet në situatën faktike të parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 28.** Si pjesë e burimeve financiare për të paguar shumën prej 49.000 eurosh në vitin 2008, subjekti ka deklaruar se është përdorur edhe një hua në shumën prej 2.000.000 lekësh, marrë nga vëllai i tij B. B.. Në deklaratën periodike të vitit 2008 lidhur me huan e marrë nga vëllai, z. B. B., është deklaruar përkatësisht: *Mora hua nga vëllai im, B. B., depozita e tij në {***}, pa interes. Marrëveshja e huas është gojore, pa afat, por do të shlyhet me kredi ose nga shitja e objektit në rr. {***}*. Në deklaratën periodike të vitit 2011, është deklaruar: *U pagua detyrimi i 1/2 së shumës së marrë hua ndaj vëllait B. B. në dhjetor 2008, për blerjen e apartamentit. 1.000.000 lekë. Mbetet 1.000.000 lekë. Dhe në deklaratën periodike të vitit 2013, është deklaruar: U shlye detyrimi i mbetur prej shumës së marrë*

⁷³ Sipas deklarimeve në deklaratën e pasurisë vetting, ka deklaruar si burim: “[...] c) Të ardhura nga paga e subjektit, si dhe nga veprimtaria si stomatologe e b/shortes, në periudhën janar 2001 - maj 2005 (deri në likuidimin e shumës së kontratës), si dhe në periudhën qershor 2005 - maj 2008, për shlyerjen e kredisë së marrë për klinikën”.

⁷⁴ Ky rezultat ndryshon nga diferenca negative sipas analizës së kryer në Komision, prej (-) 899.670 lekësh, në shumën prej 28.561 lekësh, nga efekti i kursit të monedhave të huaja, në konvertimin e balancave të likuiditeteve në bankë.

*hua ndaj vëllait B. B. në dhjetor 2009 për blerjen e apartamentit, për kontratën e porosisë së shtëpisë. 1.000.000 lekë. U shlye edhe detyrimi në euro i marrë hua vëllait B. B. në datën 17.09.2009, për likuidimin e kësteve të firmës {***}. 10.000 euro.*

28.1. Komisioni, duke e konsideruar vëllain e subjektit si person tjetër të lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ka verifikuar mundësinë e tij për të justifikuar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua në vitin 2008, prej 2.000.000 lekësh, dhe ka konkluduar se ai nuk ka pasur burime të ligjshme për ta justifikuar atë. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton konkluzionin e arritur nga Komisioni, duke pretenduar se, në lidhje me huan nga vëllai B. B., në shumën prej 2.000.000 lekësh, në dhjetor 2008, ndryshe nga sa konkludon trupi gjykues i Komisionit⁷⁵, ai provoi dhe shpjegoi bindshëm se depozita bankare dhe e gjithë shuma e dhënë hua jo vetëm ka qenë në llogarinë personale të huadhënësit, jo vetëm në kohën e transaksionit, por dhe vite më parë, pra deklarimi i tij për burimin e huamarrjes nga llogari personale është i saktë dhe arsyetimi i vendimit të Komisionit⁷⁶ jo vetëm është i gabuar, por përbën shtrembërim të fakteve dhe rrethanave të provuara. Dhe, në lidhje me huan e dhënë nga vëllai B. B. në shumën prej 10.000 eurosh në shtator 2009, referuar arsyetimit të Komisionit⁷⁷, si dhe diferencës prej 200.000 lekësh që nuk mbulonte huadhënësi⁷⁸, subjekti i rivlerësimit pretendon se është në shkelje të të gjitha parimeve në të cilat bazohet procesi, si objektiviteti, proporcionaliteti e parimet e tjera të procesit të rregullt ligjor, sanksionuar nga neni 18 dhe 179/b/2 i Kushtetutës, e thekson se me dhënien e këtij vendimi është shkelur parimi i “barazisë para ligjit”, krahasuar me proceset e tjera “kur janë marrë në konsideratë pagat e administratorëve dhe gjendja në llogari bankare”. Sa u takon pretendimeve për proces të parregullt ligjor, në drejtim të cenimit të parimit të barazisë para ligjit, krahasuar me subjektet e tjera të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit çmon se një pretendim i tillë i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjë a priori shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike, të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni⁷⁹.

28.2. Për sa i përket burimit të huas prej 2.000.000 lekësh, sipas akteve në fashikull, Kolegjit i rezulton se z. B. B. e ka tërhequr këtë shumë nga llogaria personale në {***}, në datën 23.12.2008, dhe se burimi i krijimit të kësaj depozite ishte tërheqja në datën 03.04.2006, pa përshtetshmëri, nga llogaria e shoqërisë “{***}” ShPK, ortak i së cilës ishte z. B. B.. Nga analiza e akteve të administruara, por edhe nga shpjegimet e subjektit, konstatohet se subjekti nuk ka provuar mekanizmin ligjor nëpërmjet të cilit vëllai i subjektit është bërë zotëruar i kësaj shume, duke qenë

⁷⁵ Referon vendimin, faqe 26: “Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm, sipas nenit D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, burimin e ligjshëm të shumës 2.000.000 lekë, marrë hua nga vëllai i tij [...]”.

⁷⁶ Referon vendimin, faqe 26: “Dokumentacioni i dorëzuar nuk ka nivelin e provueshmërisë, pasi transaksioni i huamarrjes është kryer nga llogaria e biznesit të tij dhe jo nga llogaria personale”.

⁷⁷ Referon në vendim, paragrafi 4.43, faqe 36, arsyetimin: “[...] konstaton se ai nuk mundi të provojë burimin e ligjshëm të shumës së marrë hua, për arsye se dividendi i shpërndarë nuk e mbulon këtë shumë, duke e parë këtë edhe në raport me pagat e të vëllait të subjektit, të cilat, nga formularët e dorëzuar prej tij për pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për këtë periudhë, rezultojnë të jenë në nivel mesatar”.

⁷⁸ Sipas përlllogaritjeve të Komisionit për huan 10.000 euro ose 1.400.000 lekë, u provua se dividendi i marrë prej 1.200.000 lekësh, nuk e mbulonte huan (për diferencën 200.000 lekë).

⁷⁹ Vendimi nr. 20/2021 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 17.

se ato figurojnë në emër të shoqërisë “{***}” ShPK dhe jo individit B. B.. Gjithashtu, nga verifikimi i akteve që janë administruar në Komision, rezulton se shoqëria “{***}” ShPK, ortak dhe administrator i së cilës është vëllai i subjektit, nuk ka shpërndarë dividend për ortakun e saj deri në vitin 2009 dhe fillon të shpërndajë për herë të parë dividend vetëm në vitin 2010. Në këto kushte, shuma prej 2.000.000 lekësh, e kaluar nga llogaria e shoqërisë te llogaria personale e personit tjetër të lidhur në vitin 2006, vit i cili nuk rezulton të ketë qenë i shoqëruar me shpërndarje dividendi dhe as rezulton ndonjë marrëdhënie që legjitimonte në një mënyrë apo tjetër përdorimin/zotërimin e kësaj shume të shoqërisë prej ortakut të saj, mbetet një pasuri e shoqërisë sipas konceptit të së ardhurës së ligjshme, por jo e ortakut të saj, personit tjetër të lidhur, z. B. B.. Në këndvështrim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, parë lidhur me nenin 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Kolegji vlerësoi si të drejtë qëndrimin e Komisionit në trajtimin e së ardhurës së ligjshme për personin tjetër të lidhur, dhe arriti në të njëjtin përfundim se, pavarësisht faktit se shoqëria “{***}” ShPK gjatë periudhës në analizë, rezulton të ketë qenë me fitim për të cilin janë likuiduar tatimet, ky fitim nuk është shpërndarë në formën e dividendit tek ortaku i saj, rrethanë e cila e bën shumën prej 2.000.000 lekësh si jo të krijuar me burime të ligjshme, në respektim të standardit kushtetues dhe ligjor në funksion të procesit të rivlerësimit. Pretendimet e subjektit se ato para kanë qenë në llogarinë personale të vëllait të tij, ndërsa provojnë ekzistencën e tyre, nuk shërbejnë për të kaluar testin e ligjshmërisë së burimit si një detyrim ligjor që buron nga neni 32/4 i ligjit nr. 84/2016. Kolegji nënvizon në këtë konkluzion jurisprudencën e gjerë të tij në këtë drejtim, e cila gjen zbatim edhe në trajtimin si më sipër⁸⁰.

28.3. Kolegji analizoi në funksion të verifikimit të burimeve të ligjshme për të paguar këstin prej 49.000 euro për apartamentin në vitin 2008 si edhe për të verifikuar burimin e ligjshëm të depozitës në “{***}” të krijuar në vitin 2003, marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me vëllain e bashkëshortes së tij A. S..

28.4. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, në strukturën e çmimit të paguar për porositjen e apartamentit me sip. 250 m², në kompleksin ““{***}””, “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit, si burim financimi, ka deklaruar: “[...] Çmimi i shitjes së ish-klinikës dentare 4.000.000 lekë, prej të cilave 1.500.000 lekë ishin paguar nga blerësi A. S., në tetor 2003 (deklaruar në mars 2004), ndërsa pjesa e mbetur u kompensua me vlerën e 19.000 eurove, marrë hua në dhjetor 2008, për apartamentin në “{***}” [...]”.

28.4.1. Në deklaratën periodike të vitit 2008, është deklaruar: “[...] Për këtë pagesë mora hua nga A. S. [...] vëllai i gruas L. B., pa interes, llogaria e tij bankare në “{***}” që ia kalon firmës ““{***}””. Shuma 19.000 euro [...]”. Në deklaratën periodike të vitit 2009, është deklaruar: “[...] Detyrime financiare për kontratën e porosisë së datës 13.12.2008 me firmën ““{***}””, për apartamentin në “{***}”. [...] A) Detyrime të krijuara e mbetura nga V. 2008: 1). Kunatit [...] mbetur borxh 19.000 euro. [...]”. Në deklaratën periodike të vitit 2012 është deklaruar: “[...] Pakësuar: Pas përfundimit të procedurës së blerjes së truallit dhe të regjistrimit në ZRPPP Kuçovë, u shit, u tjetërsua me kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.12.2012, pasuria ish-klinikë dentare në Kuçovë, te blerësi A. S. [...]. Çmimi i shitjes 4.000.000 lekë, prej të cilave pjesa prej 2.500.000 lekësh u llogarit në kompensim detyrimi tim të marrë në vitin 2008, në vlerën 19.000 euro për pagimin e kësteve të shtëpisë së re, në “{***}””. Dhe: “[...] U pagua shuma e

⁸⁰ Vendimi nr. 9/2019 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 12.6 dhe 16; dhe vendimi nr. 16/2020 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 15.3

marrë hua në dhjetor 2008, për blerjen e apartamentit në “{***}”, kunatit [...] A. S. siç kam deklaruar më parë, në deklarin e paraqitur në mars 2009, 2010, 2011, 2012. Shuma 19.000 euro. U likuidova totalisht me kunatin [...] A. S.. [...]”.

28.5. Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të huas nga z. A. S., në shumën prej 19.000 eurosh. Më herët, Komisioni ka marrë në shqyrtim dhe ka verifikuar edhe burimet e ligjshme të z. A. S. për të krijuar e për t’i dhënë hua subjektit shumën prej 1.500.000 lekësh në vitin 2002, duke konkluduar edhe për këtë shumë se subjekti nuk provoi mundësinë e z. Stavros për të krijuar me burime të ligjshme këtë pasuri. Kolegji mori në shqyrtim shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me këto konkluzione të Komisionit, sipas të cilave ai synon të provojë se kunati kishte mundësi të krijonte këto shuma në vitet 2002 dhe 2008 me burime të ligjshme.

28.5.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se provohet me provat e reja bashkëlidhur ankimit, se kunati i tij kishte krijuar të ardhura në periudhën 1995 - 2001, dhe se kunati që nga 06.01.2001 ka filluar të paguajë sigurimet shoqërore duke justifikuar çdo të ardhur të tij në bankë dhe jashtë saj. Sipas subjektit të rivlerësimit, në gjendjen e llogarisë prej 9.172.92 eurosh në datën 06.11.2001, referuar provave të reja sjellë bashkëlidhur ankimit⁸¹, janë të ardhura nga punësimi i deklaruar, për të cilin janë paguar tatime e sigurime shoqërore të siguruara nga puna që nga muaji prill 1998, dhe se kjo gjendje është mbartur në vitin 2002, dhe shtuar me të ardhurat gjatë vitit të kunatit dhe bashkëshortes së tij, dhe sipas lëvizjeve bankare në datën 17.09.2002, përfundimisht është tërhequr shuma prej 11.000 euro, për të përmbushur marrëveshjen verbale, sipas kontratës së huas, datë 19.09.2002.

28.6. Kolegji vëren se huaja prej 1.500.000 lekësh është marrë prej subjektit të rivlerësimit nëpërmjet kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol. datë 19.09.2002, sipas së cilës kjo shumë ishte marrë në dorëzim në datën e lidhjes së kontratës dhe se do të kthehej në datën 19.09.2005. Në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, është deklaruar librezja e kursimit në {***}, vlera prej 1.500.000 lekësh, me burim: “[...] Marrë nga kunati [...] si pjesë e marrëveshjes sonë për shitjen e pronës klinike dentare në Kuçovë [...]”, ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting*, për këtë shumë, subjekti deklaroi: “[...] Çmimi i shitjes së ish-klinikës dentare 4.000.000 lekë, prej të cilave 1.500.000 lekë ishin paguar nga blerësi A. S., në tetor 2003 (deklaruar në mars 2004) [...]”. Të njëjtin deklarin bën subjekti lidhur me këtë shumë edhe në deklaratën periodike të vitit 2012, kur deklaroi shitjen formale të klinikës në Kuçovë të kunati A. S.s.

28.7. Në vlerësim të këtyre rrethanave të faktit, Kolegji analizoi situatën faktike me qëllimin e përcaktimit të saktë ligjor të saj, pavarësisht pretendimeve të subjektit që synonin të provonin burimet e ligjshme të kunatit për të krijuar shumën prej 1.500.000 lekësh. Kolegji, nga analiza e fakteve që u përshkruan më lart, në zbatim të nenit 16/1 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësoi se marrëdhënia e subjektit me kunatin e tij A. S., e krijuar në vitin 2002, nuk është një marrëdhënie huaje, por një premtim për shitje. Vetë subjekti ka deklaruar se ai kishte marrë prej kunatit shumën prej 1.500.000 lekësh, në funksion të shitjes së mëvonshme formale të klinikës në Kuçovë, shitje e cila de fakto kishte ndodhur që të paktën në vitin 2003, ku ai e deklaroi fillimisht këtë pronë si

⁸¹ Vërtetimi i llogarive bankare, lëshuar nga {***}, datë 29.07.2019, drejtuar A. M. S.. Statement i lëvizjeve analitike të llogarisë bankare {***} me kod {***}, i datës 29.07.2019, lëshuar nga dega e {***}. Me vulë apostile, datë 01.08.2019. Vërtetohen nga vërtetimi i përkthimit i datës 21.08.2019, me nr. {***} rep. nga noteri B. Gj. V., me përkthyes R. M. K..

të shitur. Kjo marrëdhënie finalizohet në vitin 2012 dhe subjekti ka shpjeguar bindshëm arsyen e vonesës së kryerjes së veprimit juridik formal, për shkak të problemeve me fitimin e pronësisë së truallit dhe deklarohet si e tillë edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, dhe konfirmohet edhe nga regjistrimet në regjistrat publikë të pronës.

28.8. Në këto rrethana, Kolegji çmon se marrëdhënia juridike për shkak të së cilës subjekti mori prej kunatit shumë prej 1.500.000 lekësh në vitin 2002, nuk rezulton të jetë ajo e huamarrjes, por një parapagim në funksion të shitjes të klinikës dentare në Kuçovë, shitje e cila rezulton të jetë realizuar më pas edhe formalisht. Në këto kushte, Kolegji vlerësoi se kunati i subjektit A. S., nuk do të konsiderohet si person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016 lidhur me pasurinë 1.500.000 lekë, dhënë subjektit në vitin 2002, e për pasojë mbi subjektin nuk rëndon lidhur me këtë pasuri detyrimi për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj. Kolegji pavarësisht përpjekjeve të subjektit për të provuar mundësitë financiare të kunatit për krijimin e kësaj shume në vitin 2002, e konsideron këtë moment si irelevant lidhur me procesin e tij të rivlerësimit dhe konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë moment të padrejtë.

28.8.1. Kolegji në vijim vlerësoi marrëdhënien e subjektit me z. A. S. për marrjen hua të shumë prej 19.000 eurosh në vitin 2008, shumë e cila ka shërbyer si burim për shlyerjen e këstit prej 49.000 eurosh, paguar në vitin 2008 për apartamentin në “{***}”. Lidhur me këtë marrëdhënie, rezulton se subjekti ka bërë deklarime në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në ato periode të viteve 2008 e 2012, sipas të cilave kjo shumë është përshkruar si e marrë hua prej kunatit të tij A. S. dhe se kjo hua është shlyer pas realizimit të shitjes formale të klinikës në Kuçovë, duke kompensuar shlyerjen e saj me diferencën e çmimit të shitjes së kësaj pasurie, me shumë prej 1.500.000 lekësh, të paguar për llogari të këtij çmimi që në vitin 2002. Në këto rrethana, Kolegji e trajtoi këtë marrëdhënie si një marrëdhënie huaje dhe, në zbatim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, verifikoi mundësinë e personit tjetër të lidhur, A. S., për ta krijuar atë me burime të ligjshme. Lidhur me këtë shumë, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti ka mungesë dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të huas nga z. A. S., në shumë prej 19.000 eurosh.

28.8.2. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit duke argumentuar se të ardhurat e ligjshme për personin tjetër të lidhur, të vërtetuara⁸², ishin në shumë prej 23.000 eurosh për periudhën 2003 - 2007, ndërkohë që në referim të akteve të sjella së bashku me ankimin, për vlerën e gjendjes së depozitës prej 7.893,99 eurosh, deri në datën 31.12.2002, duhet t’u shtohen këtyre të ardhurave edhe kjo shumë, nga e cila do të rezultojë se në total, personi tjetër i lidhur ka pasur minimalisht në dispozicion të tij shumë prej 30.893,99 eurosh. Kjo shumë, sipas pretendimit të subjektit, ka qenë dhe është krejtësisht e mjaftueshme për të justifikuar me burime të ligjshme shumë prej 19.000 eurosh.

28.8.3. Në analizë të këtij shkak ankimi, Kolegji, nga aktet e administruara në fashikull, konstatoi se në datën 04.12.2008, nga llogaria e z. A. S. dhe znj. M. S., në llogari të shoqërisë ““{***}”” ShPK, ka kaluar shuma prej 19.000 eurosh, me përshkrimin: “[...] Kalim nga A. S. dhe L. B. për “{***}” ShPK, pagesë kësti për blerje apartamenti. [...]”. Kjo shumë, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.12.2012, rezulton se është konsideruar si e shlyer nëpërmjet likuidimit të një pjese të çmimit të shitjes së pasurisë klinike dentare, të ndodhur në Kuçovë. Në

⁸² Vërtetimi i datës 19.12.2018 i Institutit të Sigurimeve Shoqërore Greqi për vitet 2003 – 2007.

këto rrethana, provohet ekzistenca e kësaj marrëdhënieje huaje në kuptim të parashikimeve të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016 dhe e shlyerjes së saj në formën e përshkruar në kontratë.

28.8.4. Për sa i përket burimit të të ardhurave të kësaj shume, Kolegji, pasi bëri një vlerësim të përgjithshëm të situatës financiare të personit tjetër të lidhur për vitet 2002-2008, konstatoi se, përveç të ardhura prej 23.031,47 eurosh, të cilat janë përfituar prej tij dhe bashkëshortes nga punësimi në Greqi, e provuar me vërtetimin e datës 19.12.2018 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Greqi për vitet 2003 – 2007, që provon kriteret e konsiderimit të tyre si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, duket se njësia familjare ka pasur të ardhura që u kanë mundësuar atyre krijimin e disa depozitave në vite, krahas depozitës së përdorur për dhënien e huas subjektit në vitin 2008⁸³.

28.8.5. Duke pasur në konsideratë faktet e përmendura më lart, Kolegji çmon se në zbatim të interpretimit që i është bërë tashmë me jurisprudencën e tij nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, do të duhet të vlerësohet se personi tjetër i lidhur kishte mundësi të krijonte me burime të ligjshme shumën prej 19.000 eurosh deri në dhjetor të vitit 2008. Fakti që personi tjetër i lidhur provohet se ka mundur të krijojë me burime të ligjshme të paktën shumën prej 23.031 eurosh, por edhe se ka pasur në vazhdimësi likuiditete që i ka depozituar në sistemin bankar grek dhe shqiptar, të çon në konkluzionin se ai përmbush kriterin e krijimit me burim të ligjshëm të shumës prej 19.000 eurosh dhënë hua subjektit të rivlerësimit, hua e përdorur për të financuar një pjesë të kësaj prej 49.000 eurosh të çmimit të apartamentit në “{***}”. Bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilës neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon detyrimin e subjektit të rivlerësimit dhe personit tjetër të lidhur për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë objekt huaje apo dhurimi prej personit tjetër të lidhur, në këndvështrim të të gjitha fakteve të analizuara më lart, u arrit në konkluzionin se z. A. S. kishte mundësi të krijonte pasurinë likuiditet, të gjendur në llogarinë e sipërcituar, me burime të ligjshme.

28.8.6. Në përfundim të vlerësimit të këtij shkak, Kolegji vlerëson se kunati i subjektit të rivlerësimit, z. A. S., justifikonte me të ardhura të ligjshme shumën e huas prej 19.000 eurosh dhe qëndrimi i Komisionit për këtë hua është i gabuar dhe i pambështetur në fakte e në ligj.

28.8.7. Kolegji, pasi analizoi edhe konkluzionin e Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën prej 6.536 eurosh, sipas pretendimit të tij se ka paguar shumën 20.000 euro në fund të muajit dhjetor të vitit 2008, si dhe nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën 1.291.185 lekë, të pretenduar në tabelën e përlllogaritjeve nga eksperti kontabël, po për vitin 2008, (ky i fundit i përcaktuar dy herë si konkluzion), çmon se ky qëndrim i Komisionit është jokoherent me qëndrimet që ai vetë mban në konkluzionet e mësipërme. Ndërkohë që Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk e zotëronte këtë gjendje në *cash*, nuk mund ta penalizojë atë më pas, për mosdeklarimin e kësaj gjendjeje që nuk ekzistonte. Arsyetimi i Komisionit në këtë konkluzion, konsiderohet nga Kolegji si jologjik e i paarsyeshëm, për pasojë i padrejtë dhe jorelevant për çështjen.

⁸³ Sipas akteve në fashikuj, përkatësisht: a) depozitim në *cash* të shumës prej 5.000 eurosh, më 03.01.2008, në {***} dhe investuar në depozitë me afat për 3 muaj; b) marrëveshje për depozitë me afat, më 25.08.2004, të z. A. S. me {***}nr. {***}, në shumën prej 1.300.000 lekësh, me afat maturimi 1-vjeçar; c) marrëveshje për depozitë me afat, më 23.08.2004, të z. A. S. me {***} nr. {***}, në shumën prej 2.100.000 lekësh, me afat maturimi 1-vjeçar.

28.8.8. Në përfundim të analizimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me konkluzionet që i përkasin pagesës në vitin 2008, të shumës prej 49.000 eurosh, si këst për apartamentin në “{***}”, Kolegji arriti në përfundimin se qëndrojnë konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë çështje si më poshtë.

28.8.9. Subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të shlyer pagesën e këstit prej 10.000 eurosh dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera familjare deri në datën 18.10.2008, në vlerën prej 899.670 lekësh.

28.8.10. Subjekti nuk provoi se shuma prej 2.000.000 lekësh, marrë hua prej personit tjetër të lidhur, z. B. B., ishte krijuar me burime të ligjshme sipas përcaktimit të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

28.8.11. Për të dyja këto situata, Kolegji konstatoi se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme që kanë mundësuar pagimin e këstit prej 49.000 eurosh në vitin 2008.

29. Kolegji analizoi shkaqet e ankimit të subjektit që lidhen me konkluzionet e Komisionit për sa i përket ligjshmërisë së pagimit të këstit prej 41.000 eurosh, për çmimin e apartamentit në “{***}” deri më datë 03.06.2009. Lidhur me këtë pagesë, nga shqyrtimi i deklarimeve në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe atë periodike të vitit 2009, rezultoi se në deklaratën periodike të vitit 2009, në strukturën e kësteve të çmimit të paguar për porositjen e apartamentit me sip. 250 m², në kompleksin ““{***}””, “{***}”, Tiranë, është deklaruar: “[...] Kam vijuar pagesën e kësteve së bashku me kredinë, kam paguar 91.000 euro. Kam mbetur dhe 20.000 euro që duhet t’i paguaj në vitin 2010. Pasuria nuk është regjistruar dhe nuk ka përfunduar. Shlyerje e kësteve të kontratës së porosisë së apartamentit te firma ““{***}”” gjatë vitit 2009, 91.000 euro [50.000 euro kredi + 41.000 euro], mbetur 20.000 euro”. Dhe detyrime financiare: “[...] B) Detyrime të krijuara gjatë vitit 2009: 1).Vëllait B. B. nga llogaria në “{***}” [...] {***}. Mora borxh 10.000 euro. 2).Vëllait P. B., marrë borxh shumë 2.000.000 lekë, të cilat 1 milion nga llogaria në {***} me nr. {***} dhe 1 milion i kishte të lira. C) Në bankën {***} mora kredinë në shumë 50.000 euro [...]”.

29.1. Në lidhje me pagesat e kryera në vitin 2009, sipas analizës financiare të Komisionit, subjekti i rivlerësimit kishte mungesë të burimeve financiare në shumë prej 2.172.082 lekësh, për të justifikuar pagesën e shumës 41.000 euro për këtë pasuri deri në datën 03.06.2009, kishte kryer deklaram të rremë lidhur me burimin e krijimit të këstit prej 41.000 eurosh në vitin 2009 për këtë pasuri, pasi ka deklaruar si burim krijimi të tij dy hua të marra përtej kohës së shlyerjes, përkatësisht në shumë prej 1.000.000 lekësh nga vëllai, z. P. B., në datën 14.7.2009, dhe në shumë prej 10.000 eurosh nga vëllai, z. B. B., në datën 17.09.2009, dhe se nuk kishte deklaruar gjendjen *cash* në shumë prej 1.291.185 lekësh, të pretenduar në tabelën e përlllogaritjeve nga eksperti kontabël të vitit 2008, dhe të mbartur për shpenzimet e gjashtëmujorit të parë për vitin 2009.

29.2. Subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi konkluzionin e mësipërm të trupit gjykues të Komisionit, duke argumentuar se për periudhën 01.01.2009 - 03.06.2009, rezultati i analizës financiare do të ishte pozitiv në vlerën rreth (+) 192.000 lekë, me përfshirjen në analizë të mundësisë së kursimit nga viti 2008, në shumë prej 1.465.000 lekësh, huan afatshkurtër prej 700.000 lekësh, të marrë në maj dhe të shlyer në shtator të të njëjtit vit nga familja B.⁸⁴, përdorimin e mjeteve monetare në

⁸⁴ Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit referon dhe në huat e deklaruara në pyetësor, të mara nga vëllai z. B. B. në shumë prej 5.000 euro, marë në janar 2009 dhe në shumë prej 3.000 euro nga vëllai z. P. B., marë

shumën prej 200.000 lekësh, si aktive të arkëtueshme apo detyrime afatshkurtra me personat e tjerë, të tërhequra në cilësinë e pronares së klinikës. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit e kundërshton konkluzionin e trupit gjykues të Komisionit për mosdeklarimin e shumës prej 1.291.185 lekësh, të pretenduar në tabelën e llogaritjeve nga eksperti kontabël për vitin 2008⁸⁵, të mbartur sipas subjektit të rivlerësimit në shpenzimet e vitit 2009, duke argumentuar se përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit nuk lidhet me deklaratimet e tij dhe as me gjetjet e Komisionit, por me rezultate të llogaritura nga eksperti kontabël për mundësinë e kursimit, dhe se mosdeklarimi i mundësive të kursimit, lidhet me paqartësitë ligjore të formatit të deklaratës vjetore në ILDKPKI, të cilat kërkonin vetëm ndryshimet e gjendjes *cash*, jo vlerën totale të kësaj gjendjeje në fundin e vitit dhe se në fund, përgjegjësia ligjore e subjektit të rivlerësimit lidhet me saktësinë e deklaratës e pasurisë *vetting* dhe jo me ndonjë parregullsi të deklaratave periodike/vjetore.

29.3. Kolegji, duke vlerësuar pretendimet e subjektit si më sipër, arsyeton si më poshtë për secilin prej tyre. Lidhur me gjendjen *cash* të pretenduar prej subjektit se ka ekzistuar në vitin 2008 në vlerën prej 1.465.000 lekësh, e cila është përdorur në vitin 2009 për të mbuluar shpenzimet e këtij viti, duke rritur të ardhurat në funksion të analizës financiare, Kolegji vëren, siç ka arsyetuar edhe në lart se, në deklaratat periodike/vjetore për këto vite, nuk janë deklaruar likuiditete në *cash*, përfshirë këtu edhe deklaratën periodike/vjetore 2008, si edhe nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike/vjetore as përdorim apo pakësim i kësaj gjendjeje, por vetëm pagesat për detyrimet lidhur me çmimin e apartamentit me sip. 250 m², në kompleksin ““{***}””, “{***}”, Tiranë, huatë dhe kredinë. Kolegji rikthekson qëndrimin e tij të konsoliduar tashmë⁸⁶, se gjendja e likuiditeteve *cash* apo kursimet e shtuara kësaj gjendjeje nuk mund të provohen ndryshe në këtë proces, përveç se me deklaratat periodike, si i vetmi dokument i krijuar në kohën që pretendohet krijimi i kësaj pasurie që mund ta provojë atë. Nga shqyrtimi i të gjitha akteve të administruara gjatë hetimit, Kolegji nuk konstaton asnjë dokument tjetër ligjor në të cilin të gjejnë pasqyrim këto të dhëna, të cilat të mund të vlerësoheshin në drejtim të provueshmërisë së ekzistencës së kësaj pasurie. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit për gjendjet *cash* të mbartura në vite, por të padeklaruara në deklaratat periodike sipas detyrimeve ligjore të ligjit nr. 9049/2003, janë shfaqur për herë të parë vetëm pas njohjes prej tij me analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe vënien në dijeni për rezultatin financiar hipotetik që prodhon analiza, por në asnjë rast ky rezultat dhe kjo qasje ndaj tij nuk mund të barazohet me provueshmërinë e qenies së kësaj pasurie likuiditet në vitet që pretendon sot subjekti. Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji e çmon si të paprovuar pretendimin e subjektit se ai ka poseduar në fund të vitit 2008 një sasi likuiditeti, si shumatore e diferencave pozitive të viteve 2006-2008, të cilin nuk e ka deklaruar dhe për pasojë edhe përdorimin e këtij likuiditeti në vitin 2009 për të përballuar shpenzimet e këtij viti. Në këto rrethana, Kolegji, ashtu si edhe Komisioni, nuk e ka përfshirë këtë shumë si të ardhur në analizën financiare të vitit 2009.

29.4. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në analizën financiare të Komisionit duhet të përfshihej huaja afatshkurtër e marrë nga z. K. B. dhe znj D. B. në maj 2009, në shumën prej

në prill 2009, të cilat janë shlyer në dhjetor 2009, por që nuk janë deklaruar në deklaratën periodike/vjetore, dhe trupit gjykues i Komisionit i ka përfshirë në analizën financiare që i përket periudhës 01.01.2009 - 03.06.2009.

⁸⁵ Në analizën në ankim mundësia e kursimit *cash* në datën 31.12.2007, pretendohet në shumën prej 1.332.638 lekë, dhe në datën 31.12.2008, pretendohet në shumën prej 1.465.000 lekë.

⁸⁶ Vendim nr. 8/2019 (JR), datë 16.04.2019, paragrafi 43; vendim nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019, paragrafi 32.5; vendim nr. 29/2019 (JR), datë 08.11.2019, paragrafi 31; vendim nr. 1/2020 (JR), datë 15.01.2020, paragrafi 50; vendim (JR) nr. 11/2019, paragrafi 27; vendim (JR) nr. 19/2019, paragrafët 84-85; vendim (JR) nr. 20/2019, paragrafi 59; vendim (JR) nr. 20/2020, paragrafi 19.4; vendim (JR) nr. 12/2021; vendim (JR) nr. 27/2020, paragrafi 19.4.iii, 19.4.v.

700.000 lekësh, dhe përdorimin e mjeteve monetare prej 200.000 lekësh nga aktiviteti i klinikës së bashkëshortes. Në lidhje me këtë pretendim të tij, Kolegji konstaton se:

29.4.1. Për sa u përket pretendimeve për përfshirjen e huas afatshkurtër prej 700.000 lekësh, nga familja B. në maj 2009, rezulton se subjekti e ka deklaruar këtë burim financimi afatshkurtër për herë të parë në përgjigje të rezultateve të hetimit, dhe ka paraqitur në Komision, në mbështetje të këtij qëndrimi, deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.06.2019, të z. K. B. dhe znj. D. B., sipas së cilës ata i kanë dhënë një hua afatshkurtër familjes B. në muajin maj 2009, e cila u ishte shlyer atyre në datën 20.09.2009⁸⁷.

29.5. Në vlerësim të kësaj situatë, Kolegji, në mungesë të deklarimeve të kësaj marrëdhënieje në deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas detyrimit të udhëzimit nr. {***}, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Lartë të ILDKPKI-së⁸⁸ dhe në deklaratën periodike të vitit 2009, dhe as në ndonjë dokument ligjor të kohës kur ajo ka lindur apo afër saj, sheh të arsyeshme të risjellë në vëmendje se në vijim të jurisprudencës së Kolegjit, në vendime të marra edhe përpara vendimit objekt ankimi të Komisionit⁸⁹, deklarata noteriale e kryer gjatë rivlerësimit, pas rezultateve të hetimit administrativ, ka vlerë të kufizuar për sa i përket provueshmërisë së faktit që kërkon të provojë, duke qenë se është konsideruar si një përpjekje e subjektit, e diktuar nga nevoja për të justifikuar me burime të ligjshme një situatë negative financiare, të konstatuar nga hetimi. Deklaratat noteriale të përpiluara për këtë qëllim, konsiderohen si me një vlerë provuese të ulët, sa kohë që ato nuk mbështeten nga të dhëna të tjera që rezultojnë nga dokumentacioni ligjor i krijuar në mënyrë autonome e jashtë ndikimit të procesit të rivlerësimit.

29.6. Gjithashtu, përveç sa më sipër, ndonëse marrëdhënia e biznesit të personit fizik, që i përket personit të lidhur, dhe z. K. B. duket se ekziston referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti gjatë hetimit, ky fakt nuk konsiderohet i mjaftueshëm për konkluzionin se edhe vetë marrëdhënia e huas ka ekzistuar, për arsyt që u përmendën më lart. Kolegji konstaton se edhe në versionin se kjo marrëdhënie do të konsiderohej se provohej, asnjë provë nuk është paraqitur prej subjektit për të provuar mundësinë e këtij shtetasi për të krijuar me burime të ligjshme këtë shumë.

29.7. Pretendimi i subjektit se Komisioni ka njohur dhe konsideruar të provuar dy hua afatshkurtra të marra prej vëllezërve të tij, Bujar e P. B., përkatësisht në janar 2009 dhe në prill 2009, të cilat janë deklaruar në të njëjtat kushte si huaja e pretenduar se është marrë nga z. K. B., dhe kjo situatë demonstroi standard të dyfishtë të qëndrimeve të Komisionit, nuk vlerësohet nga Kolegji si një argument që duhet trajtuar në funksion të provueshmërisë së ekzistencës së marrëdhënies së huas. Ndërsa Kolegji nuk mund të analizojë e marrë në shqyrtim qëndrimin e Komisionit lidhur me dy huatë e pretenduara prej subjektit, duke qenë se ato nuk janë objekt i ndonjë shkakut ankimi dhe në konsideratë të parimit *non reformation in peius*, Kolegji ka detyrë të

⁸⁷ Së bashku me deklaratën, rezultojnë edhe certifikata e regjistrimit në QKR të “{***}” Person Fizik, disa fatura tatimore shitje me L. B. Person Fizik, dhe lëvizjet e llogarisë së {***} Fizik në {***}, për periudhën 30.01.2008 - 21.05.2008, në të cilën evidentohen pagesa të bëra nga L. B. Person Fizik për të konfirmuar marrëdhënien e biznesit.

⁸⁸ Udhëzimi i vitit 2016, dalë në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

⁸⁹ Paragrafët 35 dhe 36 në vendimin nr. 6/2018 (JR), dhe paragrafi 12.3 në vendimin nr. 11/2018 (JR). Po ashtu, shih edhe paragrafin 85.2 në vendimin nr. 34/2019 (JR), paragrafin 20.5 në vendimin nr. 2/2020 (JR), paragrafin nr. 41.2 në vendimin nr. 5/2020 (JR), paragrafin 26.2 në vendimin nr. 23/2020 (JR), paragrafin 28.7 në vendimin nr. 26/2020 (JR), paragrafët 32.5 dhe 34.3 në vendimin nr. 29/2020 (JR), paragrafin 20.5 në vendimin nr. 33/2020 (JR), paragrafin 16.6 në vendimin nr. 36/2020 (JR).

zbatojë ligjin në mënyrë të njëjlojtë për të gjitha subjektet dhe t'i japë përgjigje ligjore çdo çështjeje që i shtrohet për zgjidhje duke argumentuar si më sipër.

29.8. Në këto kushte, e gjithë marrëdhënia e huas me z. K. B.. ka mbetur e paprovuar prej subjektit të rivlerësimit dhe në nivel deklarativ, për pasojë kjo shumë nuk mund të konsiderohet si një burim i ligjshëm që ka shërbyer për financimin e pagesës së shumës prej 41.000 eurosh, më 03.06.2009.

29.9. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka konsideruar shpjegimet e tij për përdorimin e mjeteve monetare në shumën 200.000 lekë, të tërhequra nga të ardhurat e klinikës në cilësinë e pronarit, përdorimin e aktiveve të arkëtueshme apo detyrimeve afatshkurtra me personat e tjerë, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë këtë situatë të mjeteve të disponueshme nga klinika në momentin e përdorimit të tyre, duke qenë se në B.ncet e personit fizik nuk reflektohen, pasi janë lëvizje monetare të mbyllura brenda vitit. Subjekti i rivlerësimit ka rezultuar të jetë jokohorent dhe i qartë në këtë pretendim, duke qenë se ai nuk e ka përcaktuar qartësisht atë që në momentin e parë të prezantimit të tij, në përgjigje të rezultateve të hetimit, duke e përfshirë në shumën prej 900.000 lekësh, të pretenduar si të përdorur prej tij, së bashku me huan, por e ka saktësuar vetëm në ankim, pas njohjes me vendimin e Komisionit. Në këto kushte, ky pretendim mbetet gjithashtu deklarativ dhe i paprovuar në funksion të këtij procesi, për pasojë kjo shumë nuk do të konsiderohet si e ardhur në analizën financiare për vitin 2009.

29.10. Kolegji konstatoi se edhe në versionin që do të pranoheshin deklaratimet e subjektit për përfshirjen në analizën financiare të huas afatshkurtër nga z. K. B.. dhe znj. D. B. prej 700.000 lekësh, dhe përdorimin e aktiveve afatshkurtra e detyrimeve afatshkurtra të aktivitetit të bashkëshortes prej 200.000 lekësh, sërish subjekti i rivlerësimit do të kishte mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar pasuritë, me diferencë negative prej (-) 1.272.082 lekësh.

29.11. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit të detajuara në parashtrime lidhur me analizën e periudhës 01.01.2009 – 03.06.2009, dhe përfshirjen në këtë analizë të të ardhurave nga pagat e subjektit deri më 03.06.2009, që sipas tij duhej të ishin në vlerën prej 536.000 lekësh⁹⁰, duke argumentuar se ka përfituar të ardhurat nga paga e periudhës 15 – 31 dhjetor 2008, në vlerën neto 29.455 lekë (e cila ka kaluar në bankë në janar 2009), si dhe ka pasur shpërblime për punë jashtë orari, Kolegji vëren se sipas lëvizjes së llogarisë bankare në Raiffeisen Bank, subjekti i rivlerësimit nga janar 2009 – 03.06.2009 [paga e fundit, marrë më 29.05.2009 prej 80.830 lekësh] ka përfituar paga dhe honorare në shumën prej 495.990 lekësh, vlerë në të cilën janë të përfshira, sipas lëvizjes së llogarive bankare, edhe vlera 29.455 lekë, kaluar në llogari më 05.01.2009, honoraret e kaluara në llogari në datat 23.04.2009, 05.05.2009 dhe 20.05.2009. Në këto kushte, rezulton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk mbështetet nga të dhënat që rezultojnë prej dokumentacionit bankar, ndërsa konfirmohet si e saktë vlera e konsideruar nga Komisioni prej 495.990 lekësh, si të ardhura të cilat janë kredituar në llogari.

29.12. Lidhur me pretendimet që i referohen kalkulimit jo të saktë të të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortes për periudhën 01.01.2009 deri në 03.06.2009, Kolegji i verifikoi dhe vlerësoi ato në mënyrë analitike, sipas vlerësimit në vijim.

⁹⁰ Shtesë + 40.010 lekë, krahasuar me Komisionin që ka konsideruar vlerën 495.990 lekë.

29.12.1. Së pari, lidhur me vlerën e amortizimit të cilën subjekti pretendon se Komisioni ia ka zbritur padrejtësisht në analizën e kryer për periudhën 01.01.2009 - 03.06.2009, në masën prej 290.000 lekësh, që i takon $\frac{1}{2}$ së vlerës së amortizimit të klinikës në “{***}”, Tiranë. Nga vlerësimi i dokumentacionit financiar, rezulton se Komisioni ka konsideruar në analizën financiare si të ardhura të bashkëshortes nga biznesi deri në datën 03.06.2009, vlerën prej 1.099.348 lekësh [= 2.638.435/12 muaj \times 5 muaj], e cila është përpjesëtimore e vlerës 2.638.435 lekë⁹¹ që përfshin fitimin neto të vitit 2009 dhe amortizimin e plotë të vitit, prej 1.457.968 lekësh. Kjo vlerë i korrespondon plotësisht vlerës që do i takonte hipotetikisht të kishte përfituar bashkëshortja e subjektit në fund të muajit maj nga biznesi i saj. Nga vlerësimi i bërë në Kolegj, nuk rezulton që shifra e Komisionit të ketë pasaktësi siç pretendon subjekti i rivlerësimit, për pasojë kjo e dhënë e analizës për këtë periudhë do të mbetet e pandryshueshme⁹².

29.12.2. Për sa u përket të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortes, subjekti ka pretenduar se duhet të jenë më të larta sepse duhet të ulen shpenzimet e biznesit për pagesat e sigurimeve shoqërore për punonjësit deri më 03.06.2009, të cilat nuk duhet të konsiderohen të shpërndara në mënyrë përpjesëtimore, por duhen llogaritur sipas situatës konkrete të pagesave të tyre. Kolegji, pasi verifikoi të dhënat që dalin nga aktet e administruara, konstatoi se sipas pasqyrës “Të ardhura shpenzime” për vitin 2009 të biznesit të bashkëshortes së subjektit, vlera paga + sigurime është 399.280 lekë, përpjesëtimorja zbritur të ardhurave nga aktiviteti tregtar në analizën e Komisionit është vlera 166.367 lekë [= 399.280 lekë /12 muaj \times 5 muaj]. Ndërsa subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo shumë, e konsideruar e zbritur nga xhiroja e aktivitetit për të nxjerrë fitimin neto, nuk duhej zbritur e plotë, pasi deri në datën 03.06.2009, nuk ishin paguar të gjitha këto detyrime, por vetëm një pjesë e tyre, sipas lëvizjeve bankare të personit të lidhur në {***}, rezulton se janë paguar paga për një punonjëse tjetër⁹³, përfshirë pagën e muajit maj, në datën 27.05.2009. Ndërsa, për sa i përket pretendimit se sigurimet e tremujorit të dytë prill – maj 2009 janë paguar në korrik, ky pretendim u gjet i drejtë, por duke qenë se sipas lëvizjeve bankare të personit të lidhur në {***}, konstatohet se janë paguar më 19.01.2009 sigurimet e muajit dhjetor të vitit të mëparshëm, kjo pagesë kompenzon ato të 3-mujorit të dytë të vitit 2009 dhe nuk prodhon ndonjë efekt financiar për pasojë. Në këto kushte, pretendimet e trajtuara më sipër, nuk prodhuan të dhëna të ndryshme që do duhet të gjenin pasqyrim në analizën financiare të subjektit, të ndryshme nga ato që kishte konkluduar Komisioni.

29.12.3. Për sa u përket të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortes, lidhur me pagesën e Tatimit mbi Fitimin e vitit 2009, subjekti i rivlerësimit pretendon se ndryshe nga përlllogaritja e Komisionit (në vlerën 131.163 lekë), deri në datën 03.06.2009, është paguar vetëm kësti i tremujorit të parë në shumën prej 22.500 lekësh, ndërsa pjesa tjetër është shlyer në korrik, shtator, dhjetor 2009, dhe shtesa prej 41.163 lekësh është paguar në mars 2010. Kolegji vëren se duke e korrigjuar këtë veprim, duke konsideruar vetëm vlerën e pretenduar të paguar të tatimit prej 22.500 lekësh, do duhej të shtohej dhe vlera prej 4.355 lekësh, e paguar në datën 24.03.2009, shtesë për tatim fitimin

⁹¹ Totali i fitimit neto të vitit 2009 prej 1.180.467 lekësh + amortizimi prej 1.457.968 lekësh.

⁹² Pra vlerës që pretendon subjekti të përfshihet në analizë prej 1.570.000 lekësh, duhet t'i zbritet vlera prej 290.000 lekësh [pra, ngelet vlera prej 1.280.000 lekësh].

⁹³ 5 paga në shumën prej 19.912 lekësh \times 5 = 99.560 lekësh.

e vitit 2008⁹⁴. Në këto kushte, vlera sipas analizës financiare të Komisionit, në shumën prej 1.099.348 lekësh, duhet të ishte korrigjuar në shumën prej 1.127.144 lekësh⁹⁵.

29.12.4. Në përmbyllje, edhe duke korrigjuar të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, referuar efektit të tatimeve, paguar për kohën [deri 03.06.2009], në raport me vlerën e konsideruar në analizën e Komisionit si të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortes prej 1.099.348 lekësh, në vlerën e korrigjuar prej 1.127.144 lekësh, subjekti do të rezultonte sërish me diferencë negative prej (-) 2.144.286 lekësh për periudhën e analizuar, pra me mungesë të burimeve të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e kryera dhe pagesat e kësteve për pasurinë në “{***}”, për periudhën 01.01.2009 - 03.06.2009, nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur.

29.12.5. Ndërsa nga deklaratimet e analizuara më lart, rezulton se subjekti ka shlyer këstin prej 41.000 eurosh deri në datën 03.06.2009, ai ka deklaruar si burim për financimin e këtyre pagesave në vitin 2009, dy hua të marra prej vëllezërve të tij, Bujar e P. B., të përshkruara në deklaratat më lart. Komisioni, pasi ka verifikuar mundësinë e këtyre shtetasve, të konsideruar si persona të tjerë të lidhur sipas nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, për të krijuar me burime të ligjshme shumat e dhëna hua, ka konkluduar se ata nuk kanë provuar me dokumentacion ligjor se të ardhurat e përdorura për financimin e këtyre huave janë të ardhura të ligjshme, në kuptim të ligjit.

29.13. Lidhur me shumën prej 10.000 eurosh, deklaruar se është marrë hua nga vëllai B. B., Kolegji, pasi verifikoi dokumentacionin e administruar, konstatoi se z. B. B. kishte tërhequr në datën 17.09.2009, nga llogaria e tij personale në “{***}”, këtë shumë, me përshkrimin: “tërheqje nga B. B., dhënë borxh Gurali Brahimllari”. Nga shkresa nr. {***} prot., datë 07.01.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (në vijim “DRTT”), rezulton se për vitin 2009, shoqëria “{***}” ShPK kishte shpërndarë dividend në shumën prej 1.200.000 lekësh, mbi të cilin ishte paguar tatimi mbi dividendin, në shumën prej 120.000 lekësh. Mbi këtë të dhënë, Komisioni ka konsideruar se personi tjetër i lidhur nuk arrin të mbulojë shumën prej 10.000 eurosh të dhënë hua, me shumën e përfituar si dividend në vitin 2009, dhe ka konkluduar se personi tjetër i lidhur nuk provon krijimin me burime të ligjshme të kësaj shume.

29.13.1. Në analizë të pretendimit të subjektit lidhur me këtë konkluzion, Kolegji konstatoi se nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 30.04.2019, të shoqërisë “{***}” ShPK, dhe bilanceve të vitit 2009 të kësaj shoqërie, rezulton se në vitin 2009 nuk ishte kryer shpërndarje e fitimit në formën e dividendit, ndërsa rezulton se efektivisht shuma prej 1.200.000 lekë që i përket vitit ushtrimor 2009, është shpërndarë në vitin 2010. Ky fakt gjen pasqyrim shprehimisht në B.ncin e vitit 2010, nga i cili rezulton “divident i paguar”, shuma prej 1.200.000 lekësh në “Pasqyrën e flukseve të parasë për periudhën 01 janar - 31 dhjetor 2010”. Po ashtu, tatimi mbi të ardhurat nga shpërndarja e fitimit në formën e dividendit në shumën prej 120.000 lekësh, rezulton të jetë paguar në datën 30.07.2010. Në këto kushte, Kolegji vëren se në kohën e marrjes së huas prej 10.000 eurosh, në datën 17.09.2009, personi tjetër i lidhur B. B. nuk e kishte përfituar efektivisht fitimin e këtij viti ushtrimor, i cili është shpërndarë në vitin pasardhës kalendarik, duke e bërë praktikisht

⁹⁴ Sipas lëvizjeve të llogarisë bankare të L.B. person fizik në {***}.

⁹⁵ Llogaritur: vlerës 1.099.348 lekë, pra të ardhurat e konsideruara nga aktiviteti në analizën e Komisionit, duke shtuar përpjesëtimoren e tatimit total të vitit 2009 prej 131.163 lekësh/12 muaj x 5 muaj = 54.651 lekë, zbritur 90.000 lekë tatimi i vitit/4 pagesa, pra pjesa 22.500 lekë, tatimi i tremujorit të parë, si dhe zbritur pagesa e 4.355 lekëve, e paguar shtesë për tatim fitimin e vitit 2008, më 24.03.2009.

të pamundur justifikimin e kësaj shume me të ardhura të formalizuara si fitim i ortakut nga shoqëria “{***}” ShPK.

29.13.2. Kolegji, në këto kushte, verifikoi edhe mundësinë e personit tjetër të lidhur të krijonte këtë shumë nëpërmjet të ardhurave të krijuara nga pagat e tij dhe bashkëshortes së tij, duke qenë se ky pretendim ishte shprehur prej subjektit gjithashtu, dhe nga analiza financiare e kryer edhe mbi këto të dhëna⁹⁶, përsëri rezultoi se ai gjendej në kushtet e pamundësisë për të krijuar këtë shumë me burime të ligjshme. Vetë subjekti i rivlerësimit ka pranuar gjatë procesit, por edhe në ankim, se veprimtaria e vëllait të tij në administrimin e biznesit dhe fitimeve ishte zhvilluar deri në këtë vit, 2009, në trajta informale, si pjesa më e madhe e aktiviteteve private në vend në atë kohë, por ky pretendim, ndonëse përdoret për të justifikuar mungesën e provueshmërisë së burimeve të ligjshme, konfirmon pikërisht situatën e pamundësisë dhe dështimit të subjektit të rivlerësimit për të zbatuar detyrimin ligjor që vjen nga neni 32/4 i ligjit nr. 84/2016 për të provuar burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë së dhënë hua.

30. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave për justifikimin e shumës të marrë hua në vlerën prej 10.000 eurosh, nga vëllai B. B., në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

30.1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, sikundër u përmend më lart, se për përballimin e pagimit të këstit prej 41.000 eurosh në vitin 2009, ka shërbyer ndër të tjera edhe huaja e marrë prej vëllait të tij, z. P. B., në shumën prej 1.000.000 lekësh, në datën 14.08.2009. Edhe për këtë shumë, Komisioni ka arritur në përfundimet se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume.

30.2. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton konkluzionin e Komisionit, me argumentin se disponimi i z. P. B., në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë “{***}” ShPK, sipas vendimit nr. {***}, datë 20.06.2009, ndonëse cilësohet për mbajtje në rezervë të vlerës monetare prej 2.306.414 lekësh, e gërshetuar kjo shumë me të ardhurat e tjera familjare e personale, duhet të krijonte bindjen te trupi gjykues i Komisionit se huadhënësi kishte burime të ligjshme për të justifikuar huan. Në vijim, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar e në kundërshtim me ligjin fiskal, dhe se nga përgjigja e DRTT-së nuk është vënë në dyshim pagimi i tatimit të shoqërisë për të ardhurat e vitit 2008 e as tatimi mbi fitimin për vitin 2009, dhe se destinimi i fitimit të vitit ushtrimor 2009 nga shoqëria “{***}” ShPK është marrë në qershor - korrik 2010, sipas të dhënave të DRTT-së. Më tej, subjekti arsyeton se huadhënësi, ortakut i vetëm, nuk mund të shpërndajë dhe të përdorë dividendin që rezulton nga veprimtaria tregtare e vitit 2009, të cilin e bën në vitin 2010. Në këtë logjikë, ka pretenduar se ndryshe nga Komisioni, analiza duhet të bëhet mbi vlerën e dividendit që i takon vitit ushtrimor 2008 e që është shpërndarë në vitin 2009 dhe jo siç ka arsyetuar Komisioni, i cili ka mbështetur analizën mbi vlerën e dividendit të vitit 2009, i cili realisht është shpërndarë në vitin 2010.

⁹⁶ Referuar të ardhurave nga pagat e z. B. B. dhe bashkëshortes së tij, sipas vërtetimeve të datës 24.05.2019, referuar të ardhurave të vitit, për vitin 2009 kanë përfutuar të ardhura neto për gjithë vitin nga paga për një total prej 1.007.496 lekësh (759.096 lekë z. B. B. dhe 248.400 lekë bashkëshortja e tij nga kompania {***} ShPK), pra deri në gusht 2009, në mënyrë përpjesëtimore kanë përfutuar 671.664 lekë të ardhura nga paga neto, me të cilat nuk do mund të mbulonin shumën e dhënë hua prej 10.000 eurosh, pa përfshirë shpenzime jetese të familjes me 4 persona, sipas certifikatës familjare.

30.3. Kolegji, në analizë të këtij pretendimi, konstaton se më datë 14.08.2009, z. P. B., nga llogaria personale në {***} ka tërhequr shumën prej 1.000.000 lekësh, me përshkrimin: “[...] P. B. / dhënie hua për Gurali Brahimllari”. Rezulton se në datën 31.07.2009, nga llogaria e shoqërisë “{***}” ShPK, në llogarinë personale të ortakut të kësaj shoqërie, z. P. B., ishte transferuar shuma prej 1.020.000 lekësh, me përshkrimin: “{***}” ShPK për P. B. / shpenzime personale”.

30.4. Përkundër pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se huaja prej 1.000.000 lekësh nga z. P. B., ka burim transfertën e kryer nga shoqëria “{***}” ShPK, me qëllim shpenzime personale të ortakut të saj, duke u përjashtuar në këtë mënyrë si burim i kësaj huaje të ardhurat e tjera familjare apo personale të z. P. B., të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit. Për sa i përket ligjshmërisë së burimit nga shoqëria “{***}” ShPK, Kolegji vëren se, sipas raportit të kontrollit përfundimtar, datë 02.07.2013 të DRTT-së⁹⁷ për B.ncin e vitit 2009 të shoqërisë “{***}” ShPK, rezervat e shoqërisë rezultuan në vlerën prej 2.416.828 lekësh, pra rritur me vlerën prej 2.316.414 lekësh, sipas vendimit të ortakut të vetëm nr. 4 datë 20.06.2009. Kjo e dhënë vlerësohet nga Kolegji në këndvështrimin që këto vlera të kategorizuara si rezerva të shoqërisë, ndërkohë që krijohen nga pjesa e fitimit të shoqërisë për të cilin paguhen detyrimet tatimore sipas nenit 8 të ligjit nr. {***}, nuk janë likuiditete/pasuri e ortakut të shoqërisë dhe, si të tilla, ato konsiderohen vetëm kur i nënshtrohen shpërndarjes si dividend dhe pagimit të detyrimeve tatimore mbi to.

30.5. Në këto kushte, Kolegji konstaton se edhe për shumën prej 1.000.000 lekësh, subjekti nuk arriti të provojë bindshëm se personi tjetër i lidhur, z. P. B., e kishte krijuar atë me të ardhura të ligjshme, në kuptim të përcaktimit të nenit 3, pika 19 e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

30.6. Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit që lidhet me konkluzionin e Komisionit, sipas të cilit subjekti ka kryer deklaram të rremë lidhur me burimin e krijimit të kështit prej 41.000 eurosh në vitin 2009, pasi ka deklaruar si burim krijimi të tij dy hua të marra përtej shlyerjes, përkatësisht në shumën 1.000.000 lekë, marrë shtetasit P. B., në datën 14.8.2009 dhe 10.000 euro marrë shtetasit B. B., në datën 17 shtator të po këtij viti.

30.7. Pasi analizoi rrethanat në të cilat subjekti ka kryer deklaramet lidhur me përdorimin e këtyre dy huave, Kolegji çmon se nuk ndodhemi para situatës faktike që do përcaktohej si dëshmi e reme. Deklarimi i subjektit lidhur me përdorimin e këtyre huave, si burim për financimin e pagimit të kështit i cili është paguar realisht në kohë para marrjes së huave, nuk ka pasur për qëllim të përcaktojë kronologjinë e veprimeve financiare dhe juridike të kryera, por të referojë thelbin e të drejtave që kanë lindur prej tyre e që kanë shuar detyrimet që kanë ekzistuar, në harkun kohor të një viti kalendarik. Subjekti, pavarësisht se nuk ka qenë i plotë dhe i saktë në përshkrimin e konceptimit të përdorimit të huave si burim, i ka referuar ato si të tilla në raport me datën 31.12.2009, duke deklaruar sipas këndvështrimit të tij, të drejtat dhe detyrimet e lindura dhe shuara gjatë vitit. Kjo mënyrë e të përshkruarit të burimeve, aq më shumë në deklaratat periodike dhe në atë të pasurisë *vetting*, nuk e bën subjektin përgjegjës qoftë për deklaram të pasaktë sipas ligjit dhe aq më pak për deklaram të rremë sipas nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, Kolegji e gjen të pambështetur në fakte e në ligj këtë konkluzion të Komisionit.

30.8. Përfundimisht, pas vlerësimit të të gjitha shkaqeve të ankimit që lidheshin me konkluzionet e Komisionit lidhur me burimet e ligjshme të subjektit që kanë mundësuar pagimin e kështit prej 41.000 eurosh, Kolegji gjen të drejta konkluzionet si më poshtë.

⁹⁷ Bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 18.04.2019.

30.9. Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pagimin e këstit prej 41.000 eurosh dhe kryerjes së shpenzimeve të tjera familjare deri në datën 03.06.2009, në një vlerë prej (-) 2.144.286 lekësh, duke u gjendur në situatën faktike të parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

30.10. Subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 10.000 eurosh, marrë hua prej personit tjetër të lidhur, z. B. B., dhe shumës prej 1.000.000 lekësh, marrë hua prej personit tjetër të lidhur, z. P. B., në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

31. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në analizën financiare të kryer nga Komisioni nuk duhej të konsiderohej gjendja e “arkës” së pasqyrave të personit fizik, e barabartë me gjendje likuiditeti *cash*, mospërlllogaritja e cilës do të jepte rezultat përfundimtar përgjithësisht pozitiv lidhur me analizën e viteve 2010 – 2016, Kolegji vëren se:

31.1. Së pari, subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortes së tij në vite, si vijon: *Nga aktiviteti privat: xhiro qarkulluese e realizuar në total: mbi 80.200.000 lekë. Fitim neto i realizuar ndër vite, gjithsej: mbi 47.000.000 lekë, (fitim i ndarë në vite si vijon 1994-1997 = 3.000.000 lekë, 1998-2007 = 17.000.000 lekë, 2008 - 28.01.2017 = 27.000.000 lekë).* Në deklaratat vjetore ndër vite ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti duke përlllogaritur *xhiron dhe zbritur shpenzimet, por nga këto shpenzime janë përjashtuar amortizimi i aktiveve afatgjata apo duke konsideruar fitimin neto sipas pasqyrave financiare dhe duke shtuar amortizimin e aktiveve afatgjata, si element i “Pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve” (PASH) e duke emërtuar këto vlera si “Të ardhurat neto faktike nga aktiviteti tregtar i klinikës dentare” nga deklaratat vjetore e vitit 2014 e në vijim. Në deklaratën vjetore të vitit 2014 e në vijim, ku ka deklaruar përveç të ardhurave neto (ose fitimit neto), sipas B.ncit tregtar, ka deklaruar dhe “Të ardhurat neto faktike” duke i përlllogaritur shumat e deklaruara si total i *fitimit neto shtuar (+) amortizimin e aktiveve afatgjata apo shtuar/ zbritur (+/-) tatimin mbi fitimin sipas kohës kur është paguar dhe duke zbritur (-) vlerat e asetëve të reja (pajisjeve) që ka blerë.* Subjekti ka shprehur dhe në deklaratat vjetore gjatë viteve në ILDKPKI dhe gjatë procesit të hetimit në Komision, se amortizimi i aktiveve afatgjata nuk duhet zbritur si shpenzim në përlllogaritjen e të ardhurave nga aktiviteti i Personit Fizik pasi nuk janë shpenzime reale apo lëvizje monetare.*

31.2. Së dyti, konstatohet se, referuar analizës së kryer nga Komisioni për periudhën nga 2008-2016, në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, janë përfshirë dhe elemente të aktivitetit të bashkëshortes së tij si Person Fizik (në vijim “PF”), si: Të ardhura: a) *fitimi neto* ndër vite sipas pasqyrave financiare⁹⁸ për vitet 2008 – 2016, shtuar dhe b) *amortizimin e aktiveve afatgjata.* Subjekti i rivlerësimit që nga viti 2008 e në vijim, ka deklaruar si të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortes së tij, atë që ai e ka quajtur fitimin faktik, të përbërë nga të ardhurat nga aktiviteti si fitimi neto, duke shtuar dhe vlerën që i korrespondon zërit “amortizim”, në pasqyrat financiare të biznesit. Pasuri: a) blerje aparature për klinikën dentare më 14.11.2014, në vlerën 3.200 euro (ose 446.752 lekë;) dhe b) autoveturë Audi A5, blerë më 13.08.2014, në shumën 21.000 euro (ose 2.917.740 lekë) – deklaruar në deklaratën vjetore 2014 si shtesa në aktivet e konsumit afatgjatë të aktivitetit të bashkëshortes së subjektit si PF, me burim krijimi të ardhurat e realizuara nga veprimtaria tregtare, e regjistruar PF në

⁹⁸ Referuar pasqyrave financiare të mikronjesisë nga 2009 – 2016, sjellë bashkëlidhur shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore nr. {***}, datë 08.01.2019 (Fashikujt 10 dhe 10/1).

profesionin e stomatologes.

31.3. Ndryshime likuiditeti (gjendja në fund - gjendja në fillim të vitit), Komisioni ka përfshirë gjendjen likuiditete në bankë (nga 2008 – 2016 kur rezultojnë balanca) dhe të likuiditeteve “arka”, sipas pasqyrave financiare të aktivitetit të bashkëshortes si PF ndër vite (nga 2010-2016, kur rezulton gjendja e deklaruar “Arka”), duke i konsideruar ato si likuiditete *cash për llogari të njësisë familjare*.

31.4. Sipas analizës financiare të kryer në Komision, për vitet nga 2010-2016, ku Komisioni ka konsideruar dhe gjendjen “arka” si likuiditet *cash* në analizë, kanë rezultuar me diferenca negative vitet: 2010 prej – 1.562.349 lekësh, 2011 prej – 1.917.097 lekësh, 2012 prej – 2.137.681 lekësh, 2014 prej – 1.018.272 lekësh, me një total vlerash negative prej 6.635.399 lekësh.

31.5. Subjekti, në përgjigje të rezultateve hetimore paraprake, ashtu dhe në ankim, ka shpjeguar dhe kërkuar nga Komisioni moskonsiderimin e gjendjes “arka” sipas pasqyrave financiare të PF, të ekuivalentuar me gjendje “cash” në analizën financiare të kryer për njësinë ekonomike familjare, pasi gjendja “arka” sipas pasqyrave financiare të PF, nuk ka qenë reale, por ka qenë një lapsus/gabim material i përpilueses së pasqyrave financiare dhe/ose paaftësi e saj për të interpretuar si duhet ligjin dhe udhëzimet “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, e cila nuk ka vendosur “Vlerën monetare për shpenzime familjare e personale të pronarit të P.Fizik” në pasqyrën e pasiveve dhe kapitalit, dhe për pasojë, mosvendosja në B.nc, në kapital, të zërit “Vlera e tërheqjeve të kryera nga pronari gjatë periudhës” ka rritur totalin e pasiveve dhe në këtë mënyrë në aktive është rritur zëri “arka”. Subjekti gjithashtu ka theksuar se ekonomistja ka reflektuar paraqitjen e këtij zëri “Vlera e tërheqjeve të kryera nga pronari gjatë periudhës” në B.ncet e viteve 2016⁹⁹ e më tej në B.ncet e viteve 2017 dhe 2018.

31.6. Në lidhje me pretendimin e subjektit për të mos konsideruar gjendjen “arka” si likuiditet *cash* që rëndon ekonominë familjare, Kolegji vlerësoi këtë pretendim në raport me detyrimet që subjekti ka në zbatim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtyre dispozitave, subjektet kanë detyrimin të deklarojnë e provojnë të ardhurat e tyre të ligjshme sipas përcaktimit të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, të ardhura të cilat vlerësohen nga organet e rivlerësimit nëse arrijnë të mbulojnë pasuritë e krijuara prej subjekteve, si edhe shpenzimet e kryera prej tyre, në funksion të vlerësimit të kriterit të pasurisë. Në këndvështrimin e Kolegjit, këto të ardhura dhe këto pasuri do t’u referohen atyre të hyra në njësinë familjare, e të deklaruara si të tillë, gjithmonë pas plotësimit të kriterit të të ardhurës së ligjshme, në rastin konkret, Komisioni ka konsideruar si të tilla ato të deklaruara prej subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën periodike në vitet e deklaruara në tatime prej aktivitetit. Duke qenë se Kolegji gjendet në situatën kur Komisioni i ka njohur të ardhurat ashtu siç i ka deklaruar subjekti për periudhën 2010 - 2016, duke konsideruar fitimin faktik të deklaruar prej tij, dhe nuk ka asnjë shkak apo pretendim të ngritur në ankim rreth këtij zëri, po në të njëjtën mënyrë janë konsideruar prej Kolegjit të ardhurat edhe në analizën financiare të kryer në funksion të këtij gjykimi.

31.7. Ndërsa Komisioni ka konsideruar si pasuri të njësisë familjare edhe gjendjen “arka” që figuron e deklaruar në B.ncet e personit fizik, që zotërohet prej personit të lidhur, Kolegji e

⁹⁹ Zëri “Vlera e tërheqjeve të kryera nga pronari gjatë periudhës” në bilancin e vitit 2016 ka pasur vlerën 1.950.000 lekë.

vlerëson këtë qëndrim të pambështetur në fakte e në ligj.

31.7.1. Së pari, edhe sikur kjo gjendje të ekzistonte, ajo do të ishte një pasuri që do t'i takonte ekonomisë së biznesit të bashkëshortes së subjektit dhe jo një pasuri e njësisë familjare, për pasojë, vlerësimi i saj do të duhej të kryhej nga organet e ngarkuara me kontrollin e aktivitetit ekonomik të personit fizik, i cili do të kontrollonte deklaratimet e kryera në funksion të shlyerjes së detyrimeve fiskale ndaj shtetit dhe përcaktimin në përfundim të këtij kontrolli të detyrimeve tatimore për t'u paguar. Kjo pasuri nuk mund të konsiderohet se i takon njësisë familjare, për sa kohë që i nënshtrohet regjimit të personit fizik.

31.7.2. Së dyti, subjekti ka pretenduar se kjo gjendje nuk ka ekzistuar realisht, ashtu siç është përshkruar në B.ncet e personit fizik, duke qenë se ajo ka qenë e përfshirë brenda të ardhurave të deklaruara si të fituara prej bashkëshortes e të cilat u janë nënshtuar tatimeve dhe që janë poseduar përgjatë viteve ushtrimore prej bashkëshortes, e cila në këtë rast është identifikuar me vetë personin fizik dhe ka përdorur të gjitha shumat monetare të cilat përbëjnë fitimin e vitit, e të cilat janë pasqyruar gabimisht në B.ncin kontabël, ndërkohë që duhej të ishin përfshirë në zërin “tërheqje e pronarit”, siç është bërë në B.ncet e përditësuara më pas në vitet 2016 e vijim. Në asnjë rast, subjekti nuk ka pretenduar se kjo vlerë duhet të shtohet në të ardhurat e biznesit të bashkëshortes e të rrisë në këtë mënyrë shumat monetare që kanë hyrë në njësinë familjare. Kjo skemë shpjegimi që është ndërtuar nga subjekti, bëhet e besueshme për trupin gjykues, duke qenë se nga analiza e bërë në Kolegj, shumatorja e gjendjes së “arkës” në vite, ndryshimet e së cilës përbëjnë “tërheqje të pronarit”, është e njëjtë me shumatoren e vlerave që kanë rezultuar nga analizimi i pasqyrave financiare sipas akteve në fashikuj, të dorëzuara në tatime për vitet 2010 - 2016, për të cilat konstatohet në analizë të tyre, se seksioni “kapitali” ka pasur ndryshime ndër vite, pavarësisht se në pasqyrat financiare nuk janë reflektuar veçmas si “vlerat e tërheqjeve të pronarit” siç pretendon subjekti, pra pronari ka kryer tërheqje si rezultat i diferencave të kapitaleve apo “kapitalit të pronarit” ndër vite në vlerën 13.166.937 lekë¹⁰⁰. Vlerë më e vogël se deklarimi i të ardhurave të deklaruara prej subjektit në deklaratën *vetting* e deklaratat periodike. Kjo situatë faktike e bind Kolegjin se gjendja e “arkës”, nuk ka qenë një pasuri e shtuar e biznesit të bashkëshortes përtej të ardhurave të deklaruara prej tij, por ka qenë një gabim kontabël që ka pasqyruar të njëjtën vlerë të përfituar si e ardhur, por pa përcaktuar me korrektesë administrimin/posedimin/përdorimin e saj.

31.7.3. Së treti, Kolegji ka në konsideratë se deklarimi ose jo i kësaj gjendjeje të “arkës” në pasqyrat financiare të subjektit tregtar, person fizik, në analizë të dispozitave të legjislacionit tatimor, nuk passjell ndikim tatimor negativ për shtetin, as nuk i shërben personit fizik si arsye për të mos e bërë atë subjekt detyrimesh tatimore, në formën e tatimit nga të ardhura që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo aksionerit, nuk prodhon asnjë efekt tatimor i cili mund të shmangej nëpërmjet deklaratimit të saj prej subjektit, çka do mund të vlerësohej nga trupi gjykues si një justifikim i arsyeshëm për akumulimin e fitimit sipas raportimit në pasqyrat financiare dhe mosshpërndarjen e tij krahas fitimit të deklaruar. Në eventualitetin që shumat monetare të disponueshme dhe të deklarueshme në këtë mënyrë do të prodhonin një ndikim në uljen e detyrimeve tatimore për t'u paguar, e gjithë tabloja e situatës faktike të shpjeguar prej subjektit do të vlerësohej në një kontekst tjetër e mund të çonte Kolegjin në konkluzione të tjera.

¹⁰⁰ Përkatësisht nga analiza në Kolegj, për vitin 2013 rezultoi shuma prej 4.716.937 lekë, për vitin 2015 rezultoi shuma prej 6.500.000 lekë, dhe sipas bilancit të dorëzuar në organet tatimore në vitin 2016 në zërin “vlera e tërheqjeve të kryera nga pronari gjatë periudhës”, ishte në shumën prej 1.950.000 lekë.

31.7.4. Së katërti, fakti i pranuar prej Komisionit se kjo shumë monetare mbahej realisht në arkën e personit fizik, pa u disponuar prej pronarit për vite me radhë, në përmasat që ajo kishte në vlerën prej 13.166.937 lekësh në raport me natyrën e llojin e aktivitetit tregtar, duket jorealiste dhe as në interes të vetë personit fizik apo edhe të njësisë familjare, të cilat nuk mund të lënë të bllokuar në mënyrë të pakuptimtë e pa asnjë efekt fiskal, shuma të mëdha parash, përdorimi i të cilave krijon mundësi të rritjes së të ardhurave e të pasurive.

31.7.5. Për të gjitha arsyet e renditura më lart, Kolegji arriti në konkluzionin se pretendimi i subjektit për mosekzistencën reale të gjendjes “arka”, sipas deklarimeve në pasqyra financiare, është i besueshëm dhe, për pasojë, njësia familjare nuk mund të ngarkohet me këtë shpenzim në vitet kur ai është pasqyruar si i tillë.

31.8. Kolegji kreu analizën financiare duke reflektuar në të këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, sipas këtij pretendimi, në analizën financiare të njësisë familjare për vitet 2010-2016 nuk u konsiderua gjendja “arka” e aktivitetit privat të bashkëshortes për këto vite, si një gjendje likuiditeti *cash* të njësisë familjare të subjektit. Analiza financiare për vitet 2010 - 2016, duke pasqyruar në të vetëm këtë ndryshim dhe pa trajtuar çështje të tjera të analizës financiare, për të cilat nuk ka një shkak ankimi dhe që mund të rëndonin hipotetakisht rezultatin dhe pozitën e subjektit, rezulton të pësojë ndryshimet si vijojnë: a) për vitin 2010, duke mos konsideruar vlerën e likuiditetit “arka” nga pasqyrat financiare të aktivitetit të bashkëshortes si PF, si gjendje likuiditeti *cash* prej 1.453.176 lekësh, atëherë rezultati i vitit do të ndryshonte nga – 1.562.349 lekë në – 109.173 lekë; b) për vitin 2011, duke mos konsideruar vlerën e likuiditetit “arka” nga pasqyrat financiare të aktivitetit të bashkëshortes si PF, shtesën e këtij likuiditeti (duke krahasuar vitin 2011 me vitin 2010) si shtesë likuiditeti *cash* prej 1.483.098 lekësh, atëherë rezultati i vitit do të ndryshonte nga – 1.917.097 lekë në – 433.999 lekë; c) për vitin 2012, duke mos konsideruar vlerën e likuiditetit “arka” nga pasqyrat financiare të aktivitetit të bashkëshortes si PF, shtesën e këtij likuiditeti (duke krahasuar vitin 2012 me vitin 2011) si shtesë likuiditeti *cash* prej 2.247.844 lekësh, atëherë rezultati i vitit do të ndryshonte nga – 2.137.681 lekë në +110.163 lekë; ç) për vitin 2014, duke mos konsideruar vlerën e likuiditetit “arka”, nga pasqyrat financiare të aktivitetit të bashkëshortes si PF, shtesën e këtij likuiditeti (duke krahasuar vitin 2014 me vitin 2013) si shtesë likuiditeti *cash* prej 812.037 lekësh, atëherë rezultati i vitit do të ndryshonte nga –1.018.272 lekë në –206.235 lekë.

31.8.1. Analiza e njësisë ekonomike familjare për vitet 2010 - 2016, do të rezultonte me diferenca negative në tri vite, përkatësisht 2010, 2011 dhe 2014, në shumën totale prej (–) 749.407 lekësh, në ndryshim nga sa rezultonte në Komision në total diferenca negative në disa vite (2010-2012 dhe 2014) prej – 6.635.399 lekësh.

31.8.2. Në përfundim, nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitet 2010 - 2016, subjekti i rivlerësimit rezulton se gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të përballuar pasuritë e vëna, shpenzimet e kryera dhe pagesën e detyrimeve në një vlerë prej (–) 749.407 lekësh, situatë e cila e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

32. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, trupi gjykues i Kolegjit, pasi mori në shqyrtim ankimin e subjektit të rivlerësimit dhe parashtrimet, arrin në përfundimet e mëposhtme.

- a) Lidhur me pagesën e shumës prej 10.000 eurosh, paguar në datën 18.10.2008, si pjesë e kështit prej 49 mijë eurosh, të paguar në vitin 2008, për blerjen e apartamentit të ndodhur në kompleksin ““{***}””, “{***}”, Tiranë, me sip. 250 m², me vlerë 160.000 euro, subjekti i rivlerësimit rezulton të gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar atë dhe shpenzimet e tjera familjare në vlerën prej (-) 899.670 lekësh.
- b) Lidhur me shumën prej 41.000 eurosh, të paguar sipas deklarimeve të subjektit deri në datën 03.06.2009, për blerjen e pasurisë së përshkruar më lart, subjekti i rivlerësimit rezulton se gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për ta justifikuar atë dhe shpenzimet e tjera familjare në vlerën prej (-) 2.144.286 lekësh.
- c) Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitet 2010 - 2016, subjekti i rivlerësimit rezulton se gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të përballuar pasuritë e vëna, shpenzimet e kryera dhe pagesën e detyrimeve në vlerën prej (-) 749.407 lekësh.
- ç) Në përmbledhje të tri konkluzioneve të mësipërme, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti gjendet në mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara e shpenzimet e kryera në tërësi, në vlerën prej 3.793.363 lekësh, situatë faktike e cila kualifikohet si ajo e parashikuar nga nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
- d) Në drejtim të verifikimit të burimeve të ligjshme për shumat monetare të marra hua prej personave të tjerë të lidhur, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave për justifikimin e shumave të marra hua, në vlerën prej 2.000.000 lekësh dhe 10.000 eurosh nga vëllai i tij, z. B. B., si edhe të shumës prej 1.000.000 lekësh të marrë hua nga vëllai, z. P. B., në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

Në vlerësimin tërësor të shkeljeve të konstatuara nga kontrolli e vlerësimi i kriterit të pasurisë, Kolegji konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk justifikoi bindshëm pasuritë e krijuara e deklaruar prej tij në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Të gjitha shkeljet e konstatuara së bashku të çojnë në përfundimin se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

- 33. Në këto kushte, pavarësisht se u gjendën të drejta disa prej pretendimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, trupi gjykues i Kolegjit nuk i gjeti ato të mjaftueshme për ndryshimin e vendimit nr. 166, datë 21.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- 34. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi që ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është marrë mbështetur në fakte e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 166, datë 21.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Gurali Brahimllari.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 12.10.2021, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi